



UNIVERSITETI I EVROPES JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

FAKULTETI I DREJTËSISË
ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ
FACULTY OF LAW

STUDIME PASDIPLOMIKE-CIKLI I DYTË

TEZA:

***“USHTRIMI I SË DREJTËS PRINDORE PAS SHKURORËZIMIT TË MARTESËS NË
SISTEMIN JURIDIK TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË DHE NË TË DREJTËN
KOMPARATIVE ”***

KANDIDATI:

Besiana Aliji

MENTORI:

Prof. Dr. Emine Zendeli

Tetovë, 2020

| | |
|--|----|
| Hyrje | 5 |
| Kapitulli I..... | 7 |
| 1.Nocioni i martesës..... | 7 |
| 1.1 Procedura për lidhjen e martesës | 9 |
| 1.2 Pushimi i martesës | 9 |
| 1.3 Martesat sipas përkatësisë etnike te nuses dhe dhëndrit në vitin 2018 | 10 |
| 2. Shkurorëzimi dhe shkaqet e shkurorëzimit | 11 |
| 2.1 Sisteme të shkurorëzimit të martesës | 12 |
| 2.2 Sistemi i ndalimit të shkurorëzimit | 12 |
| 2.3 Sistemet që lejojnë shkurorëzimin | 13 |
| 2.4 Sistemi i shkurorëzimit të martesës si sanksion..... | 13 |
| 2.5 Sistemi i shkurorëzimit të martesës si ilaç | 13 |
| 2.6 Sistemi i kombinuar i shkurorëzimit të martesës | 13 |
| 3.Shkaqet për shkurorëzimin e martesës në të drejtën familjare të Republikës së Maqedonisë | 14 |
| 3.1 Martesa të shkurorëzuara sipas përkatësisë etnike të bashkëshortëve në vitin 2018 | 16 |
| 3.2 Martesa të shkurorëzuara sipas përkatësisë etnike të bashkëshortëve në vitin 2016 | 17 |
| 3.3 Statistika nga martesa të shkurorëzuara në vitet 2012, 2013, 2014, 2015, 2016 | 19 |
| 3.4 Përkatësia etnike e gruas | 20 |
| 4. Shkurorëzimi i martesës në të drejtën e krahasuar..... | 21 |
| 4.1 Shkurorëzimi i martesës në ish-shtetet e Jugosllavisë | 21 |
| 4.2 Shkurorëzimi i martesës në legjislacionin e Republikës së Maqedonisë | 22 |
| 4.3 Shkurorëzimi në vende të ndryshme evropiane | 23 |
| 5. Procedura për shkurorëzim dhe pasojat e shkurorëzimit | 25 |
| 5.1 Pasojaat e shkurorëzimit të martesës | 26 |
| Kapitulli II..... | 27 |
| Kuptimi i së drejtës prindore..... | 27 |
| 1. Marrëdhëniet e prindërve dhe fëmijëve | 27 |
| 2. E drejta prindore sipas Ligjit për familje të Republikës së Maqedonisë..... | 29 |
| 3. E drejta prindore në legjislacionet bashkëkohore | 30 |
| 4. Përmbajtja e përgjegjësisë prindore në të drejtën krahasuese (Join Custody) | 31 |
| 5. Ushtrimi i së drejtës prindore pas shkurorëzimit në vende të ndryshme evropiane..... | 34 |
| 6.Krijimi dhe ushtrimi i së drejtës prindore në të drejtën familjare të Republikës së Maqedonisë | 40 |
| 7. Ushtrimi i së drejtës prindore pas shkurorëzimit | 41 |
| 8. Marrëveshja për ushtrimin e së drejtës prindore | 42 |
| 9. Kushtet për dhënien e fëmijëve në ruajtje..... | 43 |

| | |
|--|----|
| 10. Vullneti i lirë i fëmijës | 44 |
| 10.1 Si mund të vlerësohet respektimi i parimit të interesit më të lartë të fëmijës?..... | 44 |
| 11. Vendim kundër vullnetit të fëmijës kur vjen në shprehje interesi i fëmijës..... | 45 |
| 12. Roli i Qendrës për punë sociale në ushtrimin e së drejtës prindore sipas të drejtës pozitive familjare | 46 |
| 13. Roli i Avokatit të popullit në mbrojtjen e interesit më të mirë të fëmijës sipas të drejtës pozitive .. | 48 |
| Kapitulli III | 51 |
| Të drejtat dhe obligimet e prindërve dhe fëmijëve pas shkurorëzimit..... | 51 |
| 1. Ushtrimi i së drejtës prindore nga ana e njërit prind | 51 |
| 2. Mbajtja e kontakteve me prindin tjetër | 51 |
| 3. Ushqimia (mbajtja) e anëtarëve të familjes..... | 55 |
| 4. Mundësia e marrjes të së drejtës prindore prindit që i është dhënë fëmija | 56 |
| 5. Mbikëqyrja në ushtrimin e të drejtës prindore | 57 |
| KAPITULLI IV | 58 |
| Kushtet e nevojshme për ushtrimin e së drejtës prindore pas shkurorëzimit | 58 |
| 1. Kushtet që duhet ti plotësojë prindi | 58 |
| 2. Mosha e fëmijës si kusht..... | 59 |
| 3. Mosdhënia e fëmijës për shkak të shkurorëzimit të martesës me fajin e bashkëshortit | 59 |
| 4. Mosushtrimi i së drejtës prindore nga asnjëri prind..... | 60 |
| 4.1 Marrja e të drejtës prindore | 60 |
| Neglizhenca fizike | 61 |
| Neglizhenca shëndetësore | 61 |
| Abuzimi emocional | 61 |
| 4.2 Mbrojtja sociale në Republikën e Maqedonisë | 62 |
| 5. Ndryshimi i vendimit me të cilin caktohet se cili prind do të ushtrojë të drejtën prindore | 63 |
| 6. Kompetenca e Gjykatës | 64 |
| KAPITULLI V | 65 |
| PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME | 65 |
| Literatura..... | 68 |
| Akte ligjore, kode..... | 69 |
| Burime nga interneti | 70 |

Hyrje

E drejta prindore si dhe ushtrimi i së drejtës prindore veçanërisht ushtrimi i së drejtës prindore pas shkurorëzimit të martesës është njëra nga pyetjet më të hulumtuara në të drejtën familjare bashkëkohore gjithashtu edhe në të drejtën tonë familjare. Mënyra dinamike e jetesës, përmbushja e nevojave personale përpara atyre familjare, duke mos i kushtuar rëndësinë e duhur familjes si dhe një numër i madh i shkaqeve kanë bërë që çdo ditë e më shumë të rritet numri i rasteve të shkurorëzimit. Shkurorëzimi i martesës është një nga temat aktuale në të gjitha shtetet bashkëkohore shikuar nga aspekti kronik i pranisë së saj në shoqëritë moderne, si një nga temat me rëndësi të veçant për t'u analizuar duke pasur në konsiderat pasojat të cilat i shkakton në familje, me theks të veçant tek fëmijët. Pas shkurorëzimit të martesës familja pëson ndryshime të mëdha si në mënyrën e jetesës, duke u ndarë fizikisht ashtu edhe në atë emocional. Ndërsa si viktimitë nga e gjithë kjo çdoherë janë fëmijët. Ato janë të detyruar që të jetojnë me prindër të ndarë, duke ndërruar edhe vendbanimin në rastet kur i janë dhënë në përkujdesje njërit prind, të jetojnë të ndarë nga motrat dhe vëllezërit e tjerë, kur disa janë besuar në mbikëqyrje njërit prind, të tjerët prindit tjetër, të rriten larg nga rrethi familjar. Prandaj themi se shkurorëzimi shkakton pasojat të rënda në bashkësinë familjare si në aspektin ekonomik-financiar gjithashtu edhe në atë emocional, psikik. Në të drejtën komparative por edhe në të drejtën tonë familjare parashihet se fëmijët kanë të drejtë që të jetojnë me prindërit e tyre. Këtë të drejtë ata mund ta gëzojnë vetëm atëherë kur prindërit e tyre jetojnë bashkërisht. Prindërit që janë në kurrorë dhe që jetojnë në një bashkësi familjare e ushtrojnë të drejtën prindore bashkërisht dhe me marrëveshje. Ndërsa edhe kur ata janë të ndarë pas shkurorëzimit duhet që të vazhdojnë të ushtrojnë të drejtën prindore bashkërisht. Nëse prindërit nuk janë marrë vesh për këtë ose nëse marrëveshja e tyre nuk u përgjigjet interesave të fëmijëve, gjykata posa të marrë mendimin nga Qendra për punë sociale dhe të hulumtojë të gjitha rrethanat, do të vendosë nëse fëmijët do të qëndrojnë për ruajtje dhe edukim te njëri prind ose disa do të qëndrojnë tek nëna, disa tek babai ose të gjithë do t'i besohen ndonjë personi të tretë apo institucioni (neni 80). Nga ky nen mund të përfundojmë se e drejta jonë familjare nuk parasheh institucionin e ushtrimit të përbashkët të së drejtës prindore edhe pas ndarjes së bashkëshortëve martesor, që domethënë i ashtuquajturit insituti Joint Custody- Kujdestaria e përbashkët në sistemin juridik është mangësi. Thënë ndryshe nuk ka ndonjë mundësi ligjore që gjykata të sjell vendim me të cilin do të urdhërojë që të dy prindërit pas shkurorëzimit të ushtrojnë të drejtën prindore njëkohësisht. Prindit të cilit i janë besuar fëmijët në përkujdesje i përjeton vështirësitë më të mëdha si nga aspekti financiar për mirëmbajtjen e tyre, duke pasur edhe një serë detyrime të tjera për rritjen, edukimin, mirëqenien e tyre. Tjetri jeton me kufizim, duke mos pasur mundësi që të shohë çdo ditë se si rriten fëmijët e tij, duke e parë vetëm në periudha dhe termine të caktuara. Përkrah të gjitha këtyre pasojave negative që sjell shkurorëzimi në bashkësinë familjare, absolutisht janë të gabuara bindjet të cilat shkurorëzimin e shohin si fund i një familje.

Edhe pse të ndarë, prindërit duhet që të vazhdojnë të ushtrojnë të drejtën e tyre prindore. Edhe pse Ligji për familje në Republikën e Maqedonisë shumë pak mund të krijojë kushte të tilla në rastet e shumta të shkurorëzimeve në vendin tonë. Qëllimi i kësaj teme është që të analizohet e drejta familjare e Republikës së Maqedonisë, duke e krahasuar me të drejtën familjare bashkëkohore të vendeve të tjera, për mënyrën e shkurorëzimit të martesës, të drejtën prindore, ushtrimin e të drejtës prindore me theks të veçant ushtrimin e kësaj të drejte pas shkurorëzimit të martesës, pasojat nga shkurorëzimi në dëm të fëmijëve, interesi më i mirë i fëmijëve si dhe të gjitha pyetjet e tjera që dalin nga hulumtimi i kësaj teme. Nga të gjitha rastet e shkurorëzimit dhe vendimeve që jepen në lidhje me të duke përfshirë edhe interesin më të mirë të fëmijëve duhet që të implementohen dhe të jepen propozime për ndryshime dhe përmbushje të zbrastirave juridike në ligjin e së drejtës familjare, duke u mbështetur në dokumente më të rëndësishme ndërkombëtare, Juridiksioni i Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut, për ti dhënë mbështetje dhe të gjejë zbatim e drejta e ushtrimit të së drejtës prindore bashkërisht edhe pas shkurorëzimit të martesës.

Kapitulli I

1.Nocioni i martesës

Në të drejtën tonë familjare, në ligjin për familje martesë definohet si “bashkësi jetësore e rregulluar me ligj e një burri dhe një gruaje në të cilën realizohen interesat e bashkëshortëve, familjes dhe shoqërisë” (neni 6).

Marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve themelohen në bazë të vendimit të lirë të burrit dhe gruas për të lidhur martesën, në bazë të barazisë së tyre, respektit reciprok dhe ndihmës të ndërsjelltë.¹

Martesa si institucion juridik dhe shoqëror, është një ndër institucionet më të lashta, e gjithsesi më i rëndësishëm shoqëror dhe juridik. Megjithatë, ka pasur dilema dhe mospërputhje mendimesh në teorinë juridike familjare, për konceptin e natyrës juridike të martesës. Për natyrën juridike të martesës ekzistojnë dy koncepte kryesore: martesë është kontratë civile dhe martesë është institucion. I pari, që e cilëson martesën si kontratë, i ka rrënjët e veta në të drejtën romake dhe ka qenë sanksionuar shprehimisht në legjislacionin kishtar. Ky koncept gjeti shprehje në të drejtën franceze dhe në të drejtën e vendeve në të cilat u zbatua Kodi civil i Napolonit. Martesa, sipas këtij koncepti është një kontratë civile e karakterit specifik. Natyra urdhëruese e normave juridike të cilat zbatohen me rastin e lidhjes dhe zgjidhjes së martesës, të cilat bashkëshortët nuk mund t'i ndryshojnë me shprehjen e lirë të vullnetit, kontratës së martesës i japin karakter specifik kundrejt kontratës së shitblerjes apo kontratave tjera civile. Koncepti i dytë e cilëson martesën si institucion juridik. Përfaqësuesit e këtij koncepti, si profesorët Emanuel Levi, A. Bankas e të tjerë, pohojnë se: martesë krijon statusin juridik bashkëshortor për burrin dhe gruan dhe kështu formohet familja; ndërsa martesë nuk ka përmbajtje dhe synim kontratën; subjekt i marrëdhënieve martesore mund të jetë vetëm një burrë dhe një grua, ndërsa te kontrata civile mund të ketë dy e më shumë palë kontraktuese; për lidhjen e martesës ekzistojnë pengesa martesore absolute, si: gjinia e gjakut në vijë të drejtë pa kufi dhe në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, kurse për lidhjen e kontratave civile nuk janë vënë pengesa të tilla; marrëdhëniet martesore kanë karakter personal dhe si rrjedhojë, natyra dhe përmbajtja e tyre është krejtësisht ndryshe nga ato që krijohen për debitorin dhe kreditorin, kur është fjala për cilëndo kontratë; dispozitat ligjore për lidhjen dhe zgjidhjen e martesës janë të natyrës urdhëruese, ndërsa mjaft norma për lidhjen dhe shuarjen e marrëdhënieve kontraktuese nuk kanë karakter urdhërues.²

Martesa lidhet në bazë të kërkesës së bashkëshortëve, sipas vullnetit të lirë të tyre. Në të drejtën tonë familjare, që të prodhojë efekte juridike martesë duhet të lidhet në bazë të kushteve të parapara në ligj.

¹ЗАКОН ЗА СЕМЕЈСТВОТО,(ПРЕЧИСТЕН ТЕКСТ),Сл. Весник на Р. Македонија, бр.153 од 20.10.2014 година
Neni 6, në tekstin në vijim e përdorur si LF.

² Hamdi Podvorica, E drejta familjare, Prishtinë 2005, fq 67,68.

Si kusht themelor që martesë të prodhojë efekte juridike, duhet të lidhet ndërmjet dy personave me gjini të kundërt me deklaratë të lirë të vullnetit të tyre përpara organit kompetent, në mënyrë të caktuar me ligj. Martesa lidhet në bazë të kërkesës së bashkëshortëve, sipas vullnetit të lirë të tyre. Në qoftë se ekzistojnë pengesa të cilat janë të parapara në ligj martesë e tillë nuk mund të lidhet, apo nëse është lidhur martesë e tillë do të anulohet.

Pengesat martesore janë rrethana ose fakte të vertetuara me ligj të cilat nuk duhet të ekzistojnë në momentin e lidhjes së martesës. Martesa e lidhur duke ekzistuar pengesa të tilla nuk do të jetë e plotfuqishme dhe si e tillë do të anulohet. Në të drejtën tonë, ligji për familje parasheh pesë lloje të pengesave martesore edhe atë: moshë e mitur, martesë ekzistuese, formë e manifestuar e sëmundjes psikike, paaftësia për të gjykuar si dhe personat me zhvillim të metë mendor, mungesa e vullnetit të lirë si dhe gjinia. Nga kjo rrjedh se: Nuk mund të lidhë martesë personi i cili nuk ka mbushur moshën 18 vjeçare. Gjykata kompetente ka mundësi që në procedurë jokontestimore t'i lejojë lidhjen e martesës personit i cili ka mbushur moshën 16 vjeçare nëse vërteton se ai ka arritur pjekurinë fizike dhe psikike të nevojshme për kryerjen e të drejtave dhe detyrave që krijohen në martesë dhe pas sigurimit të mendimit të institucionit shëndetësor dhe ndihmës profesionale të ofruar nga Qendra për punë sociale. Propozimin për sjelljen e vendimit për dhënien e lejes për lidhjen e martesës mund ta parashtrijë vetëm personi i cili ende nuk ka mbushur moshën madhore. Në procedurën për sjelljen e vendimit për lidhjen e martesës së personit që ende nuk ka mbushur moshën madhore, gjykata do ta dëgjojë parashtruesin e mitur të propozimit, prindërit e tij, respektivisht kujdestarin dhe personin me të cilin dëshiron të lidh martesë. Pengesë tjetër martesore është edhe martesë ekzistuese pra nuk mund të lidh martesë personi përderisa martesë e mëparshme nuk i ka pashuar. Gjithashtu nuk mund të lidhin martesë personat të cilën për shkak të formës së manifestuar të sëmundjes psikike me prani të simptomave psikotike ose me shenja reziduale nga sëmundja nuk janë në gjendje që ta kuptojnë rëndësinë e martesës dhe obligimeve që dalin prej saj dhe të tillët njëkohësisht janë të paaftë për të gjykuar. Poashtu nuk mund të lidhin martesë dhe personat me zhvillim të metë mendor (psiqik) nëse i takojnë grupit të personave me mbetje mentale të rëndë IQ është nën 36 shkallë. Personat të cilët janë të numëruar si persona me pengesa të zbutura në zhvillimin psiqik ose me pengesa të lehta në zhvillimin psiqik si dhe personat të cilët kanë sëmundje trashëguese nga familja, mund të lidhin martesë pas mendimit të marrë lidhur me konstrukcionin gjenetik të dhënë nga Enti për shëndet mendor të fëmijëve dhe të rrinjve në Shkup ose ndonjë institucion tjetër përkatës që merret me hulumtime gjenetike. Martesa nuk do të jetë e plotfuqishme nëse pajtimi për lidhjen e martesës është dhënë nën ndikimin e dhunës, mashtrimit ose lajthimit.

Si pengesë martesore është edhe gjinia e gjakut. Nuk mund të ligjin martesë ndërmjet tyre të afërmit e gjinisë së gjakut në vijë të drejtë (gjyshi, gjyshja, nëna babai dhe nipërit), si dhe as vllazërit dhe motrat e lindur nga prindër të përbashkët, vëllau dhe motra nga babai, gjegjësisht nga nëna, xhaxhai dhe fëmija i vëllaut, daja dhe fëmija nga motra, tezja dhe fëmija nga vëllau, tezja dhe fëmija nga motra, as kushërinjtë e parë. Nuk mund të lidhin martesë edhe personat gjinia e të cilëve nga paragrafi paraprak është bazuar në adoptim.

Nuk mund të lidhin martesë vjehri dhe nusja, dhëndri dhe vjehrra, njerku dhe thjeshtra, njerka dhe thjeshtri, pa marrë parasysh nëse lidhja martesore me të cilën kanë ardhur në këtë lidhje familjare ka përfunduar. Gjinia jashtmartesore paraqet pengesë për lidhjen e martesës ashtu sikurse edhe gjinia martesore. Për të gjitha këto pengesa martesore zbatohen dispozitat e këtij ligji që kanë të bëjnë me anulimin e martesës.

1.1 Procedura për lidhjen e martesës

Personat që kanë për qëllim të hyjë në martesë parashtrojnë fletëparaqitje deri te organi administrativ kompetent për mbajtjen e librave amzë të të kurorëzuarve. Fletëparaqitja për lidhjen e martesës mund të dorëzohet me shkrim ose gojarisht me procesverbal. Bashkëshortët e ardhshëm i bashkangjesin fletëparaqitjes çertifikatë nga libri amzë i të lindurve dhe dokumentet tjerë kur kjo është e nevojshme (aktvendim me të cilin lejohet lidhja e martesës, provë se martesë e mëparshme ka përfunduar etj). Ofiqari do të vërtetojë në bazë të deklaratës së personave që duan të lidhin martesë, por sipas nevojës edhe në ndonjë mënyrë tjetër, se a ekziston pengesë ligjore për lidhjen e martesës. Ai është i obliguar me aktvendim të refuzojë lidhjen e martesës nëse vërteton se sipas ligjit nuk është e lejuar lidhja e martesës pasi ekzistojnë pengesa martesore. Kundër këtij aktvendimi, në afat prej tetë ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit deri tek organi administrativ kompetent për mbajtjen e librave amzë. Martesa lidhet në prani të personave që dëshirojnë të lidhin martesë, anëtarit të këshillit të komunës që do ta përcaktojë komuna, dy dëshmitar dhe ofiqari.

1.2 Pushimi i martesës

Ashtu sikur ekziston e drejta për të lidhur martesë ekziston edhe e drejta për të zgjidhur martesën. Në pajtim me ligjin tonë të familjes, martesë pushon: me vdekjen e njërit bashkëshort, me shpalljen e bashkëshortit të zhdukur për të vdekur, me anulim dhe me shkurorëzim të martesës. Nëse njëri prej bashkëshortëve është shpallur për të vdekur martesë pushon në ditën e cila me aktvendim të plotfuqishëm është përcaktuar si ditë e vdekjes së tij. Martesa pushon me anulim dhe me shkurorëzim kur aktgjykimi për anulim, respektivisht aktgjykimi për shkurorëzim bëhet i plotfuqishëm.

Martesa do të anulohet nëse vërtetohet se gjatë lidhjes së saj ka ekzistuar ndonjëra nga pengesat e parapara në ligjin për familje, neni 16-22. Anulimin e martesës mund ta kërkojë njëri prej bashkëshortëve, prokurori publik si dhe personi fizik apo juridik i cili për këtë ka interes juridik, nëse për këtë në ligj nuk është përcaktuar diçka tjetër. Anulimi i martesës së lidhur me dhunë mund ta kërkojë vetëm bashkëshorti i cili ka qenë i detyruar të lidh martesë. Padija mund të parashtrohet në afat prej një viti nga dita kur rreziku për realizimin e dhunës ka pushuar. Anulimin e martesës së lidhur nën lajthim mund ta kërkojë vetëm bashkëshorti i cili në lajthim është pajtuar të lidh martesë.³

³ Neni 15-38, LF

1.3 Martesat sipas përkatësisë etnike te nuses dhe dhëndrit në vitin 2018

| Përkatësia etnike e nuses | Përkatësia etnike e dhëndrit | | | | | | | | | |
|---------------------------|------------------------------|---------|----------|------|-----|-------|------|----------|----------|-------------|
| | Gjithsej | Maqedon | Shqiptar | Turk | Rom | Vlleh | Sërb | Boshnjak | Të tjerë | Të panjohur |
| Gjithsej | 13 494 | 7 055 | 4 785 | 532 | 438 | 10 | 91 | 109 | 298 | 176 |
| Maqedone | 6 973 | 6 758 | 16 | 17 | 10 | 8 | 70 | 6 | 67 | 21 |
| Shqiptare | 4 741 | 44 | 4 618 | 57 | 1 | - | - | 9 | 11 | 1 |
| Turke | 471 | 3 | 18 | 439 | - | - | - | 6 | 5 | - |
| Rome | 447 | 9 | 3 | 4 | 420 | - | 1 | - | 9 | 1 |
| Vlleh | 7 | 6 | - | - | - | 1 | - | - | - | - |
| Sërb | 103 | 75 | 4 | - | 1 | 1 | 19 | - | 3 | - |
| boshnjak | 108 | 5 | 16 | 8 | 1 | - | - | 77 | 1 | - |
| Të tjerë | 481 | 144 | 109 | 7 | 5 | - | 1 | 11 | 201 | 3 |
| Të panjohur | 163 | 11 | 1 | - | - | - | - | - | 1 | 150 |

Burimi: “Северна Македонија во бројки, Макстат, 2019” стр. 17

Në bazë të të dhënave nga Instituti shtetëror për statistika, në Republikën e Maqedonisë, në vitin 2018 gjithsej janë të regjistruara 13494 martesat të kurorëzuara. Nga ky numër i përgjithshëm i martesave, të përkatësisë etnike maqedone, gjithsej janë 7055 burra maqedon të martuar me 6758 gra të përkatësisë etnike maqedone, nga ky numër, burra të përkatësisë etnike maqedone janë të martuar 44 gra të përkatësisë etnike shqiptare, 3 prej tyre me gra të përkatësisë etnike turke e kështu me rradhë, me përkatësitë etnike tjera. Të përkatësisë etnike shqiptare 4785 burra janë të martuar me 16 gra të përkatësisë etnike maqedone. Nga ky numër me gra shqiptare janë të martuar 4618, me gra të përkatësisë turke janë të martuar 18 e kështu me rradhë me përkatësitë etnike tjera.

2. Shkurorëzimi dhe shkaqet e shkurorëzimit

Çdo dukuri njerëzore, veçanërisht ato që reflekohen në botën fizike, kanë një fillim dhe një mbarim. Shpeshherë thuhet se ngjarjet më të mëdha në jetën e një njeriu janë lindja, martesë dhe vdekja. Lindja dhe vdekja janë fenomene të cilat nuk i nënshtrohen vullnetit të njeriut. Martesë është fenomen i cili i nënshtrohet vullnetit njerëzor, por që edhe kjo si çdo fenomen tjetër njerëzor, ka një fillim dhe një mbarim, pra ajo mund të shkurorëzohet.⁴ Shkurorëzimi si një nga mënyrat më të shpeshta të prishjes së martesës së vlefshme është e pranuar gati se në të gjitha legjislacionet familjare bashkëkohore. Shkurorëzimin e martesës mund ta kërkojë secili nga bashkëshortët, në rastet kur marrëdhëniet martesore do të jenë të prishura deri në atë masë sa jeta e përbashkët bashkëshortore është bërë e padurueshme. Martesë mund të prishet me shkurorëzim sipas kushteve dhe menyrës së përcaktuar me ligj. Pra që të prishet martesë me shkurorëzim nuk mjafton vetëm pajtimi i vullnetit të bashkëshortëve por është e domosdoshme të jenë plotësuar kushtet të cilat i parasheh ligji. Vendimin për shkurorëzim të martesës e sjell gjykata pasi të vërtetojë se ekzistojnë shkaqet për prishjen e martesës të parapara me ligj. Nga vetë kuptimi i shkurorëzimit të martesës dalin edhe disa nga karakteristikat kryesore të tij. *E para*, me shkurorëzim mund të prishet vetëm martesë absolutisht e vlefshme, martesë e lidhur sipas kushteve të parapara në ligjin për familje. Në të kundërtën, nëse vërtetohet se nuk janë përmbushur kushtet për lidhjen e martesës ose ekzistojnë pengesa martesore, martesë e tillë është absolutisht e pavlefshme, dhe si e tillë do të anulohet. Në rastet kur vërtetohet se ekzistojnë pengesa martesore të cilat e bëjnë të pavlefshme martesën, si dhe ekzistojnë shkaqet për shkurorëzim të martesës, gjithmonë përparësi ka anulimi i martesës. *E dyta*, martesë mund të shkurorëzohet derisa janë gjallë bashkëshortët. Bashkëshortët martesor duhet të jenë gjallë gjatë gjithë rrjedhës të procedurës së shkurorëzimit, që nga parashtrimi i kërkesës deri në sjelljen e vendimit të plotfuqishëm të shkurorëzimit të martesës. Me vdekjen e njërit prej bashkëshortëve gjatë rrjedhës së procedurës të shkurorëzimit, martesë do të prishet sipas fuqisë së ligjit, pasi procedura për shkurorëzim do të pësojë ndërprerje. Kjo karakteristikë del nga fakti se e drejta për shkurorëzim të martesës është e drejtë absolute që u takon vetëm bashkëshortëve martesor. Kjo e drejtë nuk bartet tek trashëgimtarët. Trashëgimtarët mund vetëm të vazhdojnë procedurën e filluar duke vërtetuar se ekzistojnë shkaqe për prishjen e martesës. *E treta*, martesë mund të shkurorëzohet vetëm me vendim të gjykatës, në procedurë të përcaktuar me ligj. Dhe karakteristika *e katërt*, martesë mund të shkurorëzohet vetëm nëse vërtetohet se ekzistojnë shkaqet e parapara me ligj.⁵

⁴ Arta Mandro- Bilalli, Vjollca Meçaj, Tefta Zaka, Arjana Fullani, E drejta familjare, Tiranë 2006, fq.362.

⁵ Љиљјана Спировиќ Трпеновска, Дејан Мицковиќ, Ангел Ристов, Семејно Право, Скопје, 2013, fq.136.

2.1 Sisteme të shkurorëzimit të martesës

Në teorinë dhe praktikën ligjvënëse janë të njohura shumë sisteme të shkurorëzimit të martesës. Varësisht nga ajo se a lejohet shkurorëzimi i martesës ose nuk lejohet, si dhe a ka rëndësi faji i njërit nga bashkëshortët si arsye për prishjen e martesës, ekzistojnë : 1) sistemi që ndalon shkurorëzimin 2) sistemi që lejon shkurorëzimin, 3) sistemi i shkurorëzimit si sanksion, 4) sistemi i shkurorëzimit të martesës si ilaç, 4) sistem i kombinuar i shkurorëzimit të martesës.⁶

2.2 Sistemi i ndalimit të shkurorëzimit

Ky sistem ndalon zgjidhjen e martesës nën ndikimin e filozofisë së të drejtës kanonike katolike. Kisha katolike e trajtonte martesën si shprehje e vullnetit hyjnor dhe nuk lejonte zgjidhjen e saj. Martesa mund të priset vetëm me vdekjen e njërit nga bashkëshortët martesor ose me anulimin e martesës. Me kalimin e kohës, kisha katolike filloi të bëjë reforma, duke lejuar institucionin e ndarjes nga shtrati dhe tryeza (separation thorum et mensam). Në bazë të këtij institucioni, martesa nuk zgjidhej, ajo vazhdonte të mbetej në fuqi, mirëpo lejohej ndërprerja faktike e jetesës së përbashkët të bashkëshortëve. Gjithashtu, ato nuk kishin të drejtë të lidhin martesë të re.⁷ Në vendet si: Spanja, Argjentina, Kolumbia, Irlanda, të cilat ndodheshin nën ndikimin e së drejtës kanonike katolike, moslejimi i shkurorëzimit të martesës ka vazhduar një kohë të gjatë. Kjo ka bërë që në këto vende të rritet numri i konkubinativit, por edhe të zvogëlohej nataliteti⁸. E drejta kanonike shqiptare përkrahte parimin e pazgjidhshmërisë së martesës deri në miratimin e Kodit civil të vitit 1992. “Nuk ka të drejtë shteti me zgjidhë një kurorë që është një lidhje e vumë prej perëndisë, e naltësime me sakrament, e pazgjidhshme..”. Pra, e drejta kanonike shqiptare e konsideron martesën si institucion të përhershëm, hyjnore dhe të pazgjidhshme.⁹ Në kohë të sodit një numër relativisht i vogël i shteteve e pranojnë sistemin që e ndalon shkurorëzimin e martesës. Në Evropë, sistemi që ndalon shkurorëzimin e martesës nuk ekziston në asnjë shtet.

⁶ Дејан Мицковиќ, Ангел Ристов, Семејно Право, Стоби Трејд, Скопје, 2015, fq.157.

⁷По ату, fq.157.

⁸ Hamdi Podvorica, E Drejta Familjare, Prishtinë, 2005, fq.119.

⁹По ату, fq.119.

2.3 Sistemet që lejojnë shkurorëzimin

Në shtetet muslimane, në të cilëat zbatohet e drejta e shenjtë muslimane-sherijati, e drejta e zgjidhjes së martesës ishte një e drejtë absolute dhe e pakufizuar. Kjo e drejtë i përkiste kryesisht burrit. Kurani lejon poligaminë, pra burri kishte të drejtë të martohej me shumë gra. Ky sistem gjen zbatim në një shoqëri ku martesë trajtohej si një çështje thjesht private, prandaj dhe zgjidhja e saj lejohej pa qenë nevoja për pjesëmarrjen e ndonjë organi shtetëror.¹⁰

2.4 Sistemi i shkurorëzimit të martesës si sanksion

Sistemi i shkurorëzimit si sanksion bazohet në mos ndarjen e martesës. Megjithatë, e lejon martesën, kur njëri nga bashkëshortët do të shkelë rëndë të drejtat dhe detyrimet që dalin nga martesë. Si arsye më të shpeshta për shkurorëzim konsiderohen tradhtia bashkëshortore, lënia e bashkëshortit, dhuna fizike dhe tjera të ngjajshme.¹¹ Gjithashtu shkurorëzimi lejohet si rezultat i fajit të njërit nga bashkëshortët martesor. Në këto raste, bashkëshorti fajtor, si palë e paditur, nuk ka të drejtë në mbrojtje gjyqësore (nemo audiatur turpitudinem suam alegans). Ky sistem është njëri nga më të vjetrit, ashtuqë faji i njërit bashkëshort për një kohë të gjatë ishte arsyeja e vetme për shkurorëzim në vendet evropiane.¹²

2.5 Sistemi i shkurorëzimit të martesës si ilaç

Sistemi i shkurorëzimit të martesës si mjet shërimi e konsideron shkurorëzimin si një ilaç, në ato raste kur marrëdhëniet bashkëshortore janë të prishura deri në atë shkallë sa jeta e përbashkët është bërë e padurueshme. Për dallim nga sistemi i shkurorëzimit si sanksion, ky sistem lejon prishjen e martesës duke mos i kushtuar rëndësi se cili nga bashkëshortët është fajtor, si arsye për shkurorëzimin e martesës.

2.6 Sistemi i kombinuar i shkurorëzimit të martesës

Sistemi i kombinuar i shkurorëzimit të martesës e pranon shkurorëzimin edhe si sanksion edhe si ilaç. Në këtë kuptim, ky sistem mundëson që martesë të shkurorëzohet jo vetëm kur marrëdhëniet bashkëshortore do të jenë të prishura rëndë saqë jeta e përbashkët është bërë e padurueshme, por edhe kur do të ekzistojnë shkaqe subjektive nga të cilat jeta bashkëshortore bëhet e padurueshme. Ky sistem përveç se në të drejtën tonë, është i pranuar edhe në shumë vende evropiane.¹³

¹⁰ Hamdi Podvorica, E Drejta Familjare, Prishtinë, 2005, fq.119.

¹¹ Дејан Мицковиќ, Ангел Ристов, Семејно Право, Стоби Трејд, Скопје, 2015, fq.158.

¹² По ату, fq. 158.

¹³ Дејан Мицковиќ, Ангел Ристов, Семејно Право, Стоби Трејд, Скопје, 2015, fq.159.

3.Shkaqet për shkurorëzimin e martesës në të drejtën familjare të Republikës së Maqedonisë

E drejta jonë familjare parasheh tre shkaqe në bazë të të cilave martesa mund të shkurorëzohet:

- me marrëveshjen e ndërrsjellte të bashkëshortëve për shkurorëzim (neni 39),
- me kërkesën e njërit nga bashkëshortët në rastet kur marrëdhëniet martesore janë të prishura deri në atë shkallë sa jeta e përbashkët është bërë e padurueshme (neni 40),
- bashkëshorti mund të kërkojë shkurorëzimin e martesës, në qoftë se bashkësia martesore faktikisht ka pushuar së ekzistuari më tepër se një vit (neni 41).¹⁴

Mënyra e parë e shkurorëzimit të martesës është me marrëveshjen e ndërrsjellte të bashkëshortëve martesor. Nëse bashkëshortët kanë fëmijë të mitur të përbashkët, ose fëmijë madhor të cilëve u është vazhduar e drejta prindore, është e nevojshme që të parashtrinë marrëveshje për mënyrën e ushtrimit të së drejtave prindore dhe për mbajtjen dhe edukimin e fëmijëve.¹⁵ Gjykata pasi të vlerësojë marrëveshjen e bashkëshortëve që kanë parashtruar kërkesën për shkurorëzim, do të kërkojë edhe mendimin e Qendrës për punë sociale nëse marrëveshja e tillë për shkurorëzim është në interes të fëmijëve. Për dallim nga rastet e tjera, tek shkurorëzimi me marrëveshje bashkëshortët nuk janë të detyruar që ti tregojnë arsyet që shpiejnë deri në shkurorëzim. Kështu që në procedurë të shkurorëzimit me marrëveshje arsyet e shkurorëzimit nuk vërtetohen.¹⁶ Gjykata do të sjellë vendim për shkurorëzimin e martesës në bazë të marrëveshjes së ndërrsjellte të bashkëshortëve nëse vërteton se atë pajtim e kanë arritur në mënyrë të lirë, serioze dhe të pakthyeshme.¹⁷ *Mënyra e dytë* e shkurorëzimit të martesës sipas Ligjit për familje është shkurorëzimi në bazë të kërkesës së njërit bashkëshort kur marrëdhëniet bashkëshortore janë të prishura deri në atë shkallë sa jeta e përbashkët është bërë e padurueshme. Marrëdhëniet e tilla bashkëshortore të prishura konsiderohen si arsye objektive për prishjen e martesës, prandaj nuk kërkohen që të vërtetohen edhe arsyet subjektive që nënkupton atë se cili nga bashkëshortët është fajtor për prishjen e marrëdhënieve bashkëshortore. Faji për shkurorëzimin e martesës, sipas të drejtës sonë, mund të ketë rëndësi vetëm gjatë vendosjes së kërkesës për të drejtën e mbajtjes së bashkëshortit, kështu që faji nuk ka vend të rëndësishëm në shkurorëzimin e martesës, por shqyrtohet vetëm në rregullimin e pasojave nga shkurorëzimi i martesës.¹⁸ Në pajtim me ligjin tonë të familjes, bashkëshorti i cili nuk ka mjete të mjaftueshme për ushqim dhe është i paaftë për punë pa fajin e vet, ka të drejtë në mbajtje (ushqimia) nga ana e bashkëshortit të vet në proporcion me mundësitë e tij (neni 185). Gjykata duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit, mund ta refuzojë kërkesën për mbajtje (ushqimi) në qoftë se këtë e kërkon bashkëshorti i cili me qëllim të keq ose pa shkaqe të arsyeshme e ka braktisur bashkëshortin nga i cili kërkon ushqim (neni 185, parag.2).¹⁹

¹⁴ Neni 39, 40, 41, Lf.

¹⁵ Neni 39, Lf.

¹⁶ Дејан Мицковиќ, Ангел Ристов, Семејно Право, Стоби Трејд, Скопје, 2015, fq.160.

¹⁷ Neni 39, Paragrafi,2, Lf.

¹⁸ По ату, fq.162.

¹⁹ Neni 185, parag.2, Lf

Nën kushtet e nenit 186 të këtij ligji, bashkëshorti i pa siguruar ka të drejtë të kërkojë që me anë të aktgjykimit me të cilin shkurorezohet martesë të gjykojë një shumë e caktuar e hollave në emër të ushqimit në barrë të bashkëshortit tjetër, në proporcion me mundësitë e tij (neni 186).²⁰ Me përjashtim nga dispozita e paragrafit 1 të këtij ligji, bashkëshorti ka mundësi që me anë të padisë së veçantë, me afat prej një viti pas pushimit të martesës të kërkojë ushqim vetëm nëse kushtet për ushqim të përcaktuar me nenin 185 të këtij ligji kanë ekzistuar që në momentin e përmbylljes së seancës kryesore të procedurës për shkurorezim të martesës dhe pandërprerë kanë vazhduar deri në përmbylljen e seancës kryesore në procedurën për ushqim (neni 186, paragrafi 2).²¹ E drejta për (mbajtje) ushqim të bashkëshortit të mëparshëm të përmbajtur, zgjatë më së shumti 5 vjet pas shkurorezimit apo anulimit të martesës (neni 189).²² Me kërkesë të bashkëshortit, gjykata mund të vazhdojë të drejtën për ushqim dhe pas kalimit të afatit të paraparë me paragrafin 1 të këtij neni, nëse vërtetohet se për këtë ekzistojnë shkaqe të arsyeshme, e veçanërisht nëse bashkëshorti i përmbajtur edhe pas kalimit të këtij afati nuk do të jetë në gjendje të sigurojë ushqim (neni 189, paragrafi 2).²³ E drejta e bashkëshortit të mëparshëm për ushqim pushon kur të pushojnë kushtet nga neni 185 i këtij ligji, kur të kalojë koha për të cilën është paraparë ushqimi dhe kur bashkëshorti i mëparshëm që pranon ushqiminë do të lidhë martesë të re, gjegjësisht do të hyjë në bashkësi jashtmartesore (neni 191).²⁴ *Menyra e tretë* e shkurorezimit të martesës, mund të inicohet me kërkesën e njërit bashkëshort në rastet kur bashkësia martesore faktikisht ka pushuar së ekzistuari më tepër se një vit.

²⁰ Neni 186, Lf

²¹ Neni 186, paragrafi, 2, Lf

²² Neni 189. Lf

²³ Neni 189, paragrafi, 2, Lf

²⁴ Neni 191, Lf


3.1 Martesa të shkurorëzuara sipas përkatësisë etnike të bashkëshortëve në vitin 2018

| Përkatësia etnike bashkëshortes e | Gjithsej | Përkatësia etnike e bashkëshortit | | | | | | | | |
|-----------------------------------|--------------|-----------------------------------|------------|-----------|------------|----------|-----------|-----------|-----------|-------------|
| | | Maqedon | Shqiptar | Turk | Rom | Vlleh | Sërb | Boshnjak | Të tjerë | Të panjohur |
| Gjithsej | 1 620 | 991 | 401 | 27 | 125 | 3 | 14 | 14 | 41 | 4 |
| Maqedone | 974 | 933 | 4 | 2 | 5 | - | 12 | 1 | 16 | 1 |
| Shqiptare | 372 | 17 | 348 | 2 | - | - | - | 1 | 4 | - |
| Turke | 22 | - | - | 19 | 2 | - | 1 | - | - | - |
| Rome | 122 | 2 | - | 2 | 116 | - | 1 | - | 1 | - |
| Vlleh | 3 | - | - | - | - | 3 | - | - | - | - |
| Sërbe | 15 | 15 | - | - | - | - | - | - | - | - |
| Boshnjake | 15 | - | 2 | 1 | - | - | - | 11 | 1 | - |
| Të tjerë | 93 | 24 | 45 | 1 | 1 | - | - | 1 | 19 | 2 |
| Të panjohur | 4 | - | 2 | - | 1 | - | - | - | - | 1 |

Burimi : “Северна Македонија во бројки, Макстат, 2019”, стр. 18.

Në bazë të të dhënave nga Instituti shtetëror për statistika, në Republikën e Maqedonisë, martesa të shkurorëzuara në bazë të përkatësisë etnike të bashkëshortëve për vitin 2018 gjithsej janë 1620, nga ky numër 991 janë bashkëshort të përkatësisë etnike maqedone, të shkurorëzuar nga 933 gra të përkatësisë etnike maqedone, 401 janë burra shqiptar prej të cilëve 4 janë të shkurorëzuar nga gra të përkatësisë etnike shqiptare, nga ky numër 348 janë të shkurorëzuar me gra të përkatësisë etnike shqiptare, 27 është numri i bashkëshortëve të shkurorëzuar të përkatësisë etnike turke, 125 janë të përkatësisë etnike rome e kështu me rradhë.


3.2 Martesa të shkurorëzuara sipas përkatësisë etnike të bashkëshortëve në vitin 2016



1. Burimi “Статистички годишник на Република Македонија, 2016”.

Sipas statistikave të Institutit shtetëror në Republikën e Maqedonisë në vitin 2016 burra të shkurorëzuar sipas përkatësisë etnike shqiptare janë 27%, të përkatësisë etnike maqedone janë 57% turke 3%, rome 8%, sërbe, boshnjake dhe të panjohur janë 1%.

Gra



2. Burimi : “Статистички годишnik на Република Македонија, 2016”.

Ndërsa sipas statistikave gra të shkurorëzuara të përkatësisë etnike shqiptare janë 25%, të përkatësisë etnike maqedone janë 56%, turke 3%, të përkatësisë etnike rome janë 8%, sërbe 2%, boshnjake 1%, të përkatësive tjera janë 4%.

3.3 Statistika nga martesja të shkurorëzuar në vitet 2012, 2013, 2014, 2015, 2016

| | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 |
|-----------------------------------|--------------|--------------|--------------|--------------|-------------|
| GJITHSEJ | 1 926 | 2 045 | 2 210 | 2 200 | 1985 |
| KOHËZGJATJA E MARTESËS | | | | | |
| DERI 1 VJET | 87 | 99 | 103 | 98 | 93 |
| 1 | 197 | 172 | 175 | 184 | 153 |
| 2 | 144 | 120 | 154 | 153 | 114 |
| 3 | 125 | 144 | 136 | 123 | 127 |
| 4 | 104 | 112 | 122 | 131 | 116 |
| 5-9 | 440 | 439 | 499 | 498 | 454 |
| 10-14 | 280 | 296 | 316 | 338 | 289 |
| 15 DHE MË SHUMË VJET | 549 | 663 | 705 | 675 | 639 |
| MOSHA E BURRIT | | | | | |
| NDËR 20 VJET | 5 | 2 | 7 | 2 | 2 |
| 20-24 | 113 | 105 | 111 | 97 | 83 |
| 25-29 | 259 | 274 | 275 | 274 | 253 |
| 30-34 | 364 | 390 | 371 | 418 | 345 |
| 35-39 | 359 | 375 | 409 | 404 | 357 |
| 40-44 | 313 | 305 | 351 | 327 | 350 |
| 45-49 | 214 | 275 | 285 | 308 | 271 |
| 50 DHE MË SHUMË VJET | 299 | 319 | 401 | 370 | 324 |
| MOSHA E GRUAS | | | | | |
| NDËR 20 ГВЈЕТОДИНИ | 28 | 22 | 20 | 21 | 23 |
| 20-24 | 227 | 230 | 242 | 232 | 193 |
| 25-29 | 356 | 366 | 381 | 380 | 369 |
| 30-34 | 402 | 397 | 408 | 436 | 359 |
| 35-39 | 336 | 398 | 389 | 400 | 344 |
| 40-44 | 241 | 251 | 303 | 293 | 304 |
| 45-49 | 154 | 173 | 220 | 208 | 194 |
| 50 DHE MË SHUMË VJET | 182 | 208 | 247 | 230 | 199 |
| PËRKATËSIA ETNIKE E BURRIT | | | | | |
| MAQEDONE | 1 121 | 1 202 | 1 311 | 1 281 | 1123 |
| SHQIPTARE | 521 | 521 | 504 | 566 | 534 |
| TURKE | 52 | 54 | 50 | 59 | 66 |
| ROME | 136 | 125 | 147 | 171 | 160 |
| VILLEHE | 3 | 2 | 4 | 7 | 4 |
| SËRBE | 23 | 23 | 31 | 30 | 30 |
| BOSHJAKE | 15 | 26 | 36 | 32 | 21 |
| TË TJERË | 55 | 92 | 127 | 54 | 47 |

Duke analizuar të dhënat nga Instituti shtetëror për statistika, varësisht nga kohëzgjatja e martesës, moshës së bashkëshortëve, përkatësisë etnike si dhe varësisht nga numri i përmbajtur i fëmijëve pas shkurorëzimit, nga viti 2012 deri në vitin 2015, numri i rasteve të shkurorëzimit dukshëm është në rritje, ndërsa në vitin 2016 numri i rasteve të shkurorëzimit është zvogëluar.

Në vitin 2012, sipas kozëzgjatjes së martesës, numri më i madh i rasteve të shkurorëzimit është nga kohëzgjatja më shumë se 15 vjet, ku numri i shkurorëzimeve është 549, në vitin 2013 ky numër është rritur në 663, në vitin 2014 gjithashtu kemi rritje të rasteve të shkurorëzimit në 705, ndërsa në dy vitet e fundit, 2015-2016 numri i rasteve të shkurorëzimeve nga kohëzgjatja më shumë se 15 vjet është zvogëluar. Duke marrë si bazë moshën e bashkëshortve, të gjinisë mashkullore, numri i madh i rasteve të shkurorëzimit haset në moshën 50 vjeçare, ndërsa të gjinisë femrore numri më i madh i rasteve të shkurorëzimit haset në moshën nga 30-34 vjeçare dhe 35-39 vjeçare.

3.4 Përkatësia etnike e gruas

| | | | | | |
|---|-------|-------|-------|-------|------|
| MAQEDONE | 1 146 | 1 207 | 1 302 | 1 288 | 1121 |
| SHQIPTARE | 481 | 483 | 492 | 514 | 499 |
| TURKE | 41 | 45 | 47 | 59 | 61 |
| ROME | 138 | 126 | 145 | 167 | 155 |
| VLEHE | 1 | 2 | - | 1 | 1 |
| SËRBE | 12 | 24 | 20 | 26 | 29 |
| BOSHNIJAKE | 14 | 20 | 28 | 25 | 20 |
| TË TJERË | 93 | 138 | 176 | 120 | 99 |
| MARTESA TË SHKURORËZUARA SIPAS NUMRIT TË FËMIJËVE TË PËRMBAJTUR | | | | | |
| PA FËMIJË | 995 | 995 | 1 089 | 1 096 | 963 |
| NJË | 459 | 557 | 587 | 549 | 463 |
| DY | 387 | 386 | 414 | 417 | 399 |
| TRE | 73 | 87 | 87 | 104 | 133 |
| KATËR | 10 | 16 | 27 | 24 | 23 |
| PESË E MË SHUMË | 2 | 4 | 6 | 10 | 4 |

Burimi: “Статистички годишник на Република Македонија, 2016”.

Nëse merret parasysh përkatësia etnike e burrit, në vitin 2012 deri në atë 2014 numri i rasteve të shkurorëzimit të përkatësisë etnike maqedone arrin deri në 1281 raste në vit, ndërsa në vitin 2016 ky numër është zvogëluar pak, në 1123. Të përkatësisë etnike shqiptare gjithashtu nga viti 2014 deri në vitin 2015 arrin deri në 566 raste, ndërsa në vitin 2016 ky numër është zvogëluar në 534 raste të shkurorëzimit. Nga statistikat e Institutit gjithashtu kemi të dhëna edhe për rastet e shkurorëzimit si dhe fëmijët e përmbajtur. Në vitin 2014 deri në vitin 2015, numri i rasteve të shkurorëzimit të martesave pa fëmijë është në rritje edhe atë nga 995 raste në vit deri në 1096 raste në vitin 2015, ndërsa në vitin 2016 ky numër është zvogëluar në 963. Shkurorëzimi i martesave me një fëmijë deri në vitin 2015 arrin në 549 raste në vit, ndërsa në vitin 2016 kemi 463 raste në vit. Numri më i vogël i rasteve është shkurorëzimit i martesave me pesë e më shumë fëmijë të përbashkët, ku në vitin 2012 kemi vetëm dy raste të tilla, në vitin 2013 kemi katër raste, në vitin 2014 kemi gjashtë raste, në vitin 2015 dhjetë raste ndërsa në vitin 2016 kemi katër raste të shkurorëzimit të martesave me pesë e më shumë fëmijë të përbashkët. Nga të gjitha statistikat mund të konkludojmë se secilin vit kemi rritje të numrit të rasteve të shkurorëzimit të martesave.

4. Shkurorëzimi i martesës në të drejtën e krahasuar

Në të gjitha vendet evropiane, çdo ditë është në rritje numri i rasteve të shkurorëzimit të martesës. Ekzistojnë dy sisteme të shkurorëzimit të martesës: monokauzal dhe sistemi pluralist i shkurorëzimit të martesës. Kjo ndarje bëhet varësisht nga ajo se në disa vende si shkaqe për shkurorëzimin e martesës merren parasysh më shumë fakte objektive dhe subjektive, respektivisht arsye për shkurorëzimin e martesës (sistemi pluralist) ose ekziston vetëm një shkak për shkurorëzimin e martesës dhe ajo është dështimi i martesës (sistemi monokauzal). Në vendet evropiane mbizotërojnë sistemet pluralistike, të cilat janë të pranura në Francë, Belgjikë, Luksemburg, Austri, Zvicër, Spanjë, Itali, Portugali, në vendet skandinave (me përjashtim të Suedisë), si dhe në vendet e ish Jugosllavisë. Sistemi monokauzal i shkurorëzimit të martesës është pranuar në Gjermani, Çeki, Holandë dhe Angli.²⁵

4.1 Shkurorëzimi i martesës në ish-shtetet e Jugosllavisë

Para ndarjes së Jugosllavisë nuk ekzistonte një e drejtë familjare e unifikuar, e përbashkët për të gjitha republikat dhe krahinat e saj. Akti themelor juridik i Jugosllavisë, Kushtetuta e RSFJ-së e vitit 1946, vendosi parimet themelore për sjelljen e një të drejte të re familjare në vend, duke i dhënë fund krejtësisht të drejtës familjare të pandarë. Në nenin 24 dhe 26 të Kushtetutës ishin të proklamuar parimet themelore 1) barazia e burrave dhe grave në të gjitha drejtimitet e jetës 2) martesa dhe familja ishin nën mbrojtjen e shtetit 3) shteti rregullonte me ligj marrëdhëniet martesore dhe familjen; 4) e vlefshme ishte vetëm martesa e lidhur para organeve shtetërore; 5) zgjidhja e të gjitha mosmarrëveshjeve martesore ishte nën kompetencën e gjykatave kombëtare; 6) evidenca për të lindurit, të martuarit dhe të vdekurit ishte nën kompetencën e shtetit; 7) prindërit kishin të drejta dhe detyrime të njejtë si ndaj fëmijëve të lindur në martesë ashtu edhe ndaj atyre jashtmartesor; 8) pozita e prindërve me fëmijët jashtmartesor rregullohej me ligj; 9) gruaja në marrëdhënie pune gëzonte mbrojtje të veçantë shtetërore; 10) Shteti ushtronte kujdes të veçantë për interesat e nënës dhe fëmijës duke themeluar shtëpi për fëmijët, kopshte, maternitete. Këto dhjetë parime në Kushtetutën e RSFJ-së ishin edhe konturat themelore për krijimin e të drejtës familjare të Jugosllavisë së periudhës pas mbarimit të luftës²⁶.

²⁵ Љиљјана Спиоровиќ Трпеновска, Дејан Мицковиќ, Ангел Ристов, Семејно Право, Културна Установа Блесок, Скопје, 2013, fq.143.

²⁶ Докмановиќ, Мишо, Право и политика во Македонија (1946 – 1953), ИСИЕ, Скопје, 2010, fq. 252-253

Në të njejtin vit kur ishte sjellë edhe Kushtetuta e RSFJ-së, hyri në fuqi edhe Ligji themelor i martesës. Në të drejtën martesore në periudhën pas luftës brenda Jugosllavisë, martesë e humbi karakterin e saj fetar si dhe u pranua shkurorëzimi i martesës si mënyrë për ndërprerjen e martesës së vlefshme. Në nenin 53 të Ligjit për martesë thuhet se si pasojë e mosmarrveshjes së natyrave, mospërshtatjes ose shoqërimit apo çfarëdo qoftë arsyeja që shpie në prishjen e marrëdhënieve martesore deri në atë shkallë sa jeta e përbashkët është bërë e padurueshme, secili bashkëshort ka të drejtë të kërkojë shkurorëzimin e martesës. Nëse prishja e marrëdhënieve martesore ka ardhur si pasojë e njërit bashkëshort të drejtë të kërkojë shkurorëzim ka vetëm pala tjetër. Në dy nenet e tjera të Ligjit thuhet se gjithashtu bashkëshorti ka të drejtë të kërkojë shkurorëzim në raste të tradhëtise si dhe rastet kur bashkëshorti ka tentuar që t'a privojë atë nga jeta.²⁷ Me ndryshimet kushtetuese të vitit 1963, me të cilat njësitë federale iu dha e drejta që ti rregullojnë të drejtat familjare me ligjet e veta, në vitin 1973 Kuvendi i atëhershëm solli Ligjin për martesë, Ligjin për marrëdhëniet e prindërve dhe fëmijëve, Ligjin për adoptim dhe Ligjin për kujdestari. Me këto ligje ishin të rregulluara të gjitha të drejtat dhe marrëdhëniet familjare. Faktikisht kjo nënkuptonte vazhdimin e sistemit të mëparshëm të drejtësisë.²⁸

4.2 Shkurorëzimi i martesës në legjislacionin e Republikës së Maqedonisë

Me sjelljen e Ligjit për familje në dhjetor të vitit 1992, për herë të parë në Republikën e Maqedonisë është arritur që të bëhet një kodifikim i rregullave që u rrefehohen marrëdhënieve martesore dhe familjare. Kjo nënkupton se në vend të ligjeve të mëparshme- Ligji për martesë, Ligji për marrëdhëniet e prindërve dhe fëmijëve, Ligji për adoptim dhe Ligji i kujdestarisë, hyri në fuqi ligji i cili i rregullon të gjitha çështjet që përfshihen në të drejtën familjare. Rregullimi i marrëdhënieve që lindin nga bashkësia jashtmartesore ishte një nga të rejat më të rëndësishme që ishte e përfshirë në Ligjin për familje dhe që nuk ishte i rregulluar nën kornizat e ligjvënësimit të mëparshëm.²⁹ Në Republikën e Maqedonisë është pranuar sistemi pluralist i shkurorëzimit të martesës, për arsye se në ligjin tonë janë të pranuar më shumë shkaqe të shkurorëzimit: shkurorëzimi për shkak të ndërprerjes faktike të bashkësisë martesore, shkurorëzim me marrëveshjen e ndërsjelltë të bashkëshortëve dhe shkurorëzimi kur marrëdhëniet bashkëshortore janë të prishura deri në atë shkallë sa jeta e përbashkët është bërë e padurueshme.³⁰

²⁷ Пречистен текст на основниот Закон за бракот, Службен Весник на СФРЈ, Белград, 1996, чл.53, 54 и 55.

²⁸ Докмановиќ, Мишо, Право и Политика во Македонија (1946-1953) ИСИЕ, Скопје, 2010 fq. 259,

²⁹ Спиоровиќ-Трпеновска, Лилјана, Phd, Development of Family Law in Macedonia, The International Survey of Family Law 1997, Kluwer Law International, Hague, 1999, fq 232.

³⁰ Дејан Мицковиќ, Ангел Ристов, Закон За Семејството, Скопје, 2015, fq.166

4.3 Shkurorëzimi në vende të ndryshme evropiane

Në gjysmën e dytë të shekullit XX, shkurorëzimi i martesës është futur në të gjitha vendet në Evropë, madje edhe në ato vende ku kishte ndikim të madh kisha katolike, siç janë: Italia, Spanja, Portugalia, Polonia, dhe Irlanda.

Në **Francë**, reforma e fundit e shkurorëzimit të martesës është bërë në vitin 1975. Franca e pranon sistemin pluralist të shkurorëzimit të martesës. Sipas Kodit Civil Frances kushte për shkurorëzimin e martesës janë: faji i bashkëshortit për prishjen e të drejtave dhe detyrimeve martesore, shkurorëzimi me marrëveshjen e ndërsjelltë të bashkëshortëve dhe shkurorëzimi për shkak të prishjes së marrëdhënieve bashkëshortore. Autor i reformës ligjore të vitit 1975 është civilisti i njohur, profesor Zhan Karbonie.³¹ Sistemi i shkurorëzimit të martesës i futur me reformën e vitit 1975 favorizon shkurorëzimin me pëlqimin e përbashkët të bashkëshortëve, duke mos i përfshirë mënyrat tjera të shkurorëzimit. Ligji parasheh dy mundësi për shkurorëzim me pëlqimin e përbashkët të bashkëshortëve edhe atë: 1. Shkurorëzimi kur të dy bashkëshortët sëbashku parashtrajnë kërkesën për shkurorëzim dhe 2. Mënyra tjetër e shkurorëzimit me pëlqimin e përbashkët të bashkëshortëve është kur njëri bashkëshort e parashtron kërkesën për shkurorëzim ndërsa bashkëshorti tjetër e pranon atë. Në rastet kur bashkëshortët bashkërisht parashtrajnë kërkesën për shkurorëzim, gjykatësi është i detyruar vetëm të vërtetojë nëse dëshira e tyre është serioze dhe e lirë, ndërsa palët nuk kanë për detyrë që të tregojnë arsyet për shkak të të cilave ka dështuar martesë. Për të shmangur shkurorëzimet e nxituara dhe të paqëllimshme menjëherë pas lidhjes së martesës, Kodi Civil Francez nuk lejon parashtrimin e kërkesës për shkurorëzim bashkëshortëve me pëlqimin e tyre në gjashtë muajt e parë të lidhjes së martesës. Përveç kësaj, Kodi Civil Francez në nenin 231 parasheh që gjykatësi t'a rishikojë kërkesën sëbashku me bashkëshortët. Në qoftë se palët janë të vendosur për shkurorëzim ata kanë për detyrë që të formulojnë edhe një kontratë me të cilën do t'i rregullojnë të gjitha pasojat që dalin nga shkurorëzimi i martesës në lidhje me rruajtjen dhe edukimin e fëmijëve të përbashkët, si dhe ndarjen e pasurisë së përbashkët pas shkurorëzimit. Përderisa palët nuk mund të merren vesht për rregullimin e këtyre pasojave nga shkurorëzimi i martesës, ata mund të zgjedhin mënyrë tjetër të shkurorëzimit (siç është shkurorëzimi i martesës me kërkesë të njërit bashkëshort të cilën e pranon edhe bashkëshorti tjetër ndërsa pasojat e shkurorëzimit i rregullon gjykatësi).³² Në **të drejtën familjare gjermane**, përveç vdekjes së bashkëshortit, shkurorëzimi është rasti më i rëndësishëm i pushimit të martesës. Fakti se martesë është e lidhur me qëllim afatgjatë, nuk kupton se ajo nuk mund të priset. Martesë mund të shkurorëzohet përderisa ajo ka dështuar ose përderisa më nuk ekziston jetë e përbashkët ndërmjet bashkëshortëve martesor dhe nuk mund të pritet që këto marrëdhënie përsëri të rregullohen³³.

³¹ Дејан Мицковиќ, Ангел Ристов, Семејно Право, Стоби Трејд, Скопје, 2015, fq.166.

³² По ату, fq.168.

³³ Билјана Размоска, доц. Др. Гоце Галев, Ана Баџваровска, Штаудингер, Граѓански законик, Основи на граѓанското право, Скопје, Арс Ламина, 2014, fq.1090.

Pra e drejta gjermane bën pjesë në sistemin monokauzal të shkurorëzimit të martesës, që domethënë se arsye e vetme për shkurorëzimin e martesës është dështimi i saj. Bëhet fjalë për faktin objektiv: sjelljet e papërshtatshme të njërit apo të të dy bashkëshortëve ose faji, nuk luajnë rol të rëndësishëm në pyetjen se a mund të shkurorëzohet martesja. Gjykata duhet të vërtetojë gjendjen momentale dhe të japë mendim për atë gjendje. Duke mos dashur që gjykata të hyjë në marrëdhëniet intime të bashkëshortëve martesor, nën 1565 paragrafi 1 është plotësuar me dy supozime të pakundërshtueshme me të cilat parashihet shkurorëzimi i martesës së dështuar, domethënë, në njërin anë, përderisa bashkëshortët martesor më së paku një vit kanë jetuar të ndarë dhe të dy kanë kërkuar shkurorëzimin e martesës, ose njëri bashkëshort ka miratuar kërkesën e bashkëshortit tjetër (neni 1566 paragrafi 1), në anën tjetër përderisa bashkëshortët martesor kanë jetuar të ndarë më së paku tre vite (neni 1566 paragrafi 2). Në qoftë se nuk ekzistojnë parakushte të tilla, atëherë martesja mund të shkurorëzohet vetëm nëse vërtetohet se martesja ka dështuar.³⁴ Shkurorëzimi i martesës në **Itali** ka një histori interesante, për shkak të ndikimit të madh të kishës Katolike e cila kundërshtonte shkurorëzimin e martesës. Për futjen e shkurorëzimit në sistemin ligjor italian në vitin 1975 ishte mbajtur një referendum ku 59,3% e qytetarëve të cilët votuan përkrahën shkurorëzimin e martesës të paraparë me ligjin e vitin 1970.³⁵ E drejta italiane edhe pse në ligjin 898 të vitit 1970 parasheh raste ku martesja mund të shkurorëzohet për shkak të fajit të njërit bashkëshort, në përgjithësi e pranon sistemin e shkurorëzimit të martesës për shkak të dështimit të saj.³⁶ Në **Spanjë**, shkurorëzimi i martesës, në pajtim me nenin 86 të Kodit civil është i lejuar vetëm me kalimin e afatit të caktuar kohor të jetës së ndarë të bashkëshortëve martesor. Përderisa ekziston marrëveshja e ndërsjelltë e bashkëshortëve martesor për shkurorëzim të martesës, është e nevojshme që së paku të jenë të ndarë një vit, që të mund të paraqesin kërkesë për shkurorëzim. Përveç kësaj, shkurorëzimi nuk mund të kërkohet nëse nga lidhja e martesës kanë kaluar vetëm një vit.³⁷ Kërkesa për shkurorëzim mund të paraqitet pas dy viteve të ndarjes së bashkëshortëve, nëse ekziston marrëveshja e mëparshme për ndarje, ose nëse njëri nga bashkëshortët martesor vërteton se kanë ekzistuar arsye ligjore të parapara për ndarje gjyqësore. Kërkesë për shkurorëzim mund të kërkohet edhe në afat prej dy viteve pas zhdukjes së bashkëshortit. Në të gjitha rastet e tjera, kërkesa për shkurorëzim mund të kërkohet në afat prej 5 viteve nga ndarja e bashkëshortëve martesor.³⁸ Në **Zvicër**, reforma në shkurorëzimin e martesës është bërë në vitin 1998, ndërsa e drejta zvicerane që rregullonte shkurorëzimin ishte më e vjetra në Evropë (nuk ishte ndryshuar nga viti 1907).³⁹ Kusht themelor për shkurorëzimin e martesës është pranimi i konceptit dështim i martesës si arsye themelore për shkurorëzim të martesës, ndërsa marrëveshja e ndërsjelltë e bashkëshortëve për shkurorëzim paraqet indikator themelor për

³⁴ Билјана Размоска, доц. Др. Гоце Галев, Ана Бацваровска, Штаудингер, Граѓански законик, Основи на граѓанското право, Скопје, Арс Ламина, 2014fq.1091

³⁵ Дејан Мицковиќ, Ангел Ристов, Семејно Право, Скопје, 2015, fq.171.

³⁶ По ату, fq.172.

³⁷ По ату, fq.173.

³⁸ По ату, fq.173.

³⁹ Љиљана Спиновиќ Трпеновска, Дејан Мицковиќ, Ангел Ристов, Семејно Право, Скопје, 2013, fq.153.

dështimin e martesës.⁴⁰ Në **Çeki**, gjykata mund të shkurorëzojë martesën, me kërkesën e njërit bashkëshort përderisa marrëdhëniet martesore janë të prishura deri në atë masë saqë nuk është e mundur të pritet bashkëjetesa e mëtutjeshme.⁴¹

5. Procedura për shkurorëzim dhe pasojat e shkurorëzimit

Në procedurë në të cilën gjykata vendos për kontestet familjare, martesore dhe të tjera Ligji për familje zbaton dispozitat e Ligjit për procedurë kontestimore dhe Ligjit për procedurë përmbarese, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.(Neni 222)⁴² Për kërkesat e paraqitura në procedurën për shkurorëzimin e martesës, gjykata vendos në mënyrë meritore me aktgjykim. Në procedurë për shkurorëzimin e martesës, gjykata me aktgjykim mund ta refuzojë kërkespadinë si të pabazuar, ose ta pranojë dhe ta shkurorëzojë martesën.⁴³ Aktgjykimi me të cilin shkurorëzohet martesa ka karakter konstitutiv dhe prodhon efekte juridike jo vetëm në mes palëve, por edhe *erga omnes*. Martesa pushon të ekzistojë jo vetëm ndërmjet bashkëshortëve, por ndaj të gjithëve. Aktgjykimi për shkurorëzimin e martesës vepron ex nunc- nga momenti i plotfuqishmërisë, dhe në të ardhmen.⁴⁴ Dispozitivi i aktgjykimit për shkurorëzimin e martesës mund të përmbajë vetëm një urdhër- se martesa shkurorëzohet, ose të jetë më i ndërlikuar- të përmbajë edhe urdhëra të tjerë. Pikërisht, përveç urdhërit se martesa shkurorëzohet, në aktgjykim mund të përmbahen edhe urdhërat në vijim : a) urdhëri për mbajtjen e fëmijëve të mitur të përbashkët, dhe për besimin e tyre në ruajtje dhe edukim, ndërsa nëse martesa shkurorëzohet me propozim me marrëveshje të bashkëshortëve, në urdhër shënohet marrëveshja e tyre për mbajtjen, ruajtjen dhe edukimin e fëmijëve, b) urdhëri për mbajtjen e bashkëshortit, nëse një kërkesë e tillë është paraqitur në procedurë, c) urdhëri për ndryshimin e mbiemrit të bashkëshortit, nëse një kërkesë e këtillë është paraqitur në procedurë, ç) urdhëri për shpënzimet e procedurës.⁴⁵ Aktgjykimin e plotfuqishëm për shkurorëzimin ose anulimin e martesës, gjykata e parashton deri tek organi i administratës, kompetent për mbajtjen e librit amzë të të shkurorëzuarve, më së voni në afat prej 30 ditësh, me qëllim të regjistrimit të ndryshimeve, si dhe deri te Qendra për punë sociale, në qoftë se gjatë martesës kanë fëmijë të mitur ose fëmijë mbi të cilët është vazhduar e drejta prindore (neni 43).⁴⁶

⁴⁰Për më shumë, leho po aty, Љиљана Спиrowиќ Трпенoвска, Дејан Мицковиќ, Ангел Ристов, Семејно Право, Скопје, 2013, fq.153, 154.

⁴¹Po aty, fq.154.

⁴² Neni 222, Lf

⁴³ Dr. Arsen Janevski, Dr. Tatjana Zoroska-Kamilovska, E drejta procedurale civile, Shkup, 2009, fq.453.

⁴⁴Po aty, fq.453.

⁴⁵Po aty, fq.454.

⁴⁶ Neni 43, Lf

5.1 Pasojat e shkurorëzimit të martesës

Shkurorëzimi i martesës edhe pse në disa raste mund të jetë ilaçi më i mirë, kur marrëdhëniet martesore janë të prishura deri në atë shkallë sa jeta e përbashkët është bërë e padurueshme, megjithatë sjell pasoja si ndaj bashkëshortëve ashtu edhe ndaj fëmijëve, pasoja që ndikojnë në jetën dhe zhvillimin e tyre të mëtejshëm. Fëmijët janë viktima më e madhe e shkurorëzimit të martesës. Në krahasim me fëmijët e tjerë, fëmijët, prindët e të cilëve janë të shkurorëzuar kanë probleme të mëdha edukative, psiko-sociale dhe arsimore. Këtë gjë e kanë vërtetuar edhe shumë hulumtime të bëra në mbarë botën. Ata kanë sjellje më agresive, impulsive dhe antisociale si dhe më shumë probleme në marrëdhënien me prindërit e tyre. Fëmijët që e përjetojnë shkurorëzimin e prindërve në moshë më të re kanë mundësi më të mëdha që të kenë probleme. Ndërsa fëmijë të tjerë të familjeve të shkurorëzuara, bëhen “elastikë” apo të aftë të stabilizojnë gjendjen e tyre, veçanërisht nëse prindërit e tyre bëjnë një punë të mirë dhe të arsyeshme në menaxhimin e stresit të shkurorëzimit. Si grup, fëmijët që përjetojnë shkurorëzimin e prindërve të tyre, janë fëmijë normal që e kalojnë traumën e shpërbërjes së familjes dhe përgjigjen sipas moshës së pjekurisë së tyre në kohën e shkurorëzimit. *American Board of Family Medicine* i ka ndarë përjetimet e fëmijëve ndaj shkurorëzimit sipas periudhave të zhvillimit të tyre. Parashkollorët kuptojnë që nëna dhe babai i tyre nuk jetojnë më së bashku, ndihen të braktisur, reagojnë duke ruajtur objektet e tyre të sigurisë, nuk mund të kontrolljnë zemërimin Ata priren të vetë-fajësohen. Fëmijët e shkollës fillore kanë një problem të pa shprehur, sepse i duan të dy prindërit dhe dëshirojnë që të dy prindërit t'i duan ata. Ata fantazojnë lidhur me ribashkimin e prindërve të tyre. Fëmijët e moshës shkollore më të rritur 9-12 vjeç, janë më të mbyllur dhe më të zemëruar, madje dhe më të njëanshëm. Ata e shohin botën bardh e zi, të drejtë dhe të gabuar, dhe mbajnë anën e njërit prind ndaj prindit tjetër. Shpeshherë ankohen për dhimbje koke, dhimbje stomaku, dhimbje gjoksi dhe pagjumësi. Fëmijët në këtë moshë manifestojnë sjellje delikvente si; vjedhje të vogla, gënjeshtër, manipulime. Performanca në shkollë e tyre bie në mënyrë të menjëhershme. Adoleshenca shfaq përjetime kontradiktore. Ndërsa fëmijët e kësaj moshe në njërin anë nuk janë në të vërtetë të pavarur, ata kërkojnë të jetojnë jetën e tyre, të kenë shtëpinë e tyre dhe madje urrejnë që prindërit të jenë në shtëpi bashkë me ata. Në këtë moshë, ata nuk duan të shqetësohen nga jeta e prindërve të tyre, që është shkatërruar nga shkurorëzimi dhe më së shumti jepen pas seksit, drogës dhe alkoolit. Adoleshentët posedojnë më shumë njohuri rreth shkurorëzimit në terma konjitiv, por përsëri janë emocionalisht të pa maturuar. Ata mund të shprehin zemërim, janë agresivë dhe protektivë. Ata gjithashtu mund të bëhen ankthiozë dhe depresivë. Adoleshentët me prindër të ndarë janë më të prirur të abuzojnë me substanca narko-alkoolike dhe të thyejnë ligjin. Reaksionet e shkurorëzimit në fëmijëri shfaqen edhe në moshë të rritur. Të rriturit që kanë përjetuar shkurorëzim, kanë më pak shanse të shkollohen dhe më shumë mundësi të mbesin të pa punë. Ata janë më të prirur të kenë probleme komunikimi me prindërit, vëllezërit apo motrat dhe kanë më shumë vështirësi të krijojnë marrëdhënie martesore. (ABFM 2001).⁴⁷

⁴⁷https://www.medscape.com/viewarticle/405852_6, 4/20/2019,11:45.

Kapitulli II

Kuptimi i së drejtës prindore

1. Marrëdhëniet e prindërve dhe fëmijëve

E drejta prindore si pjesë përbërëse më e rëndësishme e të drejtës familjare është tërësi normash juridike me të cilën rregullohen marrëdhëniet midis prindërve dhe fëmijëve të tyre qofshin ato martesor, jashtmartesor apo të adoptuar si edhe marrëdhëniet midis personave të tjerë në gjini. Këto marrëdhënie krijohen nga lindja e fëmijës në marrëdhëniet martesore apo jashtmartesore ose adoptimi i fëmijës dhe zgjasin deri në arritjen e moshës madhore të fëmijës, me lidhjen e martesës së fëmijës para arritjes së moshës madhore (emancipimi), me adoptimin e fëmijës dhe me vdekje. Ka raste kur e drejta prindore edhe pse fëmija ka mbushur moshën madhore mund të vazhdohet, këto shkaqe janë të parapara në ligj. Marrëdhëniet në familje krijohen në bazë të barazisë, respektit të ndërsjelltë, ndihmës dhe mbajtjes reciproke si dhe mbrojtjes së interesave të fëmijëve të mitur.⁴⁸ Pra marrëdhëniet prindore nënkuptojnë të drejtat dhe detyrimet që krijohen ndërmjet prindërve dhe fëmijëve. Prindërit ndaj fëmijëve kanë të drejta të barabarta, të drejta prindore. Ato kujdesen për rruajtjen, rritjen, edukimin, arsimimin e fëmijëve të tyre, si dhe përkujdesen për zhvillimin e aftësive dhe shprehive të tyre punuese. Për këtë shkak në të drejtën bashkëkohore të shumë shteteve gjithnjë e më shumë në vend të termit “e drejtë prindore” pranohet termi “përgjegjësi prindore”, gjithashtu ky term përdoret edhe në Konventën për të drejtat e fëmijëve si njëri nga dokumentet më të rëndësishme ndërkombëtare që rregullon të drejtat e fëmijëve. Mirëpo në vendin tonë, në Ligjin për familje ende përdoret termi e drejtë prindore. Megjithatë konsiderojm se ky term duhet të ndryshohet dhe në vend të tij të përdoret termi përgjegjësi prindore, pasi në marrëdhëniet familjare bashkëkohore për dallim nga kohërat e vjetra të gjithë antarët e familjes konsiderohen si subjekt të drejtpërdrejtë të së drejtës, përfshirë edhe fëmijët. Për këtë qëllim preferohet të përdoret termi përgjegjësi prindore, sepse në të drejtën bashkëkohore pranohet koncepti se prindërit janë përgjegjës që të sjellin vendime të rëndësishme në lidhje me fëmijët e tyre, gjithmonë në interes të mirë të fëmijës, pasi edhe fëmijët janë subjekt aktiv të së drejtës, nuk janë më persona pasiv, në mbrojtje dhe të varur nga prindërit e tyre ashtu siç ishte në të kaluarën. Sipas preambulës së Konventës për të drejtat e fëmijëve Neni 1: **“me fëmijë nënkuptohet çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç, me përjashtim të rasteve kur mosha madhore arrihet më përpara, në përputhje me ligjet të cilave ai u nënshtrohet”**. Duke konsideruar se fëmija, për shkak të papjekurisë së tij fizike dhe intelektuale, ka nevojë për një mbrojtje dhe kujdes të veçantë, veçanërisht për mbrojtjen e duhur juridike, si para ashtu edhe pas lindjes, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara me rezolutën 1386 të datës 20 nëntor viti 1959 shpall këtë deklaratë për të Drejtat e fëmijës me qëllim që fëmija të gëzojë një fëmijëri të lumtur dhe të përfitojë në interesin e tij ashtu sikurse dhe në interesin e shoqërisë, të drejtat dhe liritë që janë formuluar aty, duke i ftuar prindërit, burrat dhe gratë si individë dhe si organizatat e vullnetit

⁴⁸ Neni 3, Lf.

të mirë, autoritetet, lokale dhe qeveritë kombëtare t'i njohin këto të drejta dhe të përpiqen të sigurojnë respektimin e tyre nëpërmjet masave ligjore dhe masash të tjera që do të miratohen gradualisht në zbatimin e parimeve të mëposhtme: *Parimi i parë*: Fëmija duhet të gëzojë të gjitha të drejtat e formuluar në këtë Deklaratë. Këto të drejta duhet t'u njihen të gjithë fëmijëve pa asnjë përjashtim dhe pa asnjë dallim dhe diskriminim të bazuar në racë, ngjyrë, gjini, gjuhë, opinion politik tjetër, origjinën kombëtare apo shoqërore, pasurinë, lindjen apo ndonjë situatë tjetër qoftë kur kjo ka të bëjë me vetë fëmijën osë familjen e tij. *Parimi i dytë*: Fëmija duhet të gëzojë mbrojtje të veçantë dhe t'i jepen mundësi dhe lehtësira nëpërmjet ligjit dhe me mjete të tjera, me qëllim që të zhvillohet në mënyrë të shëndetshme dhe normale në planin fizik, intelektual, moral, shpirtëror dhe shoqëror, në kushte lirie dhe dinjiteti. Kur miratohen ligje për këtë qëllim, si kriter përcaktues duhet të jetë interesi më i lartë i fëmijës. *Parimi i tretë*: Fëmija ka të drejtë, qysh prej lindjes, për një emër dhe për një shtetësi. *Parimi i katërt*: Fëmija duhet të përfitojë nga sigurimi social, ai duhet të ketë mundësi të rritet dhe të zhvillohet në mënyrë të shëndetshme. Fëmija ka të drejtë për ushqim, strehim, argëtim dhe përkujdesje të duhur mjekësore.⁴⁹ *Parimi i pestë*: Fëmija i pazhvilluar sa duhet fizikisht, mendërisht dhe nga pikëpamja shoqërore duhet të gëzojë trajtimin, edukimin dhe përkujdesjen e veçantë që kërkon gjendja ose pozita e tij. *Parimi i gjashtë* : Për zhvillimin e harmonishëm të personalitetit të tij, fëmija ka nevojë për dashuri dhe mirëkuptim. Ai duhet, sa të jetë e mundur, të rritet nën përkujdesjen dhe përgjegjësinë e prindërve dhe gjithsesi, në një atmosferë ngrohtësie dhe sigurie morale e materiale, përveç rrethanave të jashtëzakonshme, fëmija në moshë të vogël nuk duhet të ndahet nga nëna. *Parimi i shtatë*: fëmija ka të drejtën e arsimimit falas dhe të detyrueshëm së paku në nivelin fillor. Ai duhet të marrë një edukim që të kontribuojë në kulturën e tij të përgjithshme dhe t'i lejojë atij, në kushtet e barazisë së mundësive, të zhvillojë aftësitë e tij, gjykimin personal dhe ndjenjën e tij të përgjegjësisë morale dhe shoqërore si dhe të bëhet anëtar i dobishëm i shoqërisë. Ata që merren me edukimin dhe orientimin e fëmijës në jetë duhet të udhëhiqen nga interesi i tij më i lartë; kjo përgjegjësi më së pari u bië prindërve. *Parimi i tetë*: Fëmija, në çdo rrethanë, duhet të jetë ndër të parët që i jepet mbrojtje dhe ndihmë. *Parimi i nëntë*: Fëmija duhet të mbrohet kundër të gjitha formave të pakujdesisë, egërsisë dhe të shfrytëzimit si dhe ai nuk duhet të bëhet objekt i asnjë lloji tregtimi. Fëmija nuk duhet të punësohet pa arritur moshën minimale të përshtatshme, nuk duhet, në asnjë rast, të shtrëngohet apo të lejohet të bëjë një punë që dëmton shëndetin apo edukimin e tij, ose që pengon zhvillimin e tij fizik, mendor apo moral; *Parimi i dhjetë*: Fëmija duhet të mbrohet kundër praktikave që çojnë në diskriminimin racial, fetar apo çdo formë tjetër diskriminimi. Ai duhet të rritet në një frymë mirëkuptimi, tolerance, miqësie midis popujve dhe vëllazërie të përgjithshme, dhe me ndjenjën se duhet t'ia përkushtojë energjinë dhe talentin e tij të shërbimit të gjithë atyre që janë si ai.⁵⁰

⁴⁹ Pwrmbledhje e instrumenteve nderkombetare, Tw drejtat e njeriut, Kombet e bashkuara, New York dhe Gjenevë, 1994, fq.218.

⁵⁰ Po aty, fq.219

2. E drejta prindore sipas Ligjit për familje të Republikës së Maqedonisë

Të drejtën prindore e përbëjnë të drejtat dhe obligimet e prindërve dhe fëmijëve për tu përkujdesur për personalitetin, të drejtat dhe interesat e fëmijëve të tyre të mitur dhe fëmijëve mbi të cilët ka vazhduar e drejta prindore. E drejta prindore i takon si nënës ashtu edhe babait në mënyrë të barabartë. Në qoftë se njëri nga prindërit ka ndërruar jetë ose nuk është i njohur ose i është marrë e drejta prindore ose është penguar që të ushtrojë të drejtën prindore atëherë të drejtën prindore e ushtron prindi tjetër. E drejta prindore në të drejtën tonë është e themeluar duke u mbështetur në disa parime themelore të cilat janë të parapara në Kushtetutë, Konventa ndërkombëtare dhe në Ligjin për familje, parime në bazë të të cilave rregullohen marrëdhëniet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve.⁵¹ Parimi i parë është parimi i cili kërkon mbrojtjen e veçantë të fëmijëve, të miturve, fëmijëve pa prindër dhe fëmijëve pa përkujdesje prindore. Këto kategori të personave gëzojnë mbrojtje të veçantë të parapara në korniza kushtetuese. Shteti gjithashtu përkujdeset për përmbushjen e detyrimeve të prindërve ndaj fëmijëve pa prindër dhe fëmijëve pa përkujdesje prindore. Parimi i dytë i cili ka të bëjë me ushtrimin e drejtë të së drejtës prindore që nënkupton se prindërit kanë të drejta dhe obligime të ndara si dhe vendosin për të gjitha pyetjet lidhur me fëmijët e tyre. Parimi i barazisë së fëmijëve martesor dhe jashtmartesor, e paraparë edhe në Kushtetutë, që nënkupton atë se fëmijët e lindur në martesë dhe fëmijët jashtmartesor janë të barabartë sa u përket të drejtave dhe obligimeve që kanë prindërit si dhe organet shtetërore ndaj tyre. Parimi në interes të mirë të fëmijës që është një nga parimet më të rëndësishme i pranuar në familjet bashkëkohore. Në Ligjin për Familje ky parim nuk është i theksuar qartë mirëpo kjo është e paraparë në Konventën për të drejtat e fëmijëve të cilën e ka ratifikuar edhe Maqedonia.⁵² Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë në **Nenin 40** i siguron kujdes dhe mbrojtje të veçantë familjes. Marrëdhëniet juridike në martesë, familje dhe bashkësinë jashtëmartesore rregullohen me ligj. Prindërit kanë të drejtë dhe detyrë që të kujdesen për mbajtjen dhe edukimin e fëmijëve. Fëmijët kanë për detyrë që të kujdesen për prindërit e moshuar dhe të pamundur. Republika u siguron mbrojtje të veçantë fëmijëve pa prindër dhe fëmijëve pa kujdes prindëror. **Neni 41** “ Është e drejtë e njeriut që lirisht të vendosë për të pasur fëmijë. Republika, me qëllim të zhvillimit të harmonizuar ekonomik dhe social, udhëheq një politikë humane të popullimit”. **Neni 42** Republika veçanërisht i mbron amësinë, fëmijët dhe personat e mitur. Personi më i ri se 15 vjeç nuk mund të punësohet. Personat e mitur dhe nënat kanë të drejtë në mbrojtje të veçantë gjatë punës. Personat e mitur nuk guxojnë të punësohen në vendet e punës, të cilat janë të dëmshme për shëndetin dhe moralin e tyre.⁵³

⁵¹ Дејан Мицковиќ, Ангел Ристов, Семејно Право, Стоби Трејд, Скопје, 2015, fq.198.

⁵² По ату, fq.199.

⁵³ <https://www.sobranie.mk/content/ustav%20al/ustav%20rsm-al-ok.pdf> 18.01.2020 10:06

3. E drejta prindore në legjislacionet bashkëkohore

Karakteristikat e përgjithshme të sistemeve juridike familjare në të gjitha vendet evropiane nga shekulli XVII deri në shekullin XX ishin shumë të ngjashme. Është konsideruar se martesë zgjat deri në vdekjen e bashkëshortëve martesor, ndërsa shkurorëzimi lejohej vetëm në rastet të prishjes së tërësishme të lidhjes martesore. Për një kohë të gjatë pushteti i burrit ka qenë dominant në sistemet juridike familjare të vendeve të ndryshme evropiane. Një nga transformimet më me vlerë në të drejtën familjare ishte reforma që u bë në të drejtën e shkurorëzimit të martesës në gjysmën e dytë të shekullit XX. Të gjitha shtetet evropiane filluan hap pas hapi ta pranojnë konceptin se martesë mund të shkurorëzohet në qoftë se paraqiten rrethana të cilat e vështirësojnë jetën e përbashkët bashkëshortore, pa mos e parashtruar pyetjen se cili nga bashkëshortët është fajtor për prishjen e martesës, siç ishte në kohërat e mëparshme. Një nga karakteristikat e përgjithshme të së drejtës familjare bashkëkohore është se ajo tashmë nuk fokusohet në bashkëshortët martesor po rëndësi të veçantë ka e drejta prindore.

Ndryshim që nuk pranohet në të gjitha legjislacionet evropiane është tendenca që e drejta prindore të ushtrohet bashkërisht nga të dy prindërit edhe pse ata janë të ndarë. Pra në të drejtën familjare bashkëkohore në vend të termit pandashmëria e lidhjes që ekziston në mes të bashkëshortëve martesor, pranohet koncepti se të pandashëm janë vetëm prindërit. Në bazë të këtij ndryshimi gjithnjë e më shumë legjislacione parashohin se të drejtën prindore e ushtrojnë të dy prindërit edhe pas shkurorëzimit të martesës. Ushtrim i së drejtës prindore nga të dy prindërit është gjithnjë në interes të mirë të fëmijës. Secili nga prindërit ka përgjegjësi që të ushtrojë të drejtën prindore dhe të ja mundësojë edhe prindit tjetër të ushtrojë atë të drejtë pa kufizime. E drejta e ushtrimit të së drejtës prindore nga ana e të dy prindërve edhe pas ndërprerjes të jetës së përbashkët bashkëshortore mbështetet edhe në konventat ndërkombëtare, si një nga më të rëndësishmet është Konventa për të drejtat e fëmijëve **neni 18 paragrafi 1** në të cilën parashihet se “ Shtetet palë përpiqen me të gjitha mundësitë, për të siguruar njohjen e parimit, sipas të cilit të dy prindërit kanë përgjegjësi të përbashkët për edukimin dhe zhvillimin e fëmijës. Përgjegjësinë kryesore për edukimin dhe zhvillimin e fëmijës e kanë prindërit, ose sipas rastit, përfaqësuesit e tij ligjor. Ata duhet të udhëhiqen, në rradhë të parë, nga interesi më i lartë i fëmijës. **Neni 18 paragrafi 2** “ Për të garantuar e zhvilluar të drejtat e përmendura në këtë Konventë, shtetet palë u japin ndihmën e duhur prindërve dhe përfaqësuesve ligjorë të fëmijës, në ushtrimin e përgjegjësisë, të cilat u bien atyre për arritjen e fëmijës dhe sigurojnë ngritjen e institucioneve, qendrave ose shërbimeve të kujdesit për fëmijë.⁵⁴

⁵⁴ Pwrmbledhje e instrumenteve ndërkombëtare, Tw drejtat e njeriut, Kombet e bashkuara, New York dhe Gjenevw, 1994, fq.229

4. Përmbajtja e përgjegjësisë prindore në të drejtën krahasuese (Join Custody)

Në dekadat e fundit janë bërë ndryshime shumë të rëndësishme në përmbajtjen e të drejtës prindore, të cilat në rend të parë vendosin detyrimet dhe jo të drejtat e prindërve siç ishte në të kaluarën. Përveç kësaj, reformat në lidhje me mënyrën e rregullimit të marrëdhënieve ndërmjet prindërve dhe fëmijëve i kushtojnë rëndësi të veçantë nevojave, interesave dhe dëshirave të fëmijëve. Koncepti i ri për të drejtat dhe detyrimet e prindërve, i cili para se gjithash bazohet në detyrimet e tyre ndaj fëmijëve, gradualisht solli edhe ndryshime të termeve që përdorën për të drejtat dhe detyrimet e prindërve. Më parë, në shumë vende të Evropës, është përdorur termi pushteti atëror nga vetë fakti se të gjitha prerogativat në lidhje me fëmijët në masë më të madhe i përkisnin babait. Më vonë, me përmirësimin e të drejtave dhe statusit shoqëror të grave si dhe me mundësinë që edhe nëna të paraqitet si bartës i të drejtave ndaj fëmijëve, filloi që të përdoret termi pushteti prindëror ose autoriteti prindëror. Në disa vende, për të drejtat dhe detyrimet e prindërve përdoret termi e drejtë prindërore (ashtu sikur përdoret edhe në të drejtën tonë familjare). Megjithatë, vitet e fundit, një numër i madh i dokumentave ndërkombëtare si dhe ligjvënësit nacional e përdorin termin përgjegjësi prindore. Kjo nuk është vetëm ndryshim terminologjik por nënkupton transformim të vërtetë të rregullimit të marrëdhënieve ndërmjet prindërve dhe fëmijëve. Ky ndryshim shpreh edhe qëndrimin e ligjvënësve bashkëkohor se në rend të parë janë detyrimet dhe jo autorizimet e prindërve ndaj fëmijëve të tyre. Me përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve ndërmjet prindërve dhe fëmijëve të tyre, në të drejtën evropiane janë të pranishme dy koncepte të ndryshme. Sipas konceptit të parë, i cili gradualisht është duke u braktisur, parashihet detyrimi që fëmijët ti ndëgjojnë urdhërat e prindërve të tyre.⁵⁵ Ky koncept është i paraparë në Çeki, Zvicër, Itali dhe në disa shtete të tjera evropiane. Për dallim nga ky koncept, në një numër të madh të shteteve parashihet se ekziston detyrim i të gjithë anëtarëve të familjes që të respektohen dhe të ndihmohen ndërmjet veti. Ky koncept është i pranuar edhe në të drejtën familjare të Republikës së Maqedonisë, në të cilin parashihet se marrëdhëniet në familje janë të themeluara në bazë të barazisë, respektit dhe ndihmës reciproke. Në *Francë*, me ndryshimet e Kodit Civil Frances, më 4 Mars të vitit 2002, termi autoritet prindëror zëvendësohet me termin përgjegjësi prindore, e cila nënkupton një sërë të drejtash dhe detyrimesh të prindërve, qëllimi i vetëm i të cilave është interesi i fëmijëve. Ky koncept i përfshin disa aspekte, duke përfshirë kujdesin dhe mbrojtjen, mbajtja e marrëdhënieve personale, përcaktimin e vendbanimit të fëmijës, edukimin e fëmijës, përfaqësimi ligjor, mbajtja (ushqimia) e fëmijës, administrimi i pasurisë dhe përgjegjësia civile e prindërve për dëmet e shkaktuara nga fëmija i tij. **Kujdesi dhe mbrojtja**-Funksioni themelor i përgjegjësisë prindërore është mbrojtja. Dispozitat juridike franceze kërkojnë që prindërit të mbrojnë sigurinë, shëndetin dhe moralin e fëmijës. **Mbajtja e marrëdhënieve personale**- midis prindërve dhe fëmijëve, nuk është e thënë shprehimisht në Kodin Civil Francez, përveçse kur ka të bëjë me shkurorëzimin ose ndarjen e prindërve edhe nëse prindërit ndahen dhe vetëm njëri prej tyre mban përgjegjësinë prindore, prindi tjetër ka të drejtë dhe detyrim që të ruaj marrëdhëniet personale me

⁵⁵ Дејан Мицковиќ, Ангел Ристов, Семейно Право, Скопје, 2015, fq.244

fëmijën. “ Babai dhe nëna do të mbajnë marrëdhënie personale me fëmijën, si dhe do të respektojnë lidhjen midis fëmijës dhe prindit tjetër” (Art. 373-2 para. 2 French CC). **Përcaktimi i vendbanimit të fëmijës**-Lejohet që bashkëshortët të kenë vendbanime të ndara vetëm nëse kjo nuk dëmton dispozitat ligjore në lidhje me komunitetin e të jetuarit. (Art. 108 French CC). Bashkëshortët do të përaktojnë vendbanimin e familjes ku do të jetojnë edhe fëmijët e tyre. (Art. 215 para. 2 French CC).Vendbanimi i fëmijës së mitur, që nuk është i emancipuar është në vendbanimin e prindërve të tij.(Art. 108-2 French CC). **Edukimi i fëmijës** -Secili prind duhet të kontribuojë në edukimin dhe mbështetjen e fëmijëve, duke pasur parasysh mjetet që mund të ofrojnë ato në proporcion me nevojat e fëmijëve. Edukimi përfshin disa aspekte edhe atë arsimin shkollor dhe studime, edukimin moral, orientimin profesional si dhe edukimin fetar. (Art. 371-2 French CC). **Përfaqësimi ligjor dhe mbajtja (ushqimia) e fëmijës**- Prindërit kanë të drejtë dhe detyrim të përfaqësojnë fëmijët e tyre si dhe të sigurojnë mjete për përmbajtjen e tyre (ushqiminë). Prindërit janë përfaqësues ligjor të fëmijëve të tyre të mitur nëse prindërit gëzojnë përgjegjësinë prindore. Nëse prindërit gëzojnë përgjegjësinë prindore ata të dy përfaqësojnë fëmijët në të gjitha veprimtaritë juridike, përveç atyre rasteve kur ligji lejon që fëmija i mitur të veprojë në emër të vet. Nëse vetëm njëri prind gëzon përgjegjësinë prindore, ai prind është përfaqësues i vetëm ligjor. (Art. 389 para. 2 French CC).⁵⁶ Në *Gjermani*, kohëve të fundit gjithnjë e më shumë përdoret termi përgjegjësi prindore, ndërsa në ligj ende përdoret termi kujdestari prindore, që nënkupton kujdesi i prindërve për personalitetin dhe për pasurinë e fëmijës. Prindërit janë të detyruar që të kujdesen për mirëqenien fizike, psiqike dhe atë shpirtërore të fëmijëve. Në të drejtën gjermane kujdes të veçant i kushtohet respektimit të dëshirave dhe interesave të fëmijëve. Përgjegjësia prindore ndërpritet me arritjen e moshës madhore, adoptimin dhe me vdekjen e prindit ose të fëmijës. Lidhja e martesës nga ana e fëmijës së mitur nuk nënkupton automatikisht edhe ndërprerjen e përgjegjësisë prindore mirëpo ngelet detyrim i prindit që ta përfaqësojë fëmijën.⁵⁷ Në *Itali*, ligjvënësi e përdor termin autoriteti prindëror, ndërsa në teori vazhdon të përdoret termi përgjegjësi prindore. Prindërit kanë autoritet prindëror që të sigurojnë mirëqenie morale dhe materiale të fëmijëve të mitur. **Kujdesi dhe mbrojtja**-Përgjegjësia prindore përfshin fuqinë për të marrë të gjitha vendimet e nevojshme që fëmijës i sigurohet kujdes dhe mbrojtje e nevojshme. Në Kushtetutën e Italisë, në nenin 30, parashihet se prindërit kanë për detyrim të kujdesen për përmbajtjen, edukimin dhe t’u sigurojnë fëmijëve të tyre zhvillim moral, ndërsa në nenin 147 të Kodit Civil italian parashihet detyrimi i prindërve që ti marrin parasysh mendimet dhe ambiciet e fëmijëve gjatë ushtrimit të përgjegjësisë prindore. Detyra e prindërve për ti mbështetur fëmijët është një nga detyrimet e ndihmës materiale. Kjo nënkupton plotësimin e nevojave të zakonshme të fëmijës, në përputhje me kushtet materiale të familjes. Këto detyrime të mbështetjes materiale nuk janë të kufizuara vetëm në përmbushjen e nevojave themelore të të miturit por edhe çdo shpenzim tjetër të nevojshëm për zhvillimin e fëmijës. **Mbajtja e marrëdhënieve personale**- Përgjegjësia prindore nënkupton gjithashtu edhe mbajtjen e marrëdhënieve personale intenzive dhe të vazhdueshme të prindit me të miturin, për të kaluar

⁵⁶ <http://ceflonline.net/wp-content/uploads/France-Parental-Responsibilities.pdf> 07/04/2020, 10:00.

⁵⁷ <http://ceflonline.net/wp-content/uploads/Germany-Parental-Responsibilities.pdf> 08/04/2020 12:00

kohë me të ose për të siguruar kujdes dhe vëmendje, gjithmonë duke pasur parasysh nevojat morale dhe materiale të fëmijës. Të jetosh me të miturin sipas sistemit juridik italian është një nga atributet e përgjegjësisë prindore. Sidoqoftë prindi që nuk jeton me fëmijën ka të drejtë që të mbajë marrëdhënie personale me fëmijën (e ashtuquajtura e drejta e vizitës). **Edukimi**-Detyrimi i ndihmes morale përfshijnë edhe edukimin e fëmijës. **Përfaqësimi ligjor**- Duke ndjekur të gjitha interesat e fëmijës, prindërit që ushtrojnë përgjegjësinë prindore kanë të drejtë dhe detyrim të përfaqësojnë fëmijët e tyre si dhe të menaxhojnë me pasurinë e tyre. **Përcaktimi i vendbanimit**-Autoriteti prindëror nënkupton fuqinë e prindërve për të përcaktuar vendbanimin e të miturit. Sepse në sistemin juridik italian, vendbanimi i të miturit është i njëjtë me vendbanimin e familjes. Përgjegjësia prindore nënkupton gjithashtu se prindërit do të jetojnë me të miturin. **Administrimi me pasurinë**- Përgjegjësia prindore përfshin të drejtën dhe detyrën për të përfaqësuar fëmijën dhe të admistrojë me pronën e tij. Nëse përgjegjësinë prindore e ushtrojnë bashkërisht të dy prindërit, atëherë secili prind mund individualisht të bëjë akte të zakonshme të disponimit me pronën e tij. Në bazë të Kodit Civil italian, përgjegjësia prindore nuk ndërpritet as me shkurorëzim të martesës as më anulimin e saj, as nëse vetëm njëri prind ushtron kujdestarinë prindore. Nëse vetëm njëri prind jeton me fëmijën është e mundshme të dallohet ushtrimi i përgjegjësive të prindit tjetër. Ligji parashikon tre lloje të ndryshme të kujdestarisë: kujdestarinë ekskluzive, kujdestarinë e përbashkët dhe kujdestarinë alternative dhe kështu siguron modalitete të diferencuara për ushtrimin e përgjegjësive prindore. Nëse ekziston ndonjë shkak i arsyeshëm, gjykatësi mund të urdhërojë të miturin të jetojë me një palë të tretë ose në një institut për arsim. Përgjegjësia prindore ndërpritet me vdekjen e fëmijës ose prindit, me arritjen e moshës madhore ose me lidhjen e martesës, e cila lejohet vetëm me arritjen e moshës 16 vjeçare.⁵⁸ Në *Suedi* e drejta autonome nuk përdor termin përgjegjësi prindore. Në vend të kësaj ligji suedez bën dallimin midis dy koncepteve:**kujdestarisë** dhe **mbikëqyrjes**. Në të drejtën suedeze, kujdestaria i referohet përgjegjësive ligjore që ka një kujdestar ndaj nevojave personale të fëmijës. **Kujdestaria** gjithashtu përfshin edhe detyrën për të siguruar që fëmijëve u është dhënë kujdes mbrojtje dhe edukim i mirë. Kujdestari ka përgjegjësi të shohë që fëmija është i ruajtur. Në punët personale kujdestari përfaqëson fëmijën si dhe përcakton vendbanimin e fëmijës. Kujdestaria përfshin kujdesin aktual të fëmijës, do të thotë që kujdestari jeton më fëmijën dhe kujdeset për të. Ndërsa me **mbikëqyrësi** ligjvënësi i referohet përgjegjësisë për administrim me pasurinë e fëmijës si dhe përfaqësimin juridik të fëmijës në lidhje me procedurat ligjore që i referohen pasurisë (Kapitulli 10, 11 dhe 13 Kodi Suedez i Prindërve dhe Fëmijëve). Pra, prindërit janë edhe kujdestarët edhe mbikëqyrësit e fëmijëve të tyre. Nëse kujdestaria transferohet nga njëri ose nga të dy prindërit tek një ose më shumë kujdestar të caktuar edhe ato bëhen mbikëqyrës të fëmijës. Mbikëqyrësi është i detyruar gjatë përcaktimit të kapitalit të duhur të nevojshëm për arsimim dhe shpenzime të tjera të ketë në konsideratë nevojat e fëmijës. Në të drejtën suedeze përmbajtja e përgjegjësisë prindore nuk ndryshon sipas statusit familjar të ushtruesit apo ushtrueseve të saj.

⁵⁸ <http://ceflonline.net/wp-content/uploads/Italy-Parental-Responsibilities.pdf> 08/04/2020 13:00

Një fëmijë nuk mund të ketë më shumë se dy kujdestarë në të njejtën kohë. Kujdestarë janë gjithmonë ose prindërit e fëmijës ose një apo dy kujdestarë të caktuar posaçërisht. Për sa kohë që njëri prind ushtron kujdestarinë nuk mund asnjë person tjetër të emërohet si kujdestar i veçant. Sipas rregullit kujdestaria e përbashkët e prindërve gjithashtu vazhdon edhe pas shkurorëzimit (Kapitulli 6 sek.3 para 2 Kodi Suedez i Prindërve dhe Fëmijëve). Gjykata në dekretin e shkurorëzimit të martesës ua bën me dije prindërve që kujdestaria e përbashkët ende do të vazhdojë të ushtrohet edhe pas shkurorëzimit megjithatë, nën kushte të caktuara kujdestaria e përbashkët mund edhe të ndahet dhe kujdestaria e vetme t'i besohet njërit prind.⁵⁹ Në *Zvicër* gjithashtu përdoret termi, përgjegjësi prindore, prindërit janë të detyruar të kujdesen për fëmijët, për rritjen, edukimin si dhe për zhvillimin fizik, mental dhe moral të fëmijës. Gjithashtu kanë të drejtë të ndërmarrin masa për disiplinimin e fëmijëve, mirëpo është i ndaluar çfarëdo lloj ndëshkimi fizik që mund të ushtrohet ndaj fëmijës pasi mund të shkaktojë pasoja negative në zhvillimin fizik dhe mental të fëmijës. Në Kodin Civil Zviceran parashihet se fëmija është i detyruar t'i dëgjojë prindërit e tij, ndërsa prindërit të dëgjojnë fëmijët e tyre varësisht nga mosha e tyre mendimet e tyre përpara se të marrin vendime konkrete. Në Kodin Civil Zviceran gjykata duhet të vendos për përgjegjësitë e prindërve në përputhje me klauzolat e shkurorëzimit. Duke vepruar kështu përgjegjësinë prindore mund t'a ushtrojë njëri prind ose pas një peticioni të përbashkët të mos ushtrojnë përgjegjësinë prindore asnjëri prind nëse kjo është në pajtim me mirëqenien e fëmijës si dhe prindërit janë marrë vesh për mënyrën e mirëmbajtjes së shpenzimeve dhe pjesën e tyre përkatëse të kujdesit për fëmijën në një marrëveshje të aprovuar nga gjykata. Në *Hollandë*, përgjegjësia prindore nënkupton të drejtë dhe detyrim të prindërve të kujdesen për mirëqenien fizike dhe psikike të fëmijëve si dhe t'u mundësojnë zhvillimin e personalitetit të tyre. Gjithashtu edhe në të drejtën Hollandeze është e ndaluar që prindërit t'i ndëshkojnë fëmijët e tyre fizikisht. Ata kanë të drejtë të përfaqësojnë fëmijët e tyre si dhe të administrojnë me pronën e tyre.⁶⁰

5. Ushtrimi i së drejtës prindore pas shkurorëzimit në vende të ndryshme evropiane

Ligjvënësit bashkëkohor evropian, duke u nisur nga bindja se për fëmijën është më mirë që të dy prindërit të kujdesen për rritjen dhe edukimin e tyre, vitet e fundit kanë pranuar konceptin sipas të cilit përgjegjësia prindore është e ndarë nga statusi prind që nënkupton atë se prindërit bashkërisht dhe në mënyrë të ndarë mund të ushtrojnë të drejtën prindore pa marrë parasysh a janë të martuar, bashkëjetojnë ose janë të shkurorëzuar. Në bazë të kësaj bindjeje, numër i madh i ligjvënësve evropian parashohin se prindërit e ushtrojnë të drejtën prindore bashkërisht edhe pas shkurorëzimit të martesës. E tillë është situata në Francë, Itali, Britaninë e Madhe, Gjermani, Zvicër, Holandë, Çeki, në shtetet skandinave dhe në shtete të tjera evropiane.

⁵⁹ <http://ceflonline.net/wp-content/uploads/Sweden-Parental-Responsibilities.pdf> 10/04 /2020 21:00

⁶⁰ Дејан Мицковиќ, Ангел Ристов, Семейно Право, Скопје, 2015, fq. 248.

Në **Francë**, të drejtën prindore e ushtrojnë prindërit bashkërisht derisa fëmija të mbush moshën 18 vjeçare. Më 4 Mars të vitit 2002, me ndryshimet ligjore të Kodit Civil Francez, pëson ndryshime edhe ushtrimi i së drejtës prindore pas shkurorëzimit të martesës. Si princip themelor vendoset ushtrimi i përbashkët i së drejtës prindore nga ana e të dy prindërve, që nënkupton se ndërpreja e lidhjes martesore nuk ka asnjë ndikim në përgjegjësinë prindore. Ligji i vitit 2002 parasheh se fëmija mund në mënyrë alternative të jetojë njëherë te njëri prind, pas shkurorëzimit te prindi tjetër, ose të ketë dy vendbanime. Me marrëveshje prindërit mund të bien dakort që për një periudhe kohore fëmija të jetojë me njërin prind ndërsa pas shkurorëzimit te tjetri. Kjo marrëveshje do të ketë veprim ligjor derisa gjykata t'a miratojë, i cili duhet të vërtetojë nëse ky vendim është në interes të mirë të fëmijës. Përderisa prindërit nuk kanë arritur një marrëveshje të tillë, vendimin për caktimin e vendbanimit të fëmijës tek të dy prindërit do të caktojë gjykata. Në bazë të nenit 388-1 të **Kodit Civil**, nëse bëhet fjalë për mosmarrëveshje të ushtrimit të së drejtës prindore, gjykata ka për detyrë të ndëgjojë edhe mendimin e fëmijës në qoftë se fëmija ka moshën dhe pjekurinë e duhur. Përderisa fëmija është i mitur vendim do të sjellë gjykata duke konsideruar se fëmija i mitur nuk ka arritur pjekurinë e duhur dhe se sjellja e vendimit duke u mbështetur në mendimin e tij mund të jetë në dëm të interesit më të mirë të tij. Gjyqtari për çështje familjare, në përjashtim, në situata kur bëhet fjalë për mosmarrëveshje ndërmjet prindërve për ushtrimin e të drejtës prindore, mund të sjellë vendim vetëm njëri prind të ushtrojë të drejtën prindore.⁶¹ Në **Gjermani** rregull bazë është se të drejtën prindore e ushtrojnë të dy prindërit bashkërisht mirëpo në situata të caktuara atë mund ta ushtrojë edhe vetëm njëri prind. Në bazë të Ligjit për fëmijët i vitit 1998, pas shkurorëzimit të martesës prindërit vazhdojnë të ushtrojnë të drejtën prindore ndaj fëmijëve, pa pasur nevojë që për këtë të sjellë vendim gjykata. Megjithatë, përderisa prindërit shkurorëzohen ose e ndërprejnë bashkëjetesën, secili nga ata mund të kërkojë nga gjykata që në mënyrë të pavarur të ushtrojë të drejtën prindore. Këtë kërkesë gjykata mund t'a pranojë atëherë kur do të vërtetojë se ndërprerja e ushtrimit të përbashkët të së drejtës prindore është në interes të mirë të fëmijës, mirëpo më kusht që për këtë të pajtohet edhe prindi tjetër si dhe fëmija që ka mbushur moshën 14 vjeçare. Pas shkurorëzimit të martesës, kur të drejtën prindore e ushtrojnë të dy prindërit bashkërisht, ndërsa fëmija i është dhënë që të jetojë me prindin tjetër, ai prind ka të drejtë që në mënyrë të pavarur pa pëlqimin e prindit tjetër të sjellë vendime të tilla që janë të rëndësishme për përmbushjen e nevojave të përditshme të fëmijës. Pëlqimi i prindit tjetër kërkohet vetëm në rastet kur duhet të sillen vendime të rëndësishme lidhur me interesat e fëmijëve. Nëse prindërit nuk mund të merren vesh për mënyrën e ushtrimit të së drejtës prindore, për këtë do të vendosë gjykata. Në të njëjtën kohë gjykata ka dy mundësi: mund të vendosë cili nga prindërit do të sjellë vendim në raste konkrete, gjithmonë në interes më të mirë të fëmijës, si dhe mund të ndajë se cili prind në të ardhmen do të sjellë vendime në lidhje më fëmijën në sfera të ndryshme të jetës së fëmijës (si psh nevoja e intervenimeve mjeksore).⁶²

⁶¹ Љиљана Спировиќ Трпеновска, Дејан Мицковиќ, Ангел Ристов, Семејно Право, Скопје, 2013, fq.205.

⁶² По ату, fq.206.

Në **Itali**, në rastet e shkurorëzimit të martesës, prindërit mund të merrën vesh për mënyrën e ushtrimit të kësaj të drejte, me atë që ky vendim duhet të vërtetohet edhe nga ana e gjykatës, i cili ka të drejtë që të vlersojë nëse ky vendim është në pajtim me interesat e fëmijëve. Përveç kësaj, gjykata mund të sjellë edhe vendim që njëri prind të ketë të drejtë ekskluzive që të ushtrojë të drejtat prindore, si dhe të sjellë vendim që prindërit bashkërisht ose në mënyrë alternative të ushtrojnë të drejtat prindore. Në rastet e të drejtës ekskluzive, prindi i cili e posedon këtë të drejtë pas shkurorëzimit të martesës i mer të gjitha vendimet në lidhje me jetën e përditshme të fëmijës. Për vendime të rëndësishme patjetër të ketë edhe pëlqimin e prindit tjetër, ndërsa, në qoftë se nuk mund të merrën vesh vendime mund të sjellë edhe gjykata. Prindi që nuk e ushtron të drejtën prindore ka të drejta prindore të limituara. Ai së bashku me prindin tjetër, vendos për çështje të rëndësishme në jetën e fëmijës, përveç kësaj ka të drejtë edhe që të ushtrojë mbikëqyrje në edukimin dhe zhvillimin moral të fëmijës. Gjithashtu ka të drejtë që të mbajë kontakte personale si dhe ta merr fëmijën me vete dhe të kalojnë kohë të caktuar sëbashku. Që të mund gjykata të sjellë vendim që të dy prindërit të ushtrojnë të drejtën prindore bashkërisht edhe pse ata janë të ndarë, është e nevojshme që prindërit ndërmjet vete të kenë marrëdhënie të mira edhe pas shkurorëzimit të martesës, të jenë të aftë që të ushtrojnë të drejtën prindore si dhe të jetojnë në afërsi me njëri tjetrin. Ushtrimi i së drejtës prindore në mënyrë alternative mund të ndahet pas shkurorëzimit të martesës ashtu që, fëmija për një periudhë të caktuar kohore të jetojë me njërin prind, i cili në atë periudhë ka të drejtën ekskluzive të ushtrimit të së drejtës prindore, ndërsa periudhën tjetër poashtu të jetojë me prindin tjetër. Në të drejtën italiane si dhe në praktikë, autorët Karleo dhe Belisario kanë kritikuar këtë mënyrë të ushtrimit të së drejtës prindore, si arsye kryesore e mos mbështetjes së këtij vendimi është në atë se vet ndarja në mënyrë alternative e fëmijës, njëherë të jetojë me njërin prind, pastaj në periudhë tjetër kohore me prindin tjetër, tek fëmija mund të krijojë pasiguri që ndikon negativisht në zhvillimin e tij të duhur, në periudhën më të vështirë, pas shkurorëzimit të prindërve të tij.⁶³ Në **Britaninë e Madhe** përdoret termi “përgjegjësi prindore” e cila përfshin të gjitha të drejtat, detyrimet, autorizime dhe përgjegjësitë, të cilat i kanë prindërit në bazë të ligjit, ndaj personaliteti të fëmijëve si dhe ndaj pronës së fëmijëve të mitur. Prindërit e ushtrojnë këtë të drejtë bashkërisht derisa janë në kurorëzim. Pas shkurorëzimit të martesës edhe mëtej zbatohet principi për ushtrim të përbashkët të së drejtës prindore, i të dy prindërve ndaj fëmijëve. Në përgjithësi gjykatat në Britaninë e Madhe mund të sjellin katër lloje të vendimeve në lidhje me fëmijën: Vendim për ndarjen e vendbanimit të fëmijës, vendim për kontakt me fëmijën, vendim për ndalimin e marrjes së disa masave në lidhje me fëmijën dhe vendim për ndarjen për vendosjen në lidhje me disa çështje në lidhje me fëmijën.⁶⁴ Më e rëndësishmja nga të gjitha këto vendime është vendimi për ndarjen e vendbanimit të fëmijës, që në thelb nënkupton se me këtë vendim gjykata cakton se me cilin prind do të vazhdojë të jetojë fëmija pas shkurorëzimit të martesës. Megjithatë, me këtë vendim nuk domethënë se prindit tjetër me të cilin fëmija nuk jeton, i ndërpritet ushtrimi i së drejtës prindore. Përkundrazi, ai vazhdon të përmbush përgjegjësinë prindore që e ka pasur edhe para shkurorëzimit të martesës.

⁶³ Љиљана Спировиќ Трпеновска, Дејан Мицковиќ, Ангел Ристов, Семејно Право, Скопје, 2013, fq.207.

⁶⁴ По ату, fq.208.

Në jetën e përditshme kjo nënkupton se prindi me të cilin fëmija nuk jeton ka të drejtë që ti bart të gjitha vendimet e rëndësishme për fëmijën, ndërsa vendimet në lidhje me nevojat e përditshme dhe kenaqësitë e tij, i bart prindi më të cilin jeton fëmija. Në Britaninë e Madhe në qoftë se ndërmjet prindërve ka mosmarrëveshje për ndonjë çështje të rëndësishme, gjykata do të sjellë vendim për ndalimin e marrjes së ndonjë vendimi për ndonjë rast konkret si dhe vendim për zgjidhjen e çështjes që është në lidhje me fëmijën.⁶⁵ Në **Suedi**, ushtrimi i përbashkët i së drejtës prindore, është princip i cili është i pranuar në mënyrë më të gjërë për dallim nga legjislacionet e tjera evropiane. Në teorinë juridike suedeze, sipas autorëve Kovaçek-Staniq, ka argumente të shumta në lidhje me ushtrimin e përbashkët të së drejtës prindore. Më i rëndësishëm është interesi i fëmijës, i cili pa marrë parasysh nëse prindërit janë në kurorëzim ose të shkurorëzuar ose jetojnë në bashkësi jashtmartesore, ka marrëdhënie të njejta me të dy prindërit, të cilët bashkërisht kujdesen për mirëritjen dhe edukimin e drejtë të tyre. Përveç kësaj, prindërit janë më të motivuar që të kujdesen për fëmijët e tyre përderisa e dinë se kanë të drejta të njejta ndaj fëmijëve, pavarësisht nga marrëdhëniet e tyre si partner. Ushtrimi i përbashkët i së drejtës prindore në masë të madhe i zvogëlon konfliktet e shkurorëzimit të martesës, kur më së shpeshti paraqiten konfliktet rreth asaj se kush nga prindërit do të ushtrojë të drejtën prindore. Prindërit të cilët janë të kurorëzuar fitojnë të drejtën prindore më lindjen e fëmijës. Përderisa prindërit e fëmijës nuk janë të kurorëzuar, e drejta prindore i takon nënës. Në raste të tilla, prindërit e fëmijës mund të bashkërisht të ushtrojnë të drejtën prindore, me iniciimin e një procedure të thjeshtë. Ata mund të paraqesin kërkesë për ushtrim të përbashkët të së drejtës prindore në zyrën për regjistrim të qytetarëve. Në parim, gjykata sjell vendim për ushtrim të përbashkët të së drejtës prindore, prindërve që nuk janë të kurorëzuar mirëpo bashkëjetojnë, përjashtim na situata të rralla kur do të vlersojë se ai vendim është në kundërshtim me interesat e fëmijëve. E drejta suedeze parashikon se ushtrimi i së drejtës prindore me të drejtë vazhdon edhe pas shkurorëzimit të martesës. Sipas autorëve Joreborg dhe Sorgjerd, në vitin 2002, 97% nga rastet e shkurorëzimit, të drejtën prindore vazhdonin që ta ushtrojnë të dy prindërit. Interesant është fakti se në Suedi ekzistonte supozimi se ushtrimi i përbashkët i së drejtës prindore është në interes të mirë të fëmijës, kështu që gjykata mund të vendosë që të dy prindërit të ushtrojnë të drejtën prindore bashkërisht pas shkurorëzimit të martesës edhe në rastet kur njëri nga prindërit nuk pajtohet me këtë vendim. Principi themelor i ushtrimit të përbashkët të së drejtës prindore supozon që prindërit bashkërisht dhe me marrëveshje të përbashkët të drejtat dhe obligimet që i kanë ndaj fëmijëve të tyre. Kur prindërit nuk jetojnë bashkërisht, prindi me të cilin jeton fëmija ka të drejtë që të vendos për të gjitha nevojat e përditshme të fëmijës. Për vendimet më të rëndësishme, patjetër që të ketë vendim të përbashkët nga të dy prindërit të cilët e ushtrojnë të drejtën prindore. Në rastet kur prindërit nuk mund të merren vesh se cilit prind do t'i jepet në dorëzim fëmija, si dhe për mbajtjen e kontakteve me prindin tjetër, ata mund të kërkojnë ndihmë nga Qendra për punë sociale me qëllim që të arrihet një marrëveshje për këtë çështje. Përveç kësaj, në rastet kur nuk mund të merren vesh se kush do të ushtrojë të drejtën prindore, secili prej tyre mund të kërkojë nga gjykata që të vendos që vetëm njëri prej tyre të ushtrojë të drejtën prindore.⁶⁶

⁶⁵ По ату, fq.209.

⁶⁶ Љиљана Спировиќ Трпеновска, Дејан Мицковиќ, Ангел Ристов, Семејно Право, Скопје, 2013, fq.209

Në **Zvicër** ashtu si edhe në të gjitha vendet e tjera evropiane, e drejta parashikon se të drejtën prindore e ushtrojnë bashkëshortët në marrëdhënie me fëmijët e lindur në martesë. E drejta prindore u takon vetëm prindërve. Përderisa martesë shkurorezohet, ndërsa prindi tek i cili jetojnë fëmijët lidh martesë të re, njerku dhe njerka nuk kanë të drejtë prindore me fëmijët, por mundën që vetëm t'u ndihmojnë bashkëshortëve në ushtrimin e të drejtës prindore. Për fëmijët e lindur jashtë martesë, të drejtën prindore e ushtron nëna. Përderisa nëna është e mitur, ka ndërruar jetë ose i është marrë aftësia e veprimit, gjykata mund të vendos që të drejtën prindore të ushtrojë babai jashtëmartesor ose kujdestari, në varësi nga vlerësimi se çka është më e përshtatshme për interesin më të mirë të fëmijës. Në raste të shkurorezimit të martesës, gjykata sjell vendim për ushtrimin e të drejtës prindore. Gjukata mund të sjellë vendim që të drejtën prindore të ushtrojë vetëm njëri prind, por mund të vendos që të dy prindërit të vazhdojnë bashkërisht të ushtrojnë të drejtën prindore. Gjukata do të vendos që të drejtën prindore do të vazhdojë të ushtrojë ai prind i cili garanton se fëmija tek ai do të ketë kushte më të mira psikofizike dhe zhvillim mental më të përshtatshëm për moshën e tij. Përderisa të dy prindërit kanë kushte që t'u sigurojnë zhvillimin e duhur, gjykata do t'ia jep fëmijën atij prindi i cili do të sigurojë stabilitet në jetën familjare pa ndryshim të vendbanimit, duke i pasur parasysh në të njëjtën kohë edhe dëshirat e fëmijës.⁶⁷ Në Zvicër ligji parasheh që të jenë të plotësuar kushte të caktuara që të mund gjykata të vendos për ushtrim të përbashkët të së drejtës prindore pas shkurorezimit të martesës. Së pari, prindërit duhet të paraqesin kërkesë në gjykatë, pastaj duhet që të marrin një pëlqim me shkrim për alimentacionin e fëmijëve dhe përfundimisht gjykata patjetër të vërtetojë për të gjitha rastet konkrete se ushtrimi i përbashkët i së drejtës prindore është në interes të fëmijës.⁶⁸ E drejta zvicerane përmban vendime të cilat i referohen rasteve kur ekzistojnë konflikte midis prindërve në lidhje me ushtrimin e të drejtës prindore. Është e paraparë se përderisa ekziston mosmarrëveshje për ndonjë çështje të rëndësishme në lidhje me fëmijët si dhe të drejtat dhe interesat e tyre, secili prind mund të kërkojë që vendimin për këtë çështje të sjell gjykata. Njëri prind mund të sjell vendim në lidhje me fëmijët edhe përkundër mendimit të prindit tjetër, përderisa vendimi i tillë është i domosdoshëm për të shmangur ndonjë rrezik si dhe të mbrohet personaliteti ose shëndeti i fëmijës, ndërsa vendimi i tillë nuk dëmton prindin tjetër. Nëse fëmija pas shkurorezimit të martesës i është dhënë në kujdesje njërit prind, ai prind ka të drejtë që të caktojë edhe vendbanimin e fëmijës si dhe të vendos për një numër të madh të çështjeve në lidhje me jetën e përditshme si dhe përmbushjen e nevojave të fëmijëve.⁶⁹ Në **Rusi**, të drejtën prindore e ushtrojnë bashkëshortët martesor, përderisa fëmija është i lindur në martesë. Për fëmijët e lindur jashtë martesë të drejtën prindore e ushtron nëna derisa nuk është e vërtetuar atësia. Kur i ati e pranon fëmijën e lindur jashtë martesë ose në rastet kur atësia është e vërtetuar më vendim gjyqësor, të drejtën prindore ndaj fëmijëve jashtëmartesor e ushtrojnë të dy prindërit jashtëmartesor. Pas shkurorezimit të martesës të dy prindërit vazhdojnë që bashkërisht të ushtrojnë të drejtën prindore. Megjithatë, në praktikë, prindit të cilit i është dhënë fëmija për ruajtje e ushtron të drejtën prindore në mënyrë të pavarur.

⁶⁷ Лиљана Спировиќ Трпеновска, Дејан Мицковиќ, Ангел Ристов, Семејно Право, Скопје, 2013fq.210.

⁶⁸ По ату, fq. 211

⁶⁹ По ату, fq.211.

Për këtë arsye pyetja themelore në lidhje me ushtrimin e të drejtës prindore pas shkurorëzimit është e lidhur me vendosshmërinë se cilit prind do t'i jepet fëmija për rritje pas shkurorëzimit. Prindërit mund të arrijnë marrëveshje se me cilin prind do vazhdojë të jetojë fëmija pas shkurorëzimit si dhe gjykata patjetër që të miratojë këtë vendim. Prindërit patjetër që të arrijnë marrëveshje e cila është në pajtim me interesat e fëmijëve, si dhe dëshirën e fëmijës se me cilin prind dëshiron që të jetojë pas shkurorëzimit të martesës. Nëse gjykata vërteton se marrëveshja e tillë është në kundërshtim me interesin e fëmijës, do të sjellë vendim tjetër nga ai që prindërit kanë arritur marrëveshje. Pas vendosjes se cilit prind do t'i jepet fëmija, gjykata duhet patjetër ti ketë parasysh këto rrethana: afërsinë e fëmijës me prindërit si dhe më vëllezërit dhe motrat, lidhjen e secilit prind me fëmijën, mosha e fëmijës, moralin dhe cilësitë e tjera personale të prindërve për ushtrimin e të drejtës prindore, kushtet materiale dhe të gjitha kushtet e tjera që duhet t'i posedojë prindi për një zhvillim dhe edukim të drejtë të fëmijës.⁷⁰ Në të drejtën ruse, prindit të cilit nuk janë dhënë në ruajtje fëmijët pas shkurorëzimit, ka të drejtë që të mbaje kontakte me fëmijën, të merr pjesë në edukim të fëmijës si dhe të vendos për çështje të rëndësishme në lidhje me shkollimin e fëmijës. Prindit të cilit i është dhënë fëmija, nuk ka të drejtë që të pengojë mbajtjen e kontakteve të fëmijës me prindin tjetër, përderisa takimet e tilla nuk janë të dëmshme për zhvillimin psikofizik të fëmijës. Në qoftë se prindi të cilit i është dhënë fëmija në ruajtje, pa ndonjë arsye të justifikuar pengon mbajtjen e kontakteve të fëmijës me prindin tjetër, me kërkesën e tij, gjykata mund të sjell vendim me të cilin i merret fëmija prindit me të cilin jeton dhe i jepet në ruajtje prindit tjetër. Prindi i cili jeton i ndarë nga fëmija ka të drejtë që të merr informacione në lidhje me shkollimin, shëndetin si dhe kushtet e tjera sociale. Nëse paraqitet ndonjë konflikt në mes prindërve në lidhje me ushtrimin e të drejtës prindore, e drejta ruse parashes se çdonjëri nga ata ka të drejtë që të iniciojë procedurë përpara Sektorit për kujdestari ose në gjykatë. Secili nga prindërit mund të marrë vendim në lidhje me përmbushjen e nevojave të përditshme të fëmijës, nga ku supozohet se e ka edhe pëlqimin e prindit tjetër. Megjithatë, ai mund që t'i kundërvihet vendimeve të prindit tjetër dhe të kërkojë intervenim nga organet kompetente shtetërore. Vendimet në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me jetën e përditshme të fëmijës, vendos prindit të cilit i është dhënë fëmija në ruajtje, ndërsa për çështje më të rëndësishme për të vendosur duhet edhe pëlqimi i prindit tjetër.⁷¹ Në **Hungari** parashihet se të drejtën prindore në lidhje me fëmijët e lindur në martesë e ushtrojnë prindërit e tyre, të cilët mund të arrijnë edhe marrëveshje joformale në lidhje me sigurimin e kujdesit dhe mirëqenien e përditshme të fëmijës. Në të drejtën Hungareze nuk ka dallime në ushtrimin e të drejtës prindore nga prindërit martesor dhe jashtmartesor. Kusht i vetëm për ushtrimin e të drejtës prindore nga bashkëshorti jashtmartesor është vërtetimi i atësisë. Pas shkurorëzimit të martesës ekzistojnë dy mundësi në lidhje me ushtrimin e të drejtës prindore. Prindërit mund të merrën vesh që edhe pas shkurorëzimit të martesës të ushtrojnë bashkërisht të drejtën prindore. Përderisa nuk ndodh një gjë e tillë, gjykata vendos të cili prind do të jetojë fëmija pas shkurorëzimit të martesës, si dhe vendos se ai prind do të ushtrojë edhe të drejtën prindore. Me sjelljen e këtij vendimi, gjykata duhet të vërtetojë se cili prind mund t'i garantojë zhvillim më të

⁷⁰ По ату, fq.211

⁷¹ Љиљана Спиоровиќ Трпеновска, Дејан Мицковиќ, Ангел Ристов, Семејно Право, Скопје, 2013, fq.212.

mirë trupor, intelektual dhe moral të fëmijës. Sipas autorëve Vajs dhe Shajbert, në Hungari janë të pakta rastet e ushtrimit të përbashkët të së drejtës prindore pas shkurorëzimit të martesës, kështu që më së shpeshti të drejtën prindore e ushtron vetëm njëri prind. Prindi i cili nuk e ushtron të drejtën prindore ka mundësi të mbajë kontakte me fëmijën, por edhe të merr pjesë në sjelljen e vendimeve më të rëndësishme për fëmijën, bashkërisht me fëmijën i cili e ushtron të drejtën prindore.⁷² Në qoftë se paraqitet mosmarrëveshje për ushtrimin e të drejtës prindore, kjo çështje do të zgjidhet në varshmëri me atë nëse prindërit jetojnë bashkë apo të ndarë. Përderisa prindërit jetojnë bashkë dhe nuk mund të sjellin një vendim në lidhje me ushtrimin e të drejtës prindore, secili nga ata ka të drejtë të kërkojë që vendim të sjell organi i kujdestarisë. Nëse prindërit nuk jetojnë bashkë në rast të shkurorëzimit të martesës, për mosmarrëveshjet e ushtrimit të së drejtës prindore do të vendosë gjykata. Për udhëheqjen me pronën e fëmijëve, dhe me përfaqësimin e fëmijëve janë kompetent të dy prindërit, pavarësisht a jetojnë bashkë si dhe a e ushtron njëri apo të dy të drejtën prindore. Kjo domethënë se prindi me të cilin nuk jeton fëmija pas shkurorëzimit të martesës edhe pse nuk e ushtron të drejtën prindore, megjithatë ka të drejtë që të udhëheq me pronën dhe të përfaqësojë fëmijën.⁷³

6.Krijimi dhe ushtrimi i së drejtës prindore në të drejtën familjare të Republikës së Maqedonisë

Ushtrimi i së drejtës prindore u përket në mënyrë të pandarë prindërve, gjithmonë duke pasur parasysh interesin e fëmijëve. Nëqoftë se këtë e kërkojnë interesat e fëmijëve, prindërit mund që fëmijën t'ia besojnë ndonjë personi tjetër për ta ruajtur dhe edukuar ose ta vendosin atë në një institucion adekuat për përkujdesje. Ligji për familje parasheh se të drejtën prindore e ushtrjnë të dy prindërit bashkërisht dhe me marrëveshje. Në rast të mosmarrëveshjes së prindërve në lidhje me ushtrimin e së drejtës prindore, vendos Qendra për punë sociale.⁷⁴ Si kusht themelor për krijimin e marrëdhënieve prindore në mes të prindërve dhe fëmijëve në të drejtën bashkëkohore familjare, në të cilën bën pjesë edhe e drejta jonë familjare janë: lindja e fëmijës (martesor ose jashtmartesor) dhe adoptimi i fëmijës së huaj të mitur. Që të krijohet marrëdhënia prindore me lindjen e fëmijës e domosdoshme është që të vërtetohet amësia dhe atësia, si një lidhje biologjike e fëmijës me prindërit e tij. Amësia vërtetohet që në momentin e lindjes së fëmijës qoftë martesor ose jomartesor. Ndërsa atësia, kur fëmija është i lindur në martesë, si baba i fëmijës konsiderohet buri i gruas e cila e ka lindur fëmijën (pater vero is est quem nuptiae demonstrat). Në rastet kur fëmija lindet në bashkësinë jashtmartesore, marrëdhënia prindore ekziston vetëm me nënën e cila e ka lindur, ndërsa marrëdhënia prindore me babain do të ekzistojë atëherë kur do të vërtetohet atësia në pajtim me ligjin.

⁷² Љиљана Спировиќ Трпеновска, Дејан Мицковиќ, Ангел Ристов, Семејно Право, Скопје, 2013, fq.212

⁷³ По ату, fq.213

⁷⁴ Neni 76, LF.

Marrëdhënia prindore përveç se me lindje sipas Ligjit për familje të Republikës së Maqedonisë themelohet edhe me adoptim. Marrëdhënia e tillë prindore themelohet me adoptimin e fëmijës së huaj të mitur, në pajtim me dispozitat ligjore dhe me vendimin e organit përgjegjës shtetëror.

7. Ushtrimi i së drejtës prindore pas shkurorëzimit

Nëse pas shkurorëzimit të martesës, cilësia e bashkëshortëve kthehet në ish-bashkëshort, cilësia e prindit në raport me fëmijët e tyre nuk ndryshon. Shkurorëzimi i martesës nuk prek të drejtat dhe detyrimet që kanë prindërit ndaj fëmijëve të tyre. Bashkësi familjare e ndarë nënkupton pamundësinë që fëmija në të njëjtën kohë të jetojë me të dy prindërit. Kemi të bëjmë me ndarje vullnetare kur është e nevojshme të rregullohen marrëdhëniet e fëmijëve me prindërit e ndarë. Kur nuk ekziston bashkësi familjare e prindërve dhe fëmijëve, është e nevojshme të vendoset se me cilin nga dy prindërit do të jetojë fëmija, si dhe a do të dëshirojë që fëmija të takohet dhe shoqërohet me prindërit e ndarë, apo diçka tjetër nga përmbajtja e kujdesit prindor.⁷⁵ Edhe pse fëmijët kanë të drejtë të jetojnë me prindërit e tyre, poashtu edhe prindërit me fëmijët e tyre, mirëpo kur prindërit jetojnë të ndarë atëherë gjykata është kompetente që të sjell vendim se me cilin prind do të jetojë fëmija. Gjykata duhet të ketë parasysh të gjitha ato që janë nevojat e fëmijëve si një grup që gëzon të drejta të veçanta dhe mbrojtje të veçantë dhe të nevojave specifike të fëmijës konkret dhe të bëjë vlerësimin e nevojave fizike, emocionale, edukative- arsimore dhe shëndetësore të fëmijës. Gjithashtu duhet të bëjë edhe vlerësimin e pasojave që do të shkaktojë çdo ndryshim i ri në jetën e fëmijës.⁷⁶ Me aktgjykimin me të cilin shkurorëzohet martesja, gjykata do të vendos për ruajtjen, edukimin, dhe mbajtjen e fëmijëve të përbashkët. Për të përcaktuar mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindore pas zgjidhjes së martesës, gjykata duhet të vlerësojë se cili prej prindërve plotëson më së shumti nevojat e fëmijës dhe interesin e tyre. Ky vlerësim, do të realizohet mbi bazën e një parimi themelor ligjor që është Parimi i Interesit më të lartë të Fëmijës. Me qëllim zbatimit e këtij parimi, para se gjykata të marrë një vendim të përkohshëm ose përfundimtar lidhur me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, të drejtës së vizitës ose të besuarit të fëmijës njërit ish-bashkëshort, duhet të marrë mendim nga Qendra për punë sociale, e cila, para se të japë mendimin, duhet të marrë të dhëna për gjendjen materiale dhe morale të familjes, kushtet në të cilat jetojnë dhe ku është më e përshtatshme të jetojë fëmija. Nëse prindërit nuk janë marrë vesh për këtë ose nëse marrëveshja e tyre nuk u përgjigjet interesave të fëmijëve, gjykata posa të marrë mendimin nga Qendra për punë sociale dhe të hulumtojë të gjitha rrethanat, do të vendosë nëse fëmijët do të qëndrojnë për ruajtje dhe edukim te njëri prind ose disa do të qëndrojnë tek nëna, disa tek babai ose të gjithë do t'i besohen ndonjë personi të tretë apo institucioni (neni 80).⁷⁷

⁷⁵ Mira Alinçiq, Dubravka Hrabar, Dijana Jakovac-Lozić, Aleksandra Korać, Obiteljsko pravo, Narodno Novine d.d, Zagreb, 2006. fq.268.

⁷⁶ Arta Mandro, E drejta familjare, Tirane 2009, fq.337.

⁷⁷Neni 80, LF.

Gjithashtu edhe në teorinë juridike në rastet kur prindërit kanë më tepër fëmijë ekzistojnë disa mënyra se me cilin prind do të jetojnë edhe atë:

-që të gjithë fëmijët të jetojnë me njërin prind,

-që disa të jetojnë me nënën, disa me babain,

-që fëmijët (fëmija) ti besohen ndonjë personi të tretë ose ndonjë personi tjetër juridik që ushtron të drejtën për punë sociale (në këto raste ekziston qendra kompetente për punë sociale).⁷⁸ Edhe pse ndarja e fëmijëve ndonjëherë sa më shumë mund t'a lehtësojë jetën e prindërve aq më shumë mund të jetë e dëmshme për fëmijët praktika deri tani na paralajmëron që vëllezërit dhe motrat të mos ndahen nga njëri tjetri në rastet e ndarjes së bashkësisë familjare të prindërve, pasi që nuk vijnë në shprehje vetëm në ndarjen nga njëri prind por edhe nga vëllezërit dhe motrat tjera.. Për këtë shkak në rastet kur është e mundur urdhërohet që të gjithë fëmijët të jetojnë me të njëjtin prind. Interesi i fëmijëve kërkon që ata të rriten së bashku, në mënyrë që zhvillimi i tyre psiko-emocional të mos dëmtohet nga ndarja me njëri-tjetrin.

8. Marrëveshja për ushtrimin e së drejtës prindore

Pasojat më të rënda të shkurorëzimit të martesës së bashkëshortëve i pësojnë fëmijët e tyre, pasi është shumë e vështirë për to që të pranojnë se prindërit e tyre jetojnë të ndarë. Duke pasur parasysh zhvillimin mendor dhe zhvillimin e plotë të personalitetit të fëmijës, është e nevojshme që fëmijët të rriten në mjedis familjar, në një atmosferë dashurie, lumturie dhe mirëkuptimi. Është shumë e rëndësishme që ato të rriten me prindërit e tyre, pasi për shkak të papjekurisë së tyre fizike dhe intelektuale kanë nevojë për një mbrojtje dhe kujdes të veçantë. Megjithatë në mbarë botën, numri i rasteve të shkurorëzimit të martesës, dita ditës vazhdon që të jetë në rritje. Pas shkurorëzimit të martesës gjëja e parë më e rëndësishme është që të vendoset se me cilin prind do të jetojnë fëmijët. Nëse bashkëshortët bien dakort me marrëveshje se kush do të ushtrojë të drejtën prindore, gjykata do të pranojë marrëveshjen e tyre në qofte se ajo mbron interesat e fëmijëve. Marrëveshja e prindërve në lidhje me atë se me cilin prind do të jetojë fëmija, është një shenjë se ndërmjet tyre ekzistojnë marrëdhënie të mira bashkëshortore, por çdo marrëveshje nuk është e tillë që i mbron interesat e fëmijëve, ajo ndonjëherë favorizon egoizmin e prindërve, ose papërgjegjshmërinë e tyre në lidhje me fëmijët.⁷⁹ E drejta e fëmijëve që të jetojnë me prindërit e tyre është një e drejtë e cila është e garantuar edhe në Konventën për të drejtat e fëmijëve sepse Konventa ndalon ndarjen e fëmijëve nga prindërit e tyre kundër vullnetit të tyre.

⁷⁸ Mira Alinçiq, Dubravka Hrabar, Dijana Jakovac-Loziç, Aleksandra Koraç, Obiteljsko pravo, Narodno Novine d.d, Zagreb,2006. fq.269

⁷⁹ Po aty, fq.270

Neni 9 i Konventës për të drejtat e fëmijëve parasheh:

1. Shtetet palë do të garantojnë që fëmijët të mos ndahen nga prindërit përkundër dëshirës së tyre, përveç rastit kur autoritetet kompetente në bazë të rishikimit gjyqësor vendosin që, në përputhje me ligjin dhe procedurat përkatëse kjo ndarje është e domosdoshme, në interesin më të lartë të fëmijës. Ky vendim mund të jetë i nevojshëm në raste të veçanta, si ai kur prindërit keqtrajtojnë ose nuk kujdesen për fëmijën, ose kur ata jetojnë të ndarë dhe kur duhet vendosur se ku duhet të banojë fëmija.⁸⁰
2. Në të gjitha rastet e parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni, të gjitha palët e interesuara duhet të kenë mundësinë të marrin pjesë në diskutim dhe të bëjnë të njohura mendimet e tyre.⁸¹
3. Shtete palë respektojnë të drejtën e fëmijës së ndarë nga njëri ose të dy prindërit, që të mbajnë rregullisht marrëdhënie dhe takime të drejtpërdrejta me të dy prindërit e tij, me përjashtim të rasteve kur kjo nuk është në interesin më të lartë të fëmijës.⁸²

9. Kushtet për dhënien e fëmijëve në ruajtje

Gjykata gjatë vendosjes se me cilin prind do të vazhdojë të jetojë fëmija pas shkurorëzimit të martesës të bashkëshortëve, gjithmonë do të ketë parasysh interesin më të mirë të fëmijëve. Se cilat kushte duhet ti plotësojë prindi të cilit do ti jepet fëmija në kujdesje nuk janë të numëruara sakt, mirëpo gjykata gjithmonë do të marrë parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat në rastet konkrete para sjelljes së vendimit se me cilin prind do të jetojë fëmija. Në bazë të pikëpamjes se Gjykatës Supreme të Maqedonisë, gjendja materiale e mirë e njërit prind, është vetëm njëri nga kushtet por nuk është i mjaftueshëm për dhënien e fëmijës në kujdesje, mbikëqyrje dhe mbajtje.⁸³

Praktikë gjyqësore:

1. Punësimi i prindërit të cilit i është dhënë fëmija, si fakt i vetëm, nuk mund gjithmonë të konsiderohet si arsye se ekzistojnë rrethana të ndryshuara që kushtëzojnë ndryshimin e vendimit për dhënie të fëmijës. (BCM PEB 99/89, 3Б BCM III одл.28)
2. Faji i njërit bashkëshort për prishjen e marrëdhënieve bashkëshortore nuk mund të paraqesë pengesë që atij prindi ti jepet fëmija për ruajtje dhe mbikëqyrje, përderisa këtë e kërkojnë interesat e fëmijës, por gjatë vendosjes duhet të merret në konsideratë nëse arsyeja e prishjes së marrëdhënieve nuk është e natyrës së tillë që vetëvetiu na bën të ditur që për zhvillimin e fëmijës dhe për interesat e tij është e dëmshme që ti jepet atij prindi në ruajtje (BCM Гж 497/65, 3Б BCM I одл.3).

⁸⁰ Pwrmbledhje e instrumenteve nderkombetare, Tw drejtat e njeriut, Kombet e bashkuara, New York dhe Gjenevw, 1994 Konventa për të drejtat e fëmijës, Neni 9, fq.225.

⁸¹ Po aty, Neni 9, fq.226.

⁸² Po aty, Neni 9, fq.226.

⁸³ Љиљана Спировиќ Трпеновска, Дејан Мицковиќ, Ангел Ристов, Семејно Право, Скопје, 2013, fq.199

3. Kur fëmija, në bazë të dëshirës së vet shkon që të jetojë me prindin tjetër, i cili poashtu është i aftë që të kujdeset për të sikur prindi me të cilin ka jetuar deri tash fëmija, bëhet fjalë për fëmijën i cili në pikëpamje të moshës është i aftë të shprehë mendimin e tij, në raste të tilla ekzistojnë rrethana të ndryshuara, të cilat justifikojnë ndryshimin e vendimit të mëparshëm se me cilin prind do të jetojë fëmija.⁸⁴

10.Vullneti i lirë i fëmijës

E drejta e fëmijëve që të jetojnë me prindërit e tyre ka një rëndësi të veçantë, prandaj edhe Konventa për të drejtat e njeriut ndalon ndarjen e fëmijëve nga prindërit e tyre kundër vullnetit të tyre. Në këtë drejtim, ndarja e fëmijëve nga prindërit e tyre lejohet vetëm përjashtimisht, atëherë kur është në interes më të mirë të fëmijës, me vendim të organit kompetent shtetëror, në procedurë gjyqësore.⁸⁵

10.1 Si mund të vlerësohet respektimi i parimit të interesit më të lartë të fëmijës?

Një detyrë aspak e lehtë që kërkon përgjegjshmëri shumë të madhe. Kërkohej durim dhe analizë e shumë faktorëve që kontribuojnë në këtë interes, të cilët kanë efekt në mënyrë rrënjësore në të ndjerin mirë të fëmijës dhe të respektimit të interesave të tij jo vetëm për momentin, për të sotmen por edhe për të ardhmen. Në vendosjen e një balance të tyre situata duhet vlerësuar rast pas rasti. Asnjë situatë nuk është e njejtë me tjetrën.⁸⁶ Kushdo që duhet të bëjë vlerësim interesash, përparësi duhet t'i japë interesit të fëmijës. Vlerësimi i interesit më të lartë të fëmijës dhe marrja e vendimeve në përputhje me këtë është një çështje e cila rëndon dhe varet jo vetëm prej faktorëve objektiv (ekonomia, punësimi i prindërve, pasja ose jo e një të ardhure të sigurtë ose të mirë, pushteti etj) por edhe prej atyre subjektiv. Subjektiv në kuptimin e fëmijëve dhe në kuptimin e autoritetit (prindërit, personi i tretë apo institucioni) i cili merr vendimin për fëmijën.⁸⁷

Koventa për të drejtat e fëmijëve në nënin 12 parasheh se: “Shtetet palë i garantojnë fëmijës, i cili është i aftë të ketë pikpamjet e tij, të drejtën për t'i shprehur lirisht këto pikëpamje, për çdo çështje që ka të bëjë me të, duke i vlerësuar ato në përputhje më moshën dhe shkallën e pjekurisë. Për këtë qëllim, fëmijës i jepet mundësia që të dëgjohet në çdo procedurë gjyqësore ose administrative, që ka të bëjë me të, qoftë drejtpërdrejtë, qoftë nëpërmjet përfaqësuesit ose të një organi të përshtatshëm, në përputhje me rregullat e procedurës së ligjeve kombëtare.”⁸⁸

⁸⁴Дејан Мицковиќ, Ангел Ристов, Семејно Право, Скопје, 2015, fq.226.

⁸⁵ Дејан Мицковиќ, Ангел Ристов, Семејно Право, Скопје, fq.224

⁸⁶ Arta Mandro, E drejta familjare, Tiranë 2009, fq.59.

⁸⁷ По ату, fq.59.

⁸⁸ Тë Drejtat e Njeriut, Përmbledhje e instrumenteve ndërkombëtare, Vëllimi I parë (Pjesa e Parë), Instrumentet e Përgjithshme, Kombet e Bashkuara, New York dhe Gjenevë, 1994, Konventa për të drejtat e fëmijës, fq. 227

Në nënin 20 thuhet se:“Një fëmijë, të cilit i mohohet në mënyrë të përkohshme ose të përhershme mjedisi i tij familjar, ose kur është në interesin e tij të lartë të mos qëndrojë në këtë mjedis, ka të drejtë për mbrojtje dhe ndihmë të posaçme nga shteti. Shtetet palë do të sigurojnë për këtë fëmijë një përkujdesje alternative në përputhje me ligjet e tyre. .Kjo përkujdesje alternative mund të ketë, ndër të tjera, formën e vendosjes në një familje, të “Kafalasë” sipas të drejtës islamike. Të adoptimit ose në rast nevoje, të vendosjes në një qendër të përshtatshme të kujdesit për fëmijët. Në gjetjen e ketyre zgjedhjeve, duhet të mbahen mirë parasysh dëshira për vazhdimsinë në edukimin e fëmijës, si dhe origjina e tij etnike, fetare, kulturore dhe gjuhësore. ⁸⁹

11.Vendim kundër vullnetit të fëmijës kur vjen në shprehje interesi i fëmijës

Vlerësimi i dëshirave dhe i ndjenjave të fëmijës duhet bërë në përputhje me moshën e tij dhe me pjekurinë. Rritja në moshë e fëmijëve i bën mendimet e tyre më të rëndësishme për gjykatën. Gjithsesi, është e rëndësishme të pranojmë se mendimet e fëmijëve nuk janë vendimtare, sepse fëmija mund të dëshirojë diçka që është në kundërshtim me mirëqenien dhe interesin e tij. Fëmija nuk duhet të pyetet prej gjykatës në mënyrë të tillë që të zgjedhë njërin prind ose tjetrin. ⁹⁰ Pavarësisht nga mënyrat e ushtrimit të së drejtës prindore dhe format e realizimit të saj, ka edhe një kërkesë e cila është e detyrueshme për të bërë në mënyrë shkencore dhe profesionale vlerësimin e kontibuteve ose thënieve, ndjenjave, mendimeve ose sjelljeve të të miturit. Kjo është një detyrë që i atribuohet psikologut, i cili u kushton vëmendjen e duhur opinioneve dhe ndjenjave të fëmijëve për të vërejtur se çfarë qëndron pas tyre në të vërtetë.⁹¹ Edhe pse është e pranueshme që të pyetet fëmija i cili ka arritur moshën e pjekurisë dhe është i aftë që të vlerësojë dhe të vendosë drejtë, literarura sugjeron se nuk ka asnjë moshë të përcaktuar kur fëmija mund të vendosë dhe të ndajë se me cilin prind do të jetojë. Gjithashtu supozohet se për të sjellë një vendim të drejtë gjithmonë në interes të mirë të fëmijës, fëmijët duhet të takohen më shumë herë, pasi Qendra për punë sociale nuk mund të ketë një bindje të qartë se cili është vendimi në interes më të mirë të fëmijës, pasi thëniet dhe preferencat e tyre mund të ndryshojnë varësisht nga rrethanat dhe gjendjes së pasigurt që ndodhet fëmija. Gjithmonë kur do të merren në pyetje fëmijët, ato do të shprehin nevojat e tyre në aspektin emocional. Nevojat e tyre janë të orientura në drejtim të zgjidhjes së konfliktit që e kanë prindërit ndërmjet tyre. Mirëpo ekzistojnë edhe raste kur fëmijët shprehin nevojë për mbrojtje nga prindi i tyre i cili ushtron dhunë ndaj nënës së tyre. Gjatë periudhës së ndarjes të prindërve fëmijët përjetojnë frikë e cila shpesh lidhet edhe nga dhuna e cila ushtrohet në familje. Si pasojë e frikës ato mbyllën në vetvete dhe nuk janë shumë të komunikueshëm dhe aktiv. Kjo mbyllje vjen si pasojë e konflikteve prindërore dhe ankthit për ndarjen e tyre. Nga e gjithë kjo vijm në konstatim se dëshira e fëmijëve se me cilin prind do vazhdojë të jetojë mund të jetë dëshirë e ndikuar nga

⁸⁹ Të Drejtat e Njeriut, Përmbledhje e instrumenteve ndërkombëtare, Vëllimi I parë (Pjesa e Parë), Instrumentet e Përgjithshme, Kombet e Bashkuara, New York dhe Gjenevë, 1994, Konventa për të drejtat e fëmijës, fq.230, 231

⁹⁰ Arta Mandro, E drejta familjare, Tiranë 2009, fq.68.

⁹¹ Po aty, fq. 69.

rasti dhe ka mundësi që të jetë në kundërshtim me interesin e tyre, prandaj gjykata nuk do të marrë parasysh dëshirën e tyre do të sjellë vendimin që mendon se është më i drejtë dhe gjithmonë në interes më të mirë të fëmijës.

12. Roli i Qendrës për punë sociale në ushtrimin e së drejtës prindore sipas të drejtës pozitive familjare

Qendra për punë sociale është organi shtetëror i cili është kompetent që në rastet e shkurorëzimit të martesës së bashkëshortëve të analizojë rrethanat dhe të sjellë një vendim të drejtë, gjithmonë në interes të mirë të fëmijëve, se me cilin prind do të vazhdojnë të jetojnë pas shkurorëzimit të martesës nëse ata nuk mund të merren vesh ndryshe. Pas shkurorëzimit të martesës, se kush do të kujdeset për rritjen, edukimin dhe mbikëqyrjen e fëmijëve, gjykata duhet që të vendos gjithmonë në interes të mirë të fëmijëve, duke marrë mendim nga Qendra për punë sociale, e cila ka rolin më të rëndësishëm në vlerësimin e rrethanave në çdo rast konkret. Kjo pyetje ka të bëjë me fëmijët e mitur të përbashkët martesor, si dhe fëmijëve të rritur që iu është vazhduar e drejta prindore. Gjatë vlerësimit të marrëveshjes së bashkëshortëve gjykata ka detyrë të kërkojë mendim nga Qendra për punë sociale dhe nëse vlerëson se marrëveshja është në kundërshtim me interesat e fëmijëve do të sjell vendim të vetin. Qendra për punë sociale ka detyrë që në afat prej 15 ditëve nga pranimi i kërkesës nga gjykata të jep mendim nga paragrafi 1 i këtij neni. Mendim nga paragrafi 1 i këtij neni gjykata do të kërkojë nga Qendra për punë sociale edhe në kontestet kur kërkohet shkurorëzimi i martesës me padi (Neni 256).⁹² Në rastet kur prindërit e fëmijëve nuk jetojnë sëbashku atëherë ato do të merren vesh për mënyrën e mbajtjes së marrëdhënieve personale dhe kontakteve direkte me fëmijën. Nëse prindërit e fëmijës në afat prej dy muajsh nuk pajtohen për mënyrën e mbajtjes së marrëdhënieve personale dhe kontakteve direkte, Qendra për punë sociale do të sjellë aktvendim për këtë. Me rastin e përcaktimit të marrëdhënieve personale dhe kontakteve direkte të fëmijës me prindin, Qendra për punë sociale e informon fëmijën dhe i merr parasysh qëndrimet dhe mendimet e tij në varësi nga moshja dhe shkalla e zhvillimit dhe informon për pasojat e mundshme nga vendimet. Qendra për punë sociale me kërkesë të prindit mundet që prej fillimit të rregullojë mënyrën e mbajtjes së marrëdhënieve personale dhe kontakteve direkte të prindërve me fëmijët nëse këtë e kërkojnë rrethanat e ndryshuara. Mbajtja e marrëdhënieve personale dhe kontakteve direkte të fëmijëve me prindërit mund të kufizohet ose përkohësisht të ndalohet vetëm për shkak të ruajtjes së shëndetit dhe interesave tjera të fëmijës. Në rastet kur nuk realizohet e drejta e fëmijës së mitur që të mbajë kontakte direkte me prindërit dhe të afërmit e tjerë të prindit i cili ka vdekur, të cilit i është marrë e drejta prindore apo për arsyë të tjera është penguar që të ushtrojë të drejtën prindore, Qendra për punë sociale sjell aktvendim për mënyrën e mbajtjes së kontakteve të rregullta. (Neni 79).⁹³ Nga ky nen mund të konkludohet se gjatë sjelljes së vendimit me të cilin përcaktohet mënyra e ushtrimit të së drejtës prindore pas shkurorëzimit si

⁹² Neni 256, LF.

⁹³ Neni 79, LF.


dhe mbajtja e kontakteve të rregullta të fëmijëve me prindërit e tyre, Qendra për punë sociale rëndësi të veçantë i kushton interesit më të mirë të fëmijës. Qendra për punë sociale gjithashtu bën edhe mbikqyrjen e ushtrimit të së drejtës prindërore. Ajo është e obliguar të ndërmerë masa të nevojshme për mbrojtjen e personalitetit, të drejtave dhe interesave të fëmijës. Çdo qytetar, organ dhe person juridik është i obliguar që ta informojë qendrën për punë sociale menjëherë posa ta ketë kuptuar se prindi nuk e ushtron të drejtën prindërore ose për shkaqe të tjera është e nevojshme mbrojtja e personalitetit, të drejtave dhe interesave të fëmijës.⁹⁴(Neni 84). Nga neni 84 i Ligjit për familje mund të vijmë në përfundim se një nga kompetencat e Qendrës për punë sociale është edhe roli mbikëqyrës ndaj prindërve në ushtrimin e të drejtës prindërore, duke u kujdesur që kjo e drejtë të ushtrohet në mënyrë të drejtë dhe pa pengesa. Nëse këtë e kërkojnë interesat e fëmijës Qendra për punë sociale i paralajmëron prindërit për mangësitë në edukim dhe zhvillim të fëmijës dhe u ndihmon që fëmijën ta zhvillojë dhe edukojë drejtë, ndërkohë që ka mundësi që t'i udhëzojë që ato vetë ose së bashku me fëmijën të vizitojnë këshillimorin përkatëse ose ndonjë institucion shëndetësor, social ose edukativ i cili mund të japë këshilla të nevojshme(Neni 85). Nëse këtë e kërkojnë interesat e fëmijës Qendra për punë sociale mund të sjellë aktvendim për mbikëqyrje të përhershme mbi ushtrimin e së drejtës prindërore sa i përket të gjithë fëmijëve ose ndonjërit prej tyre (Neni 86). Qendra për punë sociale me aktvendim mund ta marrë fëmijën nga njëri prind dhe t'ia besojë në ruajtje dhe edukim prindit tjetër, ndonjë personi tjetër ose institucionit përkatës, kur prindërit respektivisht prindi tek i cili jeton femija e lë pas dore fëmijën sa i përket ruajtjes dhe edukimit ose kur ekziston rrezik serioz për zhvillimin dhe mirëritjen e tij të drejtë. Qendra për punë sociale mund të sjellë aktvendim me të cilin prindit i cili më tepër se 3 muaj nuk ka dhënë mbajtje për fëmijën, t'ia kufizojë të drejtën që të mbajë marrëdhënie personale dhe kontakte direkte me fëmijën, gjithnjë derisa nuk i përmbush obligimet ndaj fëmijës. Qendra për punë sociale do të sjellë aktvendim me të cilin prindit të cilit nuk i është besuar fëmija në ruajtje dhe edukim do t'i kufizojë të drejtën e mbajtjes së marrëdhënieve personale dhe kontakteve direkte me fëmijën, nëse pa arsye më tepër se 2 herë pa ndërprerë nuk e ka respektuar aktvendimin e Qendrës për punë sociale. Qendra për punë sociale mund të sjellë aktvendim me të cilin do ta jep fëmijën në qëndrim tek prindi të cilit fëmija nuk i është besuar në ruajtje dhe edukim për një periudhë të caktuar kohore, por jo më gjatë se 15 ditë nëse më tepër se dy herë njëra pas tjetrës prindi tjetër pa arsye nuk e ka respektuar aktvendimin e Qendrës për punë sociale. Qendra për punë sociale do të sjellë aktvendim me të cilin prindit do t'ia kufizojë të drejtën e mbajtjes së marrëdhënieve personale dhe kontakteve me fëmijën ose të njejtat do t'a ndalojë për një periudhë të caktuar kohore, por jo më gjatë se 6 muaj nëse në afatin e përcaktuar me aktvendim nuk e ka kthyer fëmijën ose e ka mbajtur më gjatë se sa koha që është përcaktuar me aktvendim ose e ka dërguar në drejtim të panjohur. Qendra për punë sociale do të sjellë aktvendim me të cilin përkohësisht fëmijën do t'ia besojë prindit tjetër, personit të tretë ose do ta vendosë në familje tjetër ose ndonjë institucion përkatës, si zgjidhje e fundit nëse ka dijeni se marrëdhëniet personale dhe kontaktet direkte të fëmijës janë ndërprerë më gjatë se dy muaj për shkak të mosveprimit konform aktvendimit të Qendrës për punë sociale nga ana e prindit të cilit i është besuar fëmija ose për shkak të marrëdhënieve të tronditura te

⁹⁴ Neni 84, LF.

bashkëshortëve të cilat ndikojnë në mënyrë të dëmshme në zhvillimin e fëmijëve. Me marrjen e fëmijës nuk pushojnë të drejtat dhe detyrat e tjera të prindërve ndaj fëmijës. (Neni 87).⁹⁵

13. Roli i Avokatit të popullit në mbrojtjen e interesit më të mirë të fëmijës sipas të drejtës pozitive

Avokati popullit është organ i Republikës së Maqedonisë i cili i mbrojt të drejtat kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve dhe të gjithë personave tjerë kur ato u shkelen me akte, veprime dhe lëshime të veprimeve nga organet e administratës shtetërore dhe nga organet dhe organizatat tjera që kanë autorizime publike dhe i cili ndërmerr masa dhe veprime për mbrojtjen e parimeve të mosdiskriminimit dhe përfaqësimit adekuat dhe të drejtë të pjesëtarëve të bashkësive në organet e pushtetit shtetëror, organet e njësive të vetadministrimit lokal dhe të enteve dhe shërbimeve publike.⁹⁶ Avokati i popullit ndër veprimtaritë e tij të shumta, kujdes dhe vëmendje të veçantë u kushton fëmijëve duke insistuar në ushtrimin e vazhdueshëm dhe respektimin e të drejtave të parapara në Konventën për të drejtat e fëmijëve, akteve ligjore dhe nënligjore në Republikën e Maqedonisë. Nga statistikat e institucionit të Avokatit të popullit për periudhën e viteve 2006-2011 është vërtetuar se dukshëm është në rritje numri i parashtrësive të dorëzuara te Avokati i popullit nga fusha e të drejtave të fëmijëve edhe atë siç vijon në tabelën më poshtë:



Parashtresa të dërguara te Avokati i popullit⁹⁷

⁹⁵ Neni 87, LF.

⁹⁶ <https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2013/11/Zakon-za-narodniot-pravobranitel-22-09-2003.pdf>
02/02/2020; 10:28

⁹⁷ <http://ombudsman.mk/upload/documents/2012/Licni%20kontakti%20dete%20roditel%2025.06.2012.pdf>
12/01/2020; 13:45

Ankesat për pamundësinë e mbajtjes së marrëdhënieve personale dhe kontakteve të fëmijës me prindin me të cilin nuk jeton ose me të afërmit e tij, pengesat për nxjerrjen e pasaportës së fëmijës, pagesa të parregullta të alimentacionit, ankesa të ndërrsjellta për neglizhencë dhe kujdes të pamjaftuëshëm për fëmijën, janë disa nga ankesat më të shpeshta të prindërve, ku fëmija mbetet në mes të konflikteve, mosmarrëveshjeve dhe fajësimeve ndërmjet prindërve, të cilët në kërkesat e tyre shumë shpesh shprehin pakënaqësi në punën e Qendrës për punë sociale, më sakt nga vendimet e ekspertëve ligjor. Avokati i popullit pa përjashtim ka kërkuar nga Qendra për punë sociale, Ministria për punë dhe politike sociale, si dhe nga institucionet publike të mbikëqyrjes që të respektohet e drejta e mbajtjes së marrëdhënieve personale, si dhe kontakteve të fëmijëve me prindër/it, duke treguar se kjo e drejtë mund të jetë edhe e kufizuar nëse është në kundërshtim me interesin më të mirë të fëmijës. Nga ana tjetër, padyshim se shkeljen e kësaj të drejte, si dhe principin e interesit më të mirë të fëmijës mund t'a vërtetojë vetëm një ekip profesional ekspertësh, por për fat të keq në shumicën e rasteve kjo e drejtë nuk ishte e mbrojtur në mënyrë të drejtë. Në të shumtën e rasteve, përveç sugjerimeve të vazhdueshme, rekomandimeve, punës këshilluese si dhe kërkesave për mbikëqyrje, qendrat për punë sociale nuk kanë arritur që të rivendosin kontaktet e ndërprera të fëmijës me prindërin, as të ndikojnë në përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet prindërve si dhe në këtë kontekst edhe qëndrimin e fëmijës që të shihet ose mos të shihet dhe të kontaktojë me prindin tjetër që përsëri është në dëm të fëmijës dhe të drejtës së tij që të jetë së bashku me të dy prindërit. Jotoleranca, hakmarrja e ndërsjelltë si dhe jokomunikimi i prindërve respektivisht ish-bashkëshortëve arriti deri në atë pikë sa të mos lejojnë që fëmija të nxjerrë dokument udhëtimi-pasaportë, edhe pse kjo është një e drejtë e fëmijëve e garantuar nga Konventa për të drejtat e fëmijëve. Gjithashtu u vunë re situata kur njëri nga prindërit nuk jepte pëlqim që fëmija të nxjerrë dokument udhëtimi- pasaport duke dyshuar se prindir tjetër do të keqpërdorë këtë të drejtë dhe do të largohet jasht vendit se bashku më fëmijën pa pëlqimin e prindit tjetër si dhe pa njoftim paraprak të qendrës kompetente. Ka pasur situata kur qendra për punë sociale si organ që kujdeset për të drejtat dhe interesat e fëmijëve ka dhënë pëlqim në vend të prindit që kundërshtonte, ndërsa në praktikë është vërtetuar se ekziston frika e largimit të fëmijës me prindin tjetër, duke hedhur kështu në dyshim veprimin e ekspertëve të Qendrës për punë sociale. Avokati i popullit, duke pasur parasysh interesin më të mirë të fëmijës si dhe kompetencat e Qendrës për punë sociale si institucion publik i cili duhet të kujdeset për të drejtat e fëmijëve tregon se është shumë e rëndësishme që vazhdimisht të ndiqet gjendja në familje, të bëhet mbikëqyrje në ushtrimin e së drejtës prindore, si dhe marrëdhëniet e ish bashkëshortëve si dhe fëmijëve, me qëllim që në kohë të ndërmerren masa dhe të parandalohen situatat e mos respektimit të detyrimeve për informim dhe veprim në pajtim me aktet e Qendrës për punë sociale.⁹⁸ Në disa raste, Avokati i popullit duke i rikujtuar prindërit që të komunikojnë ndërmjet vete si detyrim në interes të fëmijës, ka kontribuar në parandalimin e pasojave të dëmshme ndaj fëmijëve si dhe në rritjen dhe zhvillimin e duhur sepse në rastet kur janë të tërhequr nga njëri prind ose tjetri, shumë lehtë mund që të mbyllen në vetvete, të manifestojnë sjellje të papërshtatshme ose mund të kenë probleme në sjellje të cilat vështirë se mund të rregullohen ndërsa në shtetin tonë nuk kemi kushte të përshtatshme as për

⁹⁸ <http://ombudsman.mk/upload/Godisni%20izvestai/GI-2017/GI-2018.pdf> 03/02/2020; 22:15

kujdesje, as për përmirësimin e tij ose risocializim. Në këtë fushë, disa nga prindërit, përfshirë edhe prindërit të cilët janë duke vuajtur dënimin me burg në instituonet e vuajtjes së dënimit kanë kërkuar mbrojtje të të drejtave të fëmijëve nga sjellja e prindit tjetër, neglizhenca dhe moskujdesi i tij ndaj fëmijës, prej nga Avokati i popullit për vërtetim të një gjendje të tillë ka angazhuar Qendrën për punë sociale që të bëjë mbikëqyrjen e gjendjes familjare duke biseduar me prindin dhe fëmijën (varësisht nga mosha) dhe varësisht nga rrethanat të ndërmerr masat e duhura. Të gjitha rastet e tilla nxjerrin në pah nevojën e qendrave efikase dhe kualitative për këshillim, të martesës dhe familjës, si dhe krijimin e një sistemi të ndjekjes aktive nga ana e shërbimit social, fëmijëve dhe familjeve që janë në rrezik, në bashkëpunim me autoritetet lokale për arsim, shëndetësi si dhe bashkëpunim me shoqatat e qytetarëve, që ishte edhe rekomandim i Avokatit të popullit në raportet e tij të mëparshme.⁹⁹

⁹⁹ <http://ombudsman.mk/upload/Godisni%20izvestai/GI-2017/GI-2018.pdf> 03/02/2020; 22:15

Kapitulli III

Të drejtat dhe obligimet e prindërve dhe fëmijëve pas shkurorëzimit

1. Ushtrimi i së drejtës prindore nga ana e njërit prind

Kur martesë zgjidhet me pajtim të ndërsjellë të bashkëshortëve martesor, ndërsa bashkëshortët kanë fëmijë të mitur apo madhor të cilëve u është vazhduar e drejta prindore, mënyra e ushtrimit të të drejtave prindore dhe për besimin e fëmijëve për ruajtje dhe edukim parashtrëhet me shkrim ose gojarisht në procesverbal në gjykatën e shkallës së parë. (neni 253 paragraf. 1 Ligji për familje). Gjatë vlerësimit të marrëveshjes së bashkëshortëve gjykata ka detyrë të kërkojë mendim nga Qendra për punë sociale dhe nëse vlerëson se marrëveshja është në kundërshtim me interesat e fëmijëve do të sjellë vendim të vetin.

2. Mbjajtja e kontakteve me prindin tjetër

Mbjajtja e kontakteve të prindit me fëmijën paraqitet më problematike në rastet kur ata nuk jetojnë bashkërisht, për arsye të ndryshme. Në rastet kur gjykata ka sjellë vendim që fëmija pas shkurorëzimit të vazhdojë të jetojë vetëm me njërin prind, me tjetrin do të vazhdojë që të mbajë kontakte. Mirëpo, këto kontakte mund edhe të kufizohen ose të ndërpriten kur kjo kërkohet nga interesat më të larta të fëmijës. Madje, kur nuk është në favor të interesave të fëmijës që ky të mbajë marrëdhënie me prindin me të cilin nuk jeton, mund të vijë në shprehje të ashtuquajturat marrëdhënie të mbikëqyrura ose forma të tjera të marrëdhënieve me këtë prind. Në të drejtën e krahasuar dhe në literaturën juridike gjithatë, është diskutuar për disa aspekte kontradiktore në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e fëmijëve dhe prindërve që në mes veti të mbajnë marrëdhënie personale. Pyetja e parë që shtrohet është se a është subjekt i së drejtës të mbajtjes së marrëdhënieve personale prindi i cili nuk jeton në bashkësinë familjare me fëmijën apo është fëmija. Sot janë të pakta ligjet të cilat parashohin se bëhet fjalë për të drejtat e prindërve, të tjerët parashohin të drejtën e fëmijëve, ndërsa disa legjislatore mbajtjen e kontakteve e definojnë si e drejtë e fëmijëve dhe njëkohësisht si e drejtë dhe detyrim i prindit që të mbajë marrëdhënie personale me fëmijën e tij.¹⁰⁰ Në literaturën juridike konsiderohet se është e drejtë dhe jo detyrim-prindi me fëmijën e tij të mbajë marrëdhënie personale dhe se mund të konsiderohet vetëm si detyrim moral i prindërve, për mos përmbushjen e së cilës nuk është paraparë ndonjë sanksion direkt apo indirekt. Për më tepër nëse mbajtja e kontakteve të prindit me fëmijën do të ishte detyrim atëherë kjo për fëmijën do të ishte krejtësisht e pavlerë.

¹⁰⁰ Marija Draskic, Porodico pravo i pravo deteta, Beograd 2007, fq.263.

- Pyetja tjetër është nëse mbajtja e kontakteve të prindit me fëmijën paraqet pjesë përbërëse të së drejtës prindore ose jo. Disa jurist mbajnë qëndrimin se kjo e drejtë nuk ka atribut në të drejtën prindore, pasi ajo është një marrëdhënie direkte prind- fëmijë dhe se zakonisht mbajtja e kontakteve të prindërve me fëmijët shpesh herë zgjerohet edhe më të afërmit e tjerë.
- Në të drejtën e krahasuar dukshëm ekziston zgjerimi rrethit të personave të cilëve u njihet e drejta e mbajtjes së kontakteve me fëmijët edhe atë jo vetëm të afërmit e gjakut (gjyshërit, stërgjyshërit, motrat, vllazërit) por edhe personat e tjerë me të cilët fëmija ka pasur afërsi të veçantë dhe të cilët kanë pasur një rol të veçantë në jetën e fëmijës.¹⁰¹

Nëse ndërmjet prindërve ka konflikt në lidhje me mënyrën e ushtrimit të kësaj të drejte të fëmijës, koha dhe kohëzgjatja e takimeve të tyre do të vendoset nga gjykata. Mbajtja e kontakteve direkte si dhe marrëdhënieve personale të prindit me fëmijën i cili sipas aktgjyqimit të sjellë nga Gjykata, e bazuar në aktvendimin e Qendrës për punë sociale, vazhdon të jetojë me prindin tjetër, shpesh herë pengohet që të ushtrohet në mënyrë të drejtë dhe të rregullt, duke bërë shkelje të kësaj të drejtë nga ana e prindit të cilit i është dhënë në rruajtje dhe edukim fëmija.

Shembull nga praktika:

Parashtresë

Lëmia: Sociale

Vepron: Avokati i popullit- Tetovë

Dërguar: Qendrës për punë dhe politikë sociale- Tetovë

Lënda: **Kërkesë për shpjegim, informacion dhe dëshmi në lidhje me parashtresën**

Deri te Avokati i popullit është dërguar parashtresë nga personi me initiale B.A, në të cilën kërkohen intervenim në institucionin shtetëror të Qendrës ndërkomunale për punë sociale- Tetovë, për shkak të shkeljes të së drejtës që të mbajë kontakte me fëmijën e tij. Në parashtresë pala pohon se martesë ndërmjet tij dhe bashkëshortes së tij është e shkurorëzuar me aktgjykim të Gjykatës themelore- Tetovë, ndërsa Qendra ndërkomunale për punë sociale në Tetovë kishte sjellë aktvendim me të cilën ishin rregulluar marrëdhëniet personale dhe mbajtja e kontakteve të prindit me vajzën e tij, e cila i ishte dhënë në rruajtje dhe mbikëqyrje nënës. Parashtruesi pohon se takimet me vajzën nuk janë realizuar radhazi disa herë, i cili për këtë arsye e kishte njoftuar Qendrën për punë sociale. Për shkak se nuk është ndërmarrë asnjë veprim për tejkalim të gjendjes, parashtruesi kërkon nga Avokati i popullit mbrojtjen e të drejtës së tij. Duke u nisur nga interesi më i mirë i fëmijës dhe e drejta e tyre që të vazhdojë të mbajë marrëdhënie personale dhe kontakte të rregullta me prindin me të cilin nuk jeton në rastin konkret me babain, në përputhje me nënin 24 të Ligjit të

¹⁰¹ Marija Draskic, Porodico pravo i pravo deteta, Beograd 2007, fq.263

Avokatit të popullit (Gazeta zyrtare e RMV, nr. 60/03, 114/09, 181/16, 189/16 dhe 35/18), Avokati i pupullit kërkon nga ekipi profesional që punojnë në Qendrën për punë sociale që të njoftohet për shkaqet që pengojnë ushtrimin e të drejtës së prindit që të shihet më fëmijën e tij, cilat masa do të ndërmërrën për tejkalim të situatës si dhe masat eventuale ndaj nënës e cila ka penguar mbajtjen e kontakteve të rregullta të fëmijës me prindin respektivisht shkeljen e aktvendimit të Qendrës për punë sociale. Në bazë të nenit 24, paragrafi 1, alineja 1 e Ligjit të Avokatit të popullit (Gazeta zyrtare e RMV, nr. 60/03, 114/09, 181/16, 189/16 dhe 35/18) është e nevojshme në afat prej tetë ditëve nga dita e pranimit të kësaj kërkesë deri te Avokati i popullit të dorëzohen informactate kërkuara, bashkangjitur edhe dokumentacionet përkatëse (dëshmi) për ndërmarrje të veprimeve konkrete të Qendrës kompetente në rastin konkret.¹⁰² Kësaj kërkesë, Qendra për punë sociale i përgjigjet duke i dorëzuar Avokatit të popullit informatat e kërkuara bashkëngjitur edhe njoftimin dërguar palës në lidhje me kërkesat e tij drejtuar Avokatit të pupullit.

Nga Qendra për punë sociale drejtuar palës B.A

Lënda: Njoftim

Qendra për punë sociale ju njofton: Me aktvendimin nr.08-90 nga viti 03.05.2019, të sjellë nga Qendra për punë sociale- Tetovë, për mbajtjen e marrëdhënieve personale dhe kontakte të rregullta në mes ju si prind i dy fëmijëve të mitur R.I dhe L.I, të cilët me aktgjykim të Gjykatës Themelore, i mituri R.I të është dhënë në rruajte, edukim dhe mbikëqyrje të mëtutjeshme si baba i fëmijës, përderisa e mitura L.I i është dhënë nënës. Qendra për punë sociale ka sjellë aktvendim për mbajtjen e kontakteve të të miturve, vendim i cili nuk respektohet dhe nuk realizohet nga asnjëra anë e prindërve. Për këtë shkak ju informojmë se: 1.Si prind të cilit i është dhënë në rruajte, edukim dhe mbikëqyrje të mëtutjeshme i mituri R.I, ju informojmë se aktvendimi i sjellë nga Qendra për punë sociale duhet të respektohet në mënyrë të përgjegjshme, respektivisht jeni të detyruar që të mos pengoni ushtrimin e të drejtës së mbajtjes të marrëdhënieve dhe kontakteve të rregullta të nënës me të miturin R.I. Në bazë të Ligjit për familje fëmijët kanë të drejtë që të mbajnë marrëdhënie personale dhe kontakte të rregullta me prindin me të cilin nuk jetojnë. 2.Prindi me të cilin nuk jetojnë fëmijët e mitur, ka të drejtë dhe detyrim të mbajë marrëdhënie personale dhe kontakte të rregullta me fëmijët e tij. 3. Në raste të mos respektimit të aktvendimit respektivisht mosrealizimi i mbajtjes së kontakteve ndërjet fëmijëve të mitur dhe prindërve të tyre, ekipi profesional duke marrë parasysh të drejtën, interesin dhe personalitetin e fëmijëve të mitur, ju njofton se në raste të mos respektimit të aktvendimit do të ndërmarrë masa ndëshkuese në përputhje me Ligjin për familje.¹⁰³ Bashkangjitur këtij njoftimi nga ana e Qendrës për punë dhe politikë sociale, shërbimi për martesë dhe familje, deri të Avokati i popullit dorëzon këtë njoftim:

¹⁰² Rast konkret, Parashtrësë dërguar në Institucionin e Avokatit të Popullit, Zyra Tetovë, (НП бр. 2358/19 од 17.09.2019 год. Тетово, До: Јавна Установа Меѓуопштински Центар за социјални работи Тетово, Предмет: барање, објаснување, информации и докази за наводите во претставката).

¹⁰³ Rast konkret, Nga Qendra për punë sociale, Njoftim dërguar palës, në lidhje me parashtrësën e dërguar në Institucionin e Avokatit të Popullit, Zyra Tetovë, (НП бр. 2358/19 од 17.09.2019 год. Тетово).

Në bazë të kërkesës suaj, për shpjegim, informacione dhe dëshmi në lidhje me parashtrësën e palës B.I, ekipi i ekspertëve nga Qendra për punë sociale ju njofton se:

1. Në bazë të aktgjykimit të Gjykatës themelore i miturit R.I, në rruatje dhe edukim të mëtutjeshëm i është dhënë babait, ndërsa e mitura L.I nënës. Me kërkesë më shkrim për mbajtje të marrëdhënieve personale dhe kontakteve të rregullta të prindërve me fëmijët janë drejtuar të dy prindërit. Ekipi i profesional pranë Qendrës për punë sociale, nga marrëveshja e vetë prindërve ka sjellë aktvendim i cili nuk zbatohet në tërësi nga ana e të dy prindërve.
2. Në lidhje me zbatimin e aktvendimit, janë ndërmarrë aktivitetet në vazhdim:
Ekipi i profesional pranë Qendra për punë sociale, u bën thirrje për bisedime të dy prindërit me qëllim të forcimit të kapaciteteve prindore si dhe të sigurohen se të dy posedojnë të drejta të barabarta prindore, si dhe në lidhje me mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të fëmijëve të tyre të mitur.
Të dy prindërit në Qendrën për punë sociale kanë dhënë deklaratë me shkrim, për shkaqet e mosrealizimit të së drejtës së mbajtjes të marrëdhënieve personale dhe kontakteve direkte me fëmijën e mitur, si dhe deklaratat me shkrim të nënës për arsyet e mosrrespektimit të aktvendimit.

Me marrjen e informacioneve nga Qendra për punë sociale, Avokati i popullit i përgjigjet me shkrim parashtrësës së palës, i cili në përputhje me kompetencat ligjore të nenit 24, paragrafi 1 dhe alineja 1 të Ligjit për Avokatin e popullit (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr.60/03, 114/09, 181/16 dhe 186/16) me shpresë u drejtua deri te Institucioni publik Qendra ndërkomunale për punë sociale Tetovë me çka kërkoi sqarim dhe informatë në lidhje me rastin. Avokati i popullit duke u nisur nga interesi më i mirë për fëmijën dhe të drejtën e tij për të realizuar marrëdhënie dhe kontakte të rregullta dhe personale me prindërit me të cilët nuk jeton, kërkoi të njoftohet mbi pohimet në parashtrësë, përkatësisht me arsyet e mosrrespektimit të aktvendimit, cilat masa po merren për tejkalim të gjendjes sipas njoftimeve të dërguara nga ana palës. Nga përgjigja e kërkesës nga Ekipi profesional i Qendrës për punë sociale, ku theksohet se është sjellë aktvendim për mbajtje të marrëdhënieve personale dhe kontakteve të rregullta, por ky aktvendim nuk është respektuar në tërësi nga ana e të dy prindërve. Duke pasur parasysh sqarimin e dhënë nga Qendra për punë sociale për rastin për të cilin edhe pala është i njoftuar, Avokati i popullit e vlerësoi se nuk ka bazë për vazhdimin e mëtejshëm të procedurës për çka e njoftoi palën që e njejtat ndërpritet të përputhje me nenin 23, paragrafi 1 dhe alineja 1 të Ligjit për Avokatin e popullit (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr.60/03, 114/09, 181/16 dhe 186/16).

3.Ushqimia (mbajtja) e anëtarëve të familjes

Ushqimia (mbajtja) e anëtarëve të familjës, në Republikën e Maqedonisë është e rregulluar me Ligjin për familje nga neni 178 deri në nenin 202. Ushqimia e anëtarëve të familjes dhe familjarëve të tjerë është e drejtë dhe detyrim i tyre. Në rastet kur ushqimia reciproke e anëtarëve të familjes dhe familjarëve të tjerë nuk mund të realizohet tërësisht ose pjesërisht, Republika anëtarëve të pasiguruar të familjes ju siguron mjete të nevojshme për ushqim nën kushtet e përaktuara me ligj. Heqja dorë nga e drejta e ushqimisë nuk prodhon efekt juridik. Prindërit janë të obliguar t'i ushqejnë fëmijët e tyre. Nëse shkollimi dhe arsimimi profesional i fëmijëve vazhdon edhe pas moshës madhore, prindërit janë të detyruar t'i ushqejnë edhe më tutje fëmijët e tyre deri në përfundimin e shkollimit të rregullt e më së voni deri në moshën 26 vjeçare, ndërsa nëse fëmija edhe pas arritjes së moshës madhore është i paafatë për punë për shkak të sëmundjes, të metave fizike apo psiqike, ndërsa nuk ka mjete të mjaftueshme për jetë, prindërit janë të detyruar t'a ushqejnë derisa zgjat ajo paafhtësi. Fëmijët janë të obliguar tu japin udhqim prindërve të tyre të cilët janë të paafatë për punë, të cilët nuk kanë mjete të mjaftueshme për ushqim ose mjetet për ushqim nuk mund t'i realizojnë nga prona e tyre. Me përjashtim gjykata ka mundësi të refuzojë kërkesën për ushqim të prindit të cilit i është marrë e drejta prindore edhe pse fëmija ka mundësi, ose kur gjykata duke i vlerësuar të gjitha rrethanat e rastit, konkludon se kjo do të paraqes padrejtësi evidente ndaj fëmijës. Ushqimia si detyrim ekziston edhe ndaj bashkëshortit. Në rastet kur bashkëshorti nuk ka mjete të mjaftueshme për ushqim dhe është i paafatë për punë osë është i papunë pa fajin e tij, ka të drejtë në ushqim nga ana e bashkëshortit të vet në proporcion me mundësitë e tij. Gjykata duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit mund të refuzojë kërkesën për ushqim në qoftë se këtë e kërkon bashkëshorti i cili me qëllim të keq ose pa shkaqe të aryeshme e ka braktisur bashkëshortin nga i cili kërkon ushqiminë. Bashkëshorti i pasiguruar ka të drejtë të kërkojë që me anë të aktgjykimit me të cilin shkurorezohet martesja, të caktohet një shumë e caktuar e të hollave në emër të ushqimisë në barrë të bashkëshortit tjetër në proporcion me mundësitë e tij. Me përjashtim, bashkëshorti ka mundësi që me anë të padisë së veçantë, me afat prej një viti pas pushimit të martesës të kërkojë ushqimi vetëm nëse kushtet për ushqiminë kanë ekzistuar që në momentin e përmbylljes së seancës kryesore të procedurës për shkurorezim të martesës dhe pandërprerë kanë vazhduar deri në përmbylljen e seancës kryesore në procedurën për ushqimi. Gjykata mund të refuzojë kërkesën për ushqim nëse këtë e kërkon bashkëshorti i cili pa shkak serioz është sjellë në mënyrë të vrazhdë dhe të padrejtë në bashësinë martesore ose kërkesa e tij do të paraqiste padrejtësi evidente për bashkëshortin tjetër. Gjykata mund që ta refuzojë kërkesën për ushqim nëse bashkëshortët në një periudhë më të gjatë se kanë jetuar të ndarë, plotësisht në mënyrë të pavarur kanë siguruar mjete për ushqim, ose nga rrethanat e rastit vërtetohet se bashkëshorti që kërkon ushqim nuk është sjellë në gjendje më të vështirë materiale se sa ka qenë para lidhjes së martesës. E drejta në ushqim të bashkëshortit të mëparshëm të përmbajtur, zgjat më së shumti 5 vjet pas shkurorezimit apo anulimit të martesës. Me kërkesë të bashkëshortit, gjykata mund të vazhdojë të drejtën për ushqim edhe pas kalimit të afatit të paraparë, nëse vërtetohet se për këtë ekzistojnë shkaqe të aryeshme, e veçanërisht nëse bashkëshorti i përmbajtur edhe pas

kalimit të këtij afati nuk do të jetë në gjendje të sigurojë udhëqim. E drejta e bashkëshortit të mëparshëm për ushqim pushon kur të pushojnë kushtet në bazë të të cilave i takon e drejta e ushqimisë, kur të kalojë koha për të cilën është paraparë ushqimia dhe kur bashkëshorti i mëparshëm që pranon ushqimin do të lidhë martesë të re gjegjësisht do të hyjë në bashkësi jashtmartesore. Në kontestin e prindërve në lidhje me përmbajtjen e fëmijëve, gjykata si kontribut për përmbajtjen e fëmijës, prindit të cilit i është besuar për rruajtje dhe edukim, do të vlerësojë punën dhe kujdesin që ai prind e jep në edukimin dhe ngritjen e fëmijës. Lartësinë e ushqimisë gjykata mund ta përcaktojë në vlerë të caktuar apo në përqindje me të ardhurat e realizuara personale, gjegjësisht nga fitimi dhe të ardhurat e realizuara nga ndonjë veprimtari tjetër. Qendra për punë sociale në emër të fëmijës së mitur mund të iniciojë kontest për ushqim, gjegjësisht për rritjen e vlerës së ashtuquajtur, kur prindi tek i cili gjendet fëmija për rruajtje dhe edukim, pa shkaqe të arsyeshme, nuk e shfrytëzon këtë të drejtë. Gjithashtu Qendra për punë sociale do të insistojë që prindërit të arrijnë marrëveshje lidhur me ushqimin e fëmijës, gjegjësisht për rritjen e kontributit në ushqimin e fëmijës kur atë e kërkon nevoja e zmadhuar e fëmijës apo atë e mundëson gjendja e përmirësuar materiale e ushqimdhënësit.¹⁰⁴

4. Mundësia e marrjes të së drejtës prindore prindit që i është dhënë fëmija

Me aktgjykimin me të cilin shkurorëzohet martesa nëse palët nuk kanë marrëveshje gjykata vendos edhe për atë se me cilin prind do të vazhdojë të jetojë fëmija pas ndarjes së prindërve. Ekziston mundësia që fëmija të merret nga prindi të cilit i është besuar në rruajtje, edukim dhe mbikëqyrje. Qendra për punë sociale mund që me aktvendim ta marrë fëmijën nga njëri prind dhe t'ia besojë në rruajtje dhe edukim prindit tjetër, ndonjë personi tjetër ose institucionit përkatës, kur prindërit respektivisht prindi tek i cili jeton fëmija e lë pas dore fëmijën sa i përket rruajtjes dhe edukimit ose kur ekziston rrezik serioz për zhvillimin dhe mirërritjen e tij të drejtë.¹⁰⁵ Qendra për punë sociale mund të sjellë aktvendim me të cilin prindit i cili më tepër se 3 muaj nuk ka dhënë mbajtje për fëmijën t'ia kufizojë të drejtën që të mbajë marrëdhënie personale dhe kontakte direkte me fëmijën gjithnjë derisa nuk i përmbush obligimet ndaj fëmijës.¹⁰⁶ Gjithashtu Qendra për punë sociale do të sjellë aktvendim me të cilin përkohësisht fëmijën do t'ia besojë prindit tjetër, personit të tretë ose do ta vendosë në familje tjetër ose në institucion përkatës, si zgjidhje e fundit nëse ka dijeni se marrëdhëniet personale dhe kontaktet direkte të fëmijës janë ndërprerë më gjatë se dy muaj për shkak të mosveprimit konform të aktvendimit të Qendrës për punë sociale nga ana e prindit të cilit i është besuar fëmija ose për shkak të marrëdhënive të tronditura të bashkëshortëve të cilat ndikojnë në mënyrë të dëmshme në zhvillimin e fëmijëve. Prindit i cili e keqpërdor ushtrimin e së drejtës prindërore ose e anashkalon rëndë ushtrimin e obligimeve prindërore pas marrjes së mendimit nga Qendra për punë sociale i merret ushtrimi i së drejtës prindërore me

¹⁰⁴ Neni 178-202, Lf.

¹⁰⁵ Neni 87, LF.

¹⁰⁶ Neni 87, LF.

aktvendim të gjykatës në procedurë jokontestimore. Si keqpërdorim ose anashkalim të rëndë të obligimeve prindërore, në lidhje me paragrafin 1 të këtij neni, do të llogaritet nëse prindi: Ushtron dhunë fizike ose emocionale ndaj fëmijut e detyron fëmijun në punë e cila nuk i përgjigjet moshës së tij; I lejon përdorimin e alkoholit, droga ose substancave tjera psikotropike, e shfrytëzon fëmijun si lypës, E drejton fëmijun në sjellje shoqërore të papranueshme; E braktis fëmijun dhe më gjatë se tre muaj nuk kujdeset për fëmijun; Në cfarëdo qoftë mënyre tjetër të dhunshme i shkel të drejtat e fëmijut. Prindit mund që t'i hiqet e drejta e ushtrimit të së drejtës prindërore mbi të gjithë fëmijët ose mbi ndonjërin nga ato.¹⁰⁷

Praktikë gjyqësore

Janë të plotësuar plotësisht kushtet për marrjen e të drejtës prindore prindit i cili pengon mbajtjen e kontakteve të fëmijës me prindin tjetër me të cilin nuk jeton fëmija, dhe në ndërkohë e malltregon fizikisht dhe psikikisht fëmijën, për të cilën me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor dënohet për veprën penale dhunë në familjë.¹⁰⁸ Nëse këtë e kërkojnë interesat e fëmijës Qendra për punë sociale i paralajmëron prindërit për mangësitë në edukim dhe zhvillimin e fëmijës dhe u ndihmon që fëmijën ta zhvillojnë dhe edukojnë drejtë, ndërkohë që ka mundësi t'i udhëzojë që ato vetë ose së bashku me fëmijën të vizitojnë këshillimoren përkatëse ose ndonjë institucion shëndetësor, social ose edukativ i cili mund të japë këshilla të nevojshme.¹⁰⁹

5. Mbikëqyrja në ushtrimin e të drejtës prindore

Qendra për punë sociale bën mbikëqyrjen e ushtrimit të së drejtës prindërore. Është e detyruar të ndërmer masa të nevojshme për mbrojtjen e personalitetit, të drejtave dhe interesave të fëmijës. Çdo qytetar, organ dhe person juridik është i obliguar që ta informojë qendrën për punë sociale menjëherë posa të ketë kuptuar se prindi nuk e ushtron të drejtën prindërore ose për shkaqe të tjera është e nevojshme mbrojtja e personalitetit, të drejtave dhe interesave të fëmijës.¹¹⁰ Nëse këtë e kërkojnë interesat e fëmijës Qendra për punë sociale mund të sjellë aktvendim për mbikëqyrje të përhershme mbi ushtrimin e së drejtës prindërore sa i përket të gjithë fëmijëve ose ndonjërit prej tyre.¹¹¹

¹⁰⁷ Neni 90, LF.

¹⁰⁸ Дејан Мицковиќ, Ангел Ристов, Закон за семејството, Скопје, 2015, fq.176

¹⁰⁹ Neni 85, LF .

¹¹⁰ Neni 83,84, LF.

¹¹¹ Neni 86, LF.

KAPITULLI IV

Kushtet e nevojshme për ushtrimin e së drejtës prindore pas shkurorëzimit

1.Kushtet që duhet ti plotësojë prindi

Nuk ekzistojnë kushte të përcaktuara me ligj të cilat duhet ti plotësojë prindi që të mund të përkujdeset për fëmijët. Mirëpo nga praktika kemi raste të ndryshme në bazë të të cilave mund të konkludojmë edhe disa kushte të cilat i merr parasysh Qendra për punë sociale në momentin kur vlerëson dhe sjell vendimin se me cilin nga prindërit do të jetojë fëmija apo cili prind është i aftë që të përkujdeset për mbikëqyrjen, rritjen dhe edukimin e fëmijës gjithmonë në interes më të mirë të tij.

Nga praktika gjyqësore:

- Punësimi i prindit të cilit fëmija i është dhënë në përkujdesje, si fakt i vetëm nuk mund çdoherë të paraqes shkak të konsiderohet se ekzistojnë rrethana të cilat kushtëzojnë edhe ndryshimin e vendimit me të cilin i është dhënë në kujdesje fëmija.
- Gjendja e mirë materiale e njërit prind të cilit i është dhëna fëmija në përkujdesje është vetëm një nga kushtet, mirëpo nuk është i mjaftueshëm për dhënien e fëmijës në përkujdesje atij prindi. Gjendja material e prindërve është e rëndësishme në lidhje me lartësinë e mbajtjes (alimentacionit).
- Faji i njërit bashkëshort për prishjen e marrëdhënieve bashkëshortore nuk mund të paraqes pengesë për të që ti jepet fëmija në përkujdesje, përderisa interesat e fëmijëve kërkojnë që të jetë me të. Mirëpo gjatë vendosjes duhet të merret parasysh nëse faji për prishjen emarrëdhënieve bashkëshortore nuk është i natyrës së tillë që nga vetë fakti tregon se do të ishte në dëm të interesave të fëmijës dhe zhvillimit të tij që ti jepet atij prindi në përkujdesje.
- Gjatë vendosjes për mbajtjen e kontakteve të prindërve me fëmijët e tyre nga martesa e shkurorëzuar, organi i kujdestarisë mund të urdhëroje prindin të cilit ia ka dhënë në përkujdesje fëmijën ti mundësojë prindit tjetër përveç kontakteve të rregullta një ditë në javët, gjithashtu të lejojë që vikendin prej dy deri në tre ditë një herë në muajt të kalojë me prindin tjetër si dhe në kohën e pushimeve vjetore të lejojë që prindi tjetër të mund ta merr fëmijën dy deri 3 javë.¹¹²
- Nëse kontaktimi i prindërve me fëmijët nëpërmjet telefonit është i vendosur dhe rregulluar, si dhe është në funksion të mbajtjes së marrëdhënieve personale të fëmijës me prindin, kjo e drejtë e prindërve nuk mund të ndërpritet.

¹¹² Дејан Мицковиќ, Ангел Ристов, Семејно Право, Скопје, 2015, fq.226

- Patjetër duhet që të ekzistojnë rrethana të posaçme që janë në interes të fëmijëve te mitur që të ndahen dhe njëri ti jepet babait ndërsa tjetri nënës.
- Vendimi për dhënien e fëmijës së mitur në përkujdesje të njërit prind mund të ndryshohet përderisa kanë ndryshuar rrethanat posaçërisht kur fëmija deklaron se dëshiron të jetojë me prindin tjetër.

2. Mosha e fëmijës si kusht

Qendra për punë sociale gjatë vendosjes se cilit prind do t'ia japë në përkujdesje fëmijët gjithmonë do të niset në interes të mirë të fëmijës, duke i kushtuar rëndësi të veçantë edhe moshës së fëmijës. Ndarja e prindërve zakonisht është një situatë që vështirë pranohet nga fëmijët, veçanërisht kur ato janë në moshë të mitur, prandaj mosha e fëmijës ka një rëndësi të veçantë në sjelljen e vendimit se me cilin prind do të vazhdojë të jetojë. Fëmijët në moshë të re gjithmonë kanë nevojë më shumë që të rriten në prani të nënës së tyre edhe pse ka raste kur mund të jetë në dëm të interesit të tij që për të vazhdojë të kujdeset nëna duke pasur parasysh shumë rrethana që vështirsojnë përkujdesjen e saj ndaj fëmijës.

3. Mosdhënia e fëmijës për shkak të shkurorëzimit të martesës me fajin e bashkëshortit

Faji i bashkëshortit për shkurorëzimin e martesës nuk luan rol në vendimin se me cilin prind do vazhdojë të jetojë fëmija pas shkurorëzimit të martesës. Këtë paragraf e përfaqëson edhe Gjykata kushtetuese e Maqedonisë, e cila ka vendosur se “faji i bashkëshortit për prishjen e marrëdhënieve bashkëshortore nuk mund të paraqes pengesë që atij bashkëshorti mos ti jepen fëmijët në përkujdesje kur këtë e kërkojnë interesat e fëmijëve”.¹¹³ Për dallim nga e drejta familjare pozitive ekzistojnë shtete evropiane të cilat e përkrahin fajin e bashkëshortit si shkak për shkurorëzimin e martesës. *E drejta franceze*, për dallim nga numri i madh i ligjvënësve evropian, e mbështet fajin e bashkëshortit si kusht për shkurorëzimin e martesës. Sipas nenit 242 nga Kodi Civil, që të mund të parashtrahet kërkesa për shkurorëzim të martesës për fajin e bashkëshortit është e nevojshme : *1.Njëri bashkëshort mos ti ketë përmbushur obligimet që dalin nga martesa, 2.Kjo mospermbushje të jetë përsëritur disa herë, 3. Si pasojë e sjelljes së tillë të bashkëshortit, jeta bashkëshortore të jetë bërë e padurueshme. Në këto raste, kur për shkurorëzimin e martesës, kërkesën e ka bërë njëri bashkëshort, ndërsa tjetri e ka pranuar, bashkëshorti i cili ka bërë kërkesën duhet të dëshmojë edhe fakte nga të cilat vërtetohet se jeta bashkëshortore është bërë e padurueshme.*

¹¹³ Љиљјана Спировиќ Трпеновска, Дејан Мицковиќ, Ангел Ристов, Семејно Право, Скопје, 2013, fq.202

Në qoftë se bashkëshorti tjetër pajtohet me faktet, atëherë gjykata do të shkurorëzojë martesën si dhe do të vendosë edhe për të gjitha pasojat tjera që dalin nga shkurorëzimi i martesës (rruajtja dhe edukimi i fëmijëve, ndarja e pronës dhe mbajtja).¹¹⁴ Për dallim nga e drejta franceze, në të *drejtën gjermane* nuk kërkohet pëlqimi i përbashkët i bashkëshortëve për shkurorëzim. Është e mjaftueshme vetëm njëri të paraqesë kërkesë për shkurorëzim. Ndërsa faji i bashkëshortit nuk është relevant, kështu që edhe bashkëshorti i cili është fajtor për shkurorëzimin e martesës mund të bëjë kërkesë për shkurorëzim. Gjykatësi ka për detyrim vetëm të vërtetojë se bashkëshortët martesor tri vite jetojnë të ndarë. Nëse kjo vërtetohet, ekziston paragjykim i pakontestueshëm se martesë është e pasuksesshme dhe se duhet të pranohet kërkesa për shkurorëzim. Mirëpo gjithashtu ka raste kur gjykata kërkesën për shkurorëzim të martesës e hudh poshtë, edhe pse martesë nuk ka pasur sukses, nëse shkurorëzimi sjell pasoja të rënda për fëmijët ose partnerin tjetër.¹¹⁵

4. Mosushtrimi i së drejtës prindore nga asnjëri prind

4.1 Marrja e të drejtës prindore

Marrja e të drejtës prindore është njëri nga sanksionet më të rënda që mund tu jepet prindërve për dallim nga kufizimi i së drejtës prindore. Ky sanksion u shqiptohet prindërve të cilët rëndë e keqpërdorin të drejtën prindore, nuk i përmbushin të drejtat dhe detyrimet që i kanë ndaj fëmijëve të tyre. Gjithashtu ky sanksion u shqiptohet edhe prindërve të cilët keqpërdorin të drejtën prindore duke detyruar fëmijët e tyre që të kryejnë vepra penale për qëllime përfitimi. *Abuzimi* dhe *neglizhenca* e fëmijës i përfshin të gjitha format e abuzimit fizik apo emocional, keqtrajtimi seksual, neglizhencën apo trajtimin e pakujdesshëm si dhe eksploatimin komercial apo ndonjë tjetër, i cili rezulton me përkeqësim real apo potencial në shëndetin e fëmijës, rreziqe gjatë zhvillimit të tij apo dinjiteti në kuadër të raportit, i cili përfshin përgjegjësi, besueshmëri dhe fuqi. Neglizhenca paraqet dështim të prindit apo kujdestarit, i cili e ka përgjegjësinë prindërore apo obligimin për përkujdes të fëmijës, të sigurojë zhvillim të fëmijës, në të gjitha fushat: shëndetësi, arsimim, zhvillim emocional, ushqim, akomodim dhe kushte të sigurta jetësore, në kuadër të mjeteve të arsyeshme në dispozicion për familjen, që nxit apo mund të nxit me një probabilitet të madh çrregullim të shëndetit të fëmijës apo zhvillim shoqëror fizik dhe moral, atij mendor dhe shpirtëror.

¹¹⁴ Љиљјана Спировиќ Трпеноска, Дејан Мицковиќ, Ангел Ристов, Семејно Право, Скопје, 2013, fq.144;145

¹¹⁵ По ату, fq. 147.

Pra neglizhenca ndaj fëmijës përfshin neglizhencën bazike të fëmijës, si fizike ashtu edhe psikologjike (emocionale, kognitive) nevojat në fushën e socializimit, në përgjithësi ose mënyrën, e cila mund të çojë deri në dëmtime serioze të shëndetit dhe zhvillimit të fëmijës

Ekzistojnë disa lloje të neglizhencës edhe atë:

Neglizhenca fizike e cila përfshin neglizhencën e nevojave, të cilat mundësojnë që fëmija të rritet dhe të zhvillohet në mënyrë normale. Format më të shpeshta të neglizhencës fizike janë: Neglizhenca për t'i siguruar fëmijës veshje të mjaftueshme në mënyrë që të ngrohet dhe rehatshëm të mbrohet nga vështirësitë e motit ekstrem; Neglizhenca për t'i siguruar veshje e cila në mënyrë të arsyeshme është e pastër dhe në gjendje adekuate; Lejimi i fëmijës që të jetojë në kushte ekstreme; Lejimi i fëmijës të jetojë në kushte joadekuate (kushte të vështira sanitare, instalime të pa përmbushura hidraulike, dritare dhe shkallë të thyera, parmakë të thyer te ballkoneve me çka rrezikohet shëndeti dhe siguria e fëmijës; Neglizhenca për të siguruar ushqim të mjaftueshëm, në sasi cilësi dhe në mënyrë të rregullt me qëllim që të mbulohen nevojat e të ushqyerit të fëmijës, qoftë edhe nëse bëhet fjalë për neglizhencë nga padituria apo të paplanifikuara dhe Dështimi për të siguruar mbikëqyrje adekuate në një masë, e cila mund të çojë deri te rrezikimi i shëndetit dhe i jetës së fëmijës.

Neglizhenca shëndetësore

-neglizhenca për të siguruar përkujdes të nevojshëm mjekësor atëherë kur fëmija është i sëmurë'
-neglizhenca për të bërë imunizimin e nevojshëm dhe masat e tjera parandaluese mjekësore për fëmijën ose kujdesi për dhëmbët e fëmijës dhe neglizhenca për të siguruarit e mjeteve ndihmëse të nevojshme, përfshirë këtu edhe syzet, aparatet për dëgjim e të tjera.

Abuzimi emocional

Abuzimi emocional paraqet neglizhencë ndaj nevojave emocionale të fëmijës. Sjelljet e prindërve si në vijim bëjnë pjesë në abuzimin emocional: prindi ia shkurton dashurinë dhe mbështetjen emocionale fëmijës, që është një ndër arsyet kryesore që fëmija të ndjehet i dashur, i sigurt dhe i vlefshëm; Prindi e neglizhon fëmijën me anë të indiferencës dhe mungesës së kujdesit. Prindi haptazi e neglizhon fëmijën me anë të britmës, me anë të të akuzuarit për problemet e tij ose me anë të transmetimit të mesazheve të tjera negative.¹¹⁶Nga e gjithë kjo mund të vijmë në përfundim se nëse prindërit bëjnë shkelje të të drejtave dhe detyrimeve prindore ose keqpërdorin këto të drejta atyre ju merret e drejta prindore dhe rolin e tyre e ushtron kujdestari ose ndonjë person i tretë të cilin e cakton Qendra për punë sociale. Marrja e të drejtës prindore si sanksion mund të ju shqiptohet ose njërit ose të dy prindërve edhe atë mund që tu merret në raport vetëm me njërin fëmijë ose më të gjithë fëmijët, varësisht nga rrethanat.

¹¹⁶ Protokoll i përbashkët veprimi në raste të dhunës në familje, i institucioneve në vijim: Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, Organizatat Joqeveritare.

Për dallim nga kufizimi i së drejtës prindore, të cilën e kryen Qendra për punë sociale, marrjen e të drejtës prindore e kryen gjykata kompetente në procedurë jokontestimore. Procedura për marrjen e të drejtës prindore mund të inicohet nga ana e prindit tjetër, Qendrës për punë sociale dhe prokurorit publik. Përveç këtyre iniciativë deri te organet kompetente mund të paraqesë edhe secili qytetar përderisa kanë njohuri për keqpërdorim ose shkelje të rëndë të së drejtës prindore. Pavarësisht nga rrjedhin informacionet për keqpërdorim të së drejtës prindore, Qendra për punë sociale është e detyruar ti vërtetojë dhe kur të vërtetojë se ekzistojnë të inicojë procedurë për marrjen e të drejtës prindore. Kur Qendra për punë sociale do të mësojë se ekziston rreziku i keqpërdorimit dhe shkelje e rëndë e së drejtës prindore, është e detyruar menjëherë të ndërmerr masa mbrojtëse të personalitetit, të drejtave dhe interesat e fëmijëve. Marrja e të drejtës prindore nuk ka karakter të përhershëm, që dmth se kur do të pushojnë shkaqet si pasojë e të cilave ka ardhur deri te marrja e të drejtës prindore, prindërve me vendim të gjykatës do të ju kthehet e drejta prindore. Inicimin e procedurës për kthimin e të drejtës prindore mund të paraqesë prindi ose Qendra për punë sociale.¹¹⁷

4.2 Mbrojtja sociale në Republikën e Maqedonisë

Me Ligjin për mbrojtje sociale rregullohen gjithashtu edhe sistemi dhe organizimi për mbrojtje sociale, të drejtën e mbrojtjes sociale financimin dhe procedurën e ushtrimit të së drejtës për mbrojtje sociale. Sipas ligjit për mbrojtje sociale, personi apo familja konsideron materialisht të pasigurt nëse te ardhurat e tyre financiare janë më të ulëta se sasia e ndihmës financiare sociale e përcaktuar me Ligjin për mbrojtje sociale, si dhe personi apo familja e tillë nuk zotëron pronë dhe të drejta pronësore nga e cila mund të mbështetet.¹¹⁸ Mbrojtja sociale është një sistem masash, veprimtarish dhe politikash për të parandaluar dhe kapërcyer rreziqet themelore sociale, ndaj të cilëve janë të ekspozuar njerëzit gjatë jetës së tyre, për të ulur varfërinë dhe perjashtimin shoqëror si dhe për të forcuar aftësinë e tij për vetëmbrojtje.¹¹⁹ Të drejtën e ndihmës financiare për personat të cilët deri në moshën 18 vjeçare kanë statusin e një fëmije pa përkujdesje prindore, ka personi i cili nuk ka të ardhura dhe pronë nga e cila mund ta mbështesë veten deri në moshën 26 vjeçare. Shuma e ndihmës financiare për këto persona është 4,000 denarë e harmonizuar me rritjen e shpenzimeve për jetesë nga viti i kaluar. Ndërsa për personat të cilët janë në gjendje të arsimimit të rregullt shuma e ndihmës financiare sociale është 5,600 denarë e harmonizuar me rritjen e shpenzimeve nga viti i kaluar.¹²⁰

¹¹⁷ Љиљјана Спиrowиќ Трпенoвска, Дејан Мицковиќ, Ангел Ристов, Семејно Право, Скопје, 2003, fq. 216.

¹¹⁸ Лена Нишевска, Владо Аврамовски, „ПРИРАЧНИК за oстварување на правата од социјална и детска заштита“, Скопје, 2011 година, стр 26.

¹¹⁹ Закон за социјална заштита, Службен весник на РМ БР. 79, 24.06.2009 година.

¹²⁰ Лена Нишевска, Владо Аврамовски, „ПРИРАЧНИК за oстварување на правата од социјална и детска заштита“, Скопје, 2011 година, стр 41.

5. Ndryshimi i vendimit me të cilin caktohet se cili prind do të ushtrojë të drejtën prindore

Vendimi i gjykatës me të cilin vendoset se me cilin prind do të jetojë fëmija pas shkurorëzimit të martesës mund edhe të ndryshohet. Ndryshimin e vendimit mund ta kërkojë prindi tjetër, varësisht nga rrethanat e ndryshuara, në të cilat është bazuar edhe gjykata gjatë sjelljes së vendimit se me cilin prind do të jetojnë fëmijët gjithmonë në interes më të mirë të fëmijës. Siç e parasheh edhe **Ligji për familje neni 80** paragrafi 4: “Gjykata me kërkesë të njërit nga bashkëshortët e shkurorëzuar apo Qendra për punë sociale, do ta ndryshojë vendimin për ruajtje dhe edukimin e fëmijëve dhe marrëdhëniet e bashkëshortëve të shkurorëzuar me fëmijët e tyre të përbashkët, nëse këtë e kërkojnë rrethanat e ndryshuara”. Qendra për punë sociale me aktvendim mund të marrë fëmijën nga njëri prind dhe t’ia besojë në ruajtje dhe edukim prindit tjetër, ndonjë personi tjetër ose institucionit përkatës, kur prindërit respektivisht prindi tek i cili jeton fëmija e lë pas dore fëmijën sa i përket ruajtjes dhe edukimit ose kur ekziston rrezik serioz për zhvillimin dhe mirërritjen e tij të drejtë. Qendra për punë sociale mund të sjellë aktvendim me të cilin do t’ia jep fëmijën në qëndrim tek prindi të cilit fëmija nuk i është besuar në ruajtje dhe edukim për një periudhë të caktuar kohore, por jo më gjatë se 15 ditë nëse më tepër se dy herë njëra pas tjetrës prindi tjetër pa arsye nuk e ka respektuar aktvendimin e Qendrës për punë sociale. Qendra për punë sociale do të sjellë aktvendim me të cilin përkohësisht fëmijën do t’ia besojë prindit tjetër, personit të tretë ose do ta vendosë në familje tjetër ose në institucion përkatës, si zgjidhje e fundit nëse ka dijeni se marrëdhëniet personale dhe kontaktet direkte të fëmijës janë ndërprerë më gjatë se dy muaj për shkak të mosveprimit konform aktvendimit të Qendrës për punë sociale nga ana e prindit të cilit i është besuar fëmija ose për shkak të marrëdhënieve të tronditura të bashkëshortëve të cilat ndikojnë në mënyrë të dëmshme në zhvillimin e fëmijëve. Gjykata me kërkesë të njërit nga bashkëshortët e shkurorëzuar apo Qendrës për punë sociale, do ta ndryshojë vendimin për ruajtje dhe edukimin e fëmijëve dhe për marrëdhëniet e bashkëshortëve të shkurorëzuar me fëmijët e tyre të përbashkët, nëse këtë e kërkojnë rrethanat e ndryshuara.¹²¹ Nga gjithë këto dispozita ligjore mund të vijmë në përfundim se çdo vendim që sillet mund edhe të ndryshohet, varësisht nga rrethanat e ndryshuara, gjithmonë duke shikuar interesin më të mirë të fëmijës, qoftë me inicim të prindërve ose nga vetë Qendra për punë sociale e cila si rol kryesor ka mbikëqyrjen në ushtrimin e kësaj të drejtë në mënyrë të drejtë dhe të rregullt.

¹²¹ Neni 80, Lf .

6. Kompetenca e Gjykatës

Shkurorëzimi mbetet një ndër faktorët që ndikon shumë në zhvillimin e familjes dhe shoqërisë. Pasojat e zgjidhjes së martesës i vuajnë më së shumti fëmijët. Ato lidhen kryesisht me përjetimet e konflikteve ndërmjet prindërve të cilat ndikojnë dukshëm negativisht në zhvillimin fizik dhe mendor të fëmijës. Gjykata në vendimin e zgjidhjes së martesës, duhet të marrë vendimin që është në funksion të interesit më të lartë të fëmijës. Nisur nga ky fakt, gjykata ndodhet përpara një sfide profesionale, pasi duhet të marrë një vendim shumë të rëndësishëm që do të ndikojë ndjeshëm në zhvillimin psiko fizik të fëmijëve pas ndarjes së prindërve të tyre. Që do të thote se, vendimi i gjykatës përcakton mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore. Për kontestet për besim të fëmijëve në ruajtje dhe edukim gjykata vendos në procedurë të veçantë (pavarur) së bashku me procedurat objekt kryesor i të cilave është ndonjë kontest tjetër familjar- kontest martesor ose të paternitetit, respektivisht të maternitetit. Ekspertët vlerësues në gjykatë duhet të vlerësojnë dhe të arrijnë në konkluzione të qarta se cila është zgjidhja më e mirë për fëmijën, cili prej prindërve duhet të ketë kujdestarinë parësore si dhe duhet të argumentojnë para gjykatës dhe palëve në proces, përse rekomandimi i tyre është zgjidhja më e mirë e mundshme. Gjatë procesit gjyqësor, momenti më i vështirë për gjykatën është përcaktimi se me cilin prind duhet të qëndrojë fëmija, apo fëmijët, pas zgjidhjes së martesës. Sipas Ligjit për familje, me aktgjykimin me të cilin shkurorëzohet martesja gjykata do të vendosë ruajtje edukim dhe mbajtje të fëmijëve të përbashkët (neni 80 parag 1 LF). Nëse prindërit nuk janë marrë vesh për këtë ose marrëveshja e tyre nuk u përgjigjet interesave të fëmijëve, gjykata posa të marrë mendimin e Qendrës për punë sociale dhe të hulumtojë të gjitha rrethanat, do të vendosë nëse fëmijët do të qëndrojnë për ruajtje dhe edukim të njëri prind ose disa do të qëndrojnë tek nëna dhe disa tek babai ose të gjithë do t'i besohen ndonjë personi të tretë apo institucioni.

KAPITULLI V

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Kjo temë ka përfshirë analizën e normave juridike që rregullojnë të drejtën prindore, si një institut shumë i rëndësishëm i së drejtës familjare, të drejtat dhe detyrimet e prindërve dhe fëmijëve, kujt i takon ushtrimi i kësaj të drejte pas shkurorëzimit të bashkëshortëve martesor, kompetencat e Qendrës për punë sociale në këtë fushë si dhe kompetencat e Gjykatës sipas të drejtës familjare të Republikës së Maqedonisë. Hulumtimi im ka përfshirë analizën e detajuar të kornizës ligjore që rregullon të drejtën prindore dhe procedurën për ushtrimin e kësaj të drejte pas shkurorëzimit, mosmarrëveshjet që paraqiten në lidhje me ushtrimin e kësaj të drejte pas shkurorëzimit si dhe zgjidhja e tyre me dispozitat e Ligjit për familje të Republikës së Maqedonisë (1992). E drejta prindore është tërësi rregullash juridike me të cilat rregullohen marrëdhëniet midis prindërve dhe fëmijëve, midis adoptuesit dhe të adoptuarit, të drejtat dhe detyrat që ligji ua njeh prindërve ndaj fëmijëve të tyre të mitur. Varësisht nga gjendja civile e prindërve të cilët mund të jenë bashkëshort martesor ose të shkurorëzuar kjo e drejtë mund të ushtrohet bashkërisht ose si e ndarë. Të drejtën prindore e përbëjnë të drejtat dhe obligimet e prindërve për tu perkujdesur për personalitetin, të drejtat dhe interesat e fëmijëve të tyre të mitur dhe fëmijëve mbi të cilët ka vazhduar e drejta prindore. Prindërit kanë të drejtë dhe obligim t'i mbajnë fëmijët e tyre të mitur, të kujdesen për jetën dhe shëndetin e tyre, t'i përgatisin ata për jetë e punë të pavarur, të kujdesen për edukimin e tyre, shkollimin dhe aftësimin profesional të tyre. Fëmijët e mitur kanë të drejtë të jetojnë me prindërit e tyre. Ata mund të jetojnë ndaras nga prindërit e tyre, vetëm atëherë kur kjo paraqet interes të drejtpërdrejtë për fëmijët ose kur kjo paraqet interes të përbashkët për fëmijët dhe për prindërit. Fëmija ka të drejtë të mbajë raporte personale dhe kontakte të drejtpërdrejta me prindin me të cilin nuk bashkëjeton. Gjithashtu nga ky hulumtim vijm në përfundim se shumica e fëmijëve të cilët rriten me prindër të ndarë nuk janë të njëjtë me fëmijët që jetojnë në bashkësi familjare. Ata shfaqin kryesisht sjellje agresive, bëhen të pashoqërueshëm, krijojnë varësi, nuk afrohen lehtë në rrethin social ku bëjnë pjesë, por mbyllen në vetëvete. Shkurorëzimi ndikon në sjelljen e mëvonshme të fëmijës, ndikon në shfaqjen e simptomave emocionale, mungesës së vëmendjes ose hiperaktivitetit, problem në sjellje, rritjen e nivelit të stresit. Kur prindërit shkurorëzohen, fëmijët bëhen më indiferent. Janë shumë të shqetësuar pasi nuk duan që të merret vesh në rrethin shoqëror se prindërit e tyre janë të shkurorëzuar. Në përgjithësi paraqesin një rënie lidhur më vetëvlerësimin, kanë një ndjenjë frike dhe pasigurie nga mungesa e njërës prind. Fëmijët përjetojnë stresin më të madh përderisa edhe ata vetë janë të përfshirë në konfliktin midis prindërve. Para ose gjatë shkurorëzimit të martesës, shpeshherë fëmijët shfrytëzohen nga ana e prindërve të tyre si mjet për përcjellje të urrejtjes ndaj prindit tjetër. Një sjellje e tillë e prindërve nënkupton keqpërdorim emocional të fëmijës i cili lë pasoja afatgjate. Sipas ligjit për familje të Republikës së Maqedonisë, nëse prindërit nuk janë marrë vesh ose nëse marrëveshja e tyre nuk u përgjigjet interesave të fëmijëve, gjykata posa të marrë mendimin nga Qendra për punë sociale dhe

të hulumtojë të gjitha rrethanat, do të vendosë nëse fëmijët do të qëndrojnë për ruajtje dhe edukim te njëri prind ose disa do të qëndrojnë tek nëna, disa tek babai ose të gjithë do t'i besohen ndonjë personi të tretë apo institucioni (neni 80). Nga vetë ky nen mund të konkludohet se ligji nuk parashikon mbajtjen dhe edukimin e fëmijës nga ana e të dy prindërve edhe pas shkurorëzimit të martesës. Në këndvështrimin e ushtrimit të së drejtës prindore pas shkurorëzimit të martesës, duke u mbështetur në bindjen se ligji gjithmonë i përshtatet ndryshimeve të shoqërisë, mund të përfundojmë se me mundësinë e fuqisë ligjore, e cila do të nënkuptonte kufizimin e ekskluzivitetit në besimin e kujdestarisë dhe edukimit të fëmijës që i jepet vetëm njërit prind, dhe futjen e opsionit që pas shkurorëzimit të martesës kujdestaria e fëmijëve t'u jepet të dy prindërve, do të lejonte një koordinim më të mirë të aktiviteteve prindërore nga të dy prindërit, e cila në fund të fundit do të kontribuonte në respektimin më të madh të të drejtave të fëmijës. Mungesa e dispozitave ligjore të cilat sakt dhe qart caktojnë ushtrimin e të drejtës prindore pas shkurorëzimit të martesës gjithashtu krijon mangësi dhe vështirësi që fëmija të kalojë kohë më të gjatë me prindin me të cilin nuk jeton si psh gjatë festave ose pushimeve verore apo dimërore. Gjithashtu si rekomandim mund të jepet ideja që dispozitat ligjore të cilat i janë kushtuar ushtrimit të së drejtës prindore pas shkurorëzimit, të përcaktojnë kushte dhe rrethana që do të lejonin një qëndrim më të gjatë të fëmijës me prindin që nuk e ushtron të drejtën prindore. Gjetja e një zgjidhje ligjore e cila do t'i mundësonte prindit të cilin nuk e ka caktuar gjykata si kujdestar kryesor, të kalojë më shumë kohë me fëmijën e tij, për shembull që për një periudhë prej tre muaj në vit të jetojë me të, do të ndikonte drejtpërdrejtë në edukimin dhe zhvillimin e drejtë të fëmijës, krijimin e marrëdhënieve familjare stabile si dhe ndërveprim të rregullt të fëmijës me të dy prindërit. Nga vetë natyra e ndarjes do të ekzistojë gjithmonë diçka që fëmijët nuk mund të kërkojnë ndihmën e duhur pasi prindërit e tyre janë të shkurorëzuar dhe jetojnë të ndarë edhe përkundër faktit se prindërit kanë mundësi që financiarisht t'i mbështesin fëmijët e tyre kur ata kanë nevojë, edhe pse gjithmonë gjatë sjelljes së vendimit për shkurorëzim, gjatë vendosjes se me cilin prind do vazhdojë të jetojë fëmija do të merret në konsideratë interesi më i mirë i fëmijës, edhe nëse shumica e prindërve të shkurorëzuar do të bashkëpunonin që të vendosnin se çka është më e mira për fëmijët e tyre. Nuk duhet të lëmë anash edhe rastet kur prindërit e shkurorëzuar, që për nga natyra kanë marrëdhënie aq të ashpra, refuzojnë që të plotsojnë nevojat e fëmijës. Ose gjithashtu edhe rastet kur prindit të cilit pas shkurorëzimit nuk i është dhënë në kujdesje fëmija, refuzon që t'i sigurojë mbështetje fëmijës vetëm për shkak të sjelljes së atij vendimi. Është e pashmangshme që shkurorëzimi padyshim që shkakton pasojat të padëshiruara në lidhje me mirëqenien e fëmijëve dhe për këtë arsye obligimi i çdo shteti modern është të krijojë një legjislacion efektiv brenda të cilit prioritet pa përjashtim do të jetë interesi më i mirë i fëmijës në të gjitha procedurat ligjore, duke përfshirë edhe procedurën e shkurorëzimit.

Nga këtu mund të rekomandojmë gjithashtu që shteti të sigurojë në kuadër të Qendrës për punë sociale si institucion publik, hapjen e këshillimoreve adekuate të bashkëshortëve, ku do të mund të këshillohen me ekspert profesional për zgjidhjen e konflikteve martesore përderisa krizat e tilla nuk kanë marrë një kahje tjetër, dmth nuk kanë si zgjidhje shkurorëzimin. Një mungesë e tillë e qendrave të specializuara për këshillim falas në Republikën e Maqedonisë është e dukshme. Prania e një këshillimore e cila ofron terapi familjare falas premtion shumë përsa u përket të ashtuquajturave masa parandaluese të shkurorëzimit. Një rekomandim gjithashtu iu drejtohet edhe ekspertëve profesional të Qendrës për punë sociale, gjatë hartimit të raporteve të tyre në rastet e zgjidhjes së martesave me fëmijë të mitur. Raportet e tyre duhet të bëhen me përkushtimin sa më të madh dhe me hulumtimin e të gjitha rrethanave të secilit rast konkret, duke pasur parasysh në rend të parë interesin më të mirë të fëmijëve të mitur, pasi pasojat e zgjidhjes së martesës ndikojnë në një masë të madhe në mirëritjen e tyre, për shkak të moshës së tyre. Që dmth se një raport i tillë nuk duhet që të konsiderohet vetëm si një punë e tyre rutinë, por me përkushtim dhe përgjegjësinë më të madhe. Rekomandimi i fundit i takon të gjithë institucioneve shtetërore, të cilat janë kompetente në rastet e shkurorëzimeve, për zgjidhjen sa më të mirë të secilit rast konkret, pasi qëllim kryesor nuk është ndalimi i shkurorëzimit sepse shkurorëzimi si një nga mënyrat më të shpeshta të prishjes së martesës së vlefshme është e pranuar gati se në të gjitha legjislacionet familjare bashkëkohore, por synohet që të ketë një numër më të vogël të martesave të shkurorëzuara.

Literatura

- Dokmanović M. (2010) Pravo i politikla vo Makedonija (1946-1953) Skopje
- Puhan Ivo (1989), E drejta Romake, Prishtinë,
- Дејан Мицковиќ, Ангел Ристов, Семејно Право,
- Puhan Ivo, Polenak, Agjimovska Mirjana, e Drejta romake, Universitet Kiril i Metodij, Skopje, 2001
- Билјана Размоска, Гоце Галев, Ана Баџваровска, Штаудингер, Граѓански законик, Основи на граѓанското право,
- Arta Mandro- Balili, Vjollca Meçaj, Tefta Zaka, Arjana Fullani, E drejta familjare, Tiranë 2006,
- Љилјана Спировиќ Трпеновска, Дејан Мицковиќ, Ангел Ристов, Семејно Право,
- Hamdi Podvorica, E Drejta Familjare, Prishtinë, 2005
- Докмановиќ, Мишо, Право и Политика во Македонија (1946-1953) ИСИЕ, Скопје, 2010
- Љилјана Спировиќ Трпеновска, Development of Family Laë in Macedonia, The International Survey of Family Laë 1997, Kluëer Laë International, Hague, 1999.
- Дејан Мицковиќ, Ангел Ристов, Закон За Семејството, Скопје, 2015,
- Arta Mandro-Bilalli, Vjollca Meçaj, Tefta Zaka, Arjana Fullani, E drejta familjare, Tiranë, 2006.
- Arsen Janevski, Dr. Tatjana Zoroska-Kamilovska, E drejta procedurale civile, Shkup, 2009
- Mira Alinçiq, Dubravka Hrabar, Dijana Jakovac-Loziç, Aleksandra Koraç, Obiteljsko pravo, Zagreb, 2006.
- Arta Mandro, E drejta familjare, Tiranë 2009
- Лена Нишевска, Владо Аврамовски,,„ПРИРАЧНИК за остварување на правата од социјална и детска заштита“, Скопје, 2011.

Akte ligjore, kode

- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, 1991
- ЗАКОН ЗА СЕМЕЈСТВОТО (Сл. Весник на Р.Македонија 153 /2004)
- Kodi i familjes i R.Shqipërisë, Ligji Nr.9062, dt.8.5.2003
- Пречистен текст на основниот Закон за бракот, Службен Весник на СФРЈ, Белград, 1996
- Закон за вонпарнична постапка (Сл.весник на РМ, бр.19/1979).
- Закон за парична постапка
- Закон за социјална заштита (Службен весник на РМ бр. 79/2009 , 36/2011 и 51/2011)
- Закон за заштита на децата(Службен весник на РМ бр.170/2010) (Пречистен текст)II
- Konventa për të drejtat e fëmijëve, 1989.
- Të Drejtat e Njeriut, Përmbledhje e instrumenteve ndërkombëtare, Vëllimi i parë (Pjesa e Parë), Instrumentet e Përgjithshme, Kombet e Bashkuara, NeëYork dhe Gjenevë, 1994, Konventa për të drejtat e fëmijës.
- Konventa Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, 1950 .
- Protokoll i përbashkët veprimi në raste të dhunës në familje, i institucioneve në vijim: Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, Organizatat Joqeveritare.
- Raste nga praktika e Avokatit të popullit.

Burime nga interneti

- <https://www.lawcornell.edu/wex/guardian>
- <http://www.pravo.org.mk/>
- <http://www.bg-pravo.com/2014/10/semeyno-pravo.html>
- https://www.medscape.com/viewarticle/405852_6
- <https://www.sobranie.mk/content/ustav%20al/ustav%20rsm-al-ok.pdf>
- <http://www.stat.gov.mk/Publikacii/MakBrojki2019mk.pdf>
- <http://www.stat.gov.mk/Publikacii/PDFSG2016/03-Naselenie-Population.pdf>
- https://en.wikipedia.org/wiki/Human_rights_in_North_Macedonia
- <http://ceflonline.net/wp-content/uploads/France-Parental-Responsibilities.pdf>
- <http://ceflonline.net/wp-content/uploads/Germany-Parental-Responsibilities.pdf>
- <http://ceflonline.net/wp-content/uploads/Italy-Parental-Responsibilities.pdf>
- <http://ceflonline.net/wp-content/uploads/Sweden-Parental-Responsibilities.pdf>
- <http://www.slvesnik.com.mk/content/Ustav%20na%20RM%20-%20makedonski%20-%20FINALEN%202011.pdf>
- <https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2013/11/Zakon-za-narodniot-pravobranitel-22-09-2003.pdf>
- <https://www.sobranie.mk/content/ustav%20al/ustav%20rsm-al-ok.pdf>
- <http://ombudsman.mk/upload/documents/2012/Licni%20kontakti%20dete%20roditel%2025.06.2012.pdf>